

VAZHDON GJAHU I SPECIALES



EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 7083
30, 31 dhjetor 2023 dhe
1, 2 e 3 janar 2024

DERISA NË HAGË PO
ZHVILLOHET BETEJA
PËR PASTËRTINË E
LUFTËS ÇLIRIMTARE,
POPULLI I KOSOVËS
MBËSHTET UÇK-në



VIT I PAPARASHIKUESHËM

Në numrin ekskluziv dhe festiv të gazetës
“Epoka e re” mund të lexoni, opinione,
shkrime nga politika, ekonomia, siguria, shën-
detësia, kultura dhe sporti.
Mund të informohuni më shumë për ngjarjet

më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë vitit
2023 në Kosovë dhe në botë. Viti 2023 ishte vit i
ballafaqimit të liderëve të UÇK-së në Gjykatën
Speciale. Gjithashtu, mund të lexoni për dësh-
imin e politikës së jashtme, e cila nuk ka sigu-

ruar asnjë njohje të re në 2023-n, për sulmin
terrorist në veri të Kosovës, për trazirat në veri,
për rezultatet e dialogut, për liberalizimin e
vizave e për tema të tjera të rëndësishme që
janë shënuar gjatë vitit që po lëmë pas

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

“Epoka e re” të gjithë qytetarëve ua uron Vitin e Ri 2024!

KNAUF INSULATION
Mob: 049/335-221
049/335-224
049/334-224
Është koha ta kthejmë energjinë!
www.knaufinsulation.com/al

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhep isht
Tetov*
Tel: +389 44 487 300; +389 44
+389 44 487 75
Fax: +389 44 487
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 2

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
ND, RTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOV,
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

KOSOVA GJATË 2023-s

EPOKA E RE **Lirim GECI**

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Dialogu me Serbinë dhe situata e tensionuar në veri kanë qenë ngjarjet kryesore që kanë karakterizuar Kosovën në vitin 2023. Krahës këtyre ngjarjeve, ka pasur edhe disa zhvillime në fusha të ndryshme.

Kosova dhe Serbia pranojnë propozimin evropian, por nuk e nënshkruajnë

27 SHKURT/ 18 MARS - Kosova dhe Serbia më 27 shkurt janë pajtuar për marrëveshjen drejt normalizimit të raporteve, apo siç njihet edhe si propozimi evropian për normalizim. Ndërsa më 18 mars, palët, nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, kanë arritur pajtim për aneksin e zbatimit të marrëveshjes drejt normalizimit. Në raundin e dialogut që është mbajtur në Ohër të Maqedonisë së Veriut, në cilësinë e vëzhguesit ishte edhe emisari amerikan Gabriel Escobar. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka



argumentuar se marrëveshja ofron “njohje de facto”, ndërsa sa i përket Asociacionit ai i është referuar nenit 7, duke thënë se bëhet fjalë për “një nivel adekuat të vetëmenaxhimit të komunitetit serb” dhe “jo për vetëqeverisje”. Ndërsa presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se me këtë dokument formimi i Asociacionit “është bërë detyrim me prioritet”.

Haki Abazi largohet nga Vetëvendosja

28 SHKURT - Deputeti Haki Abazi, pas pranimit të planit evropian nga kryeministri Albin Kurti, ka njoftuar se ka ndarë rrugët me Kurtin dhe Lëvizjen Vetëvendosje. Para se të largohet nga Vetëvendosja, Abazi ishte shkarkuar nga pozita e kryetarit të Komisionit për Punë të Jashtme në Kuvendin e Kosovës.

Humolli braktis grupin parlamentar të LV-së

22 MARS - Deputeti Fatmir Humolli është larguar nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje. Ai ka thënë se është larguar nga

shumica parlamentare për shkak të pakënaqësive me mënyrën e qeverisjes së vendit nga Albin Kurti dhe Vetëvendosja.

Arrestohet drejtori i KEK-ut

19 PRILL - Prokuroria Speciale ka njoftuar se është arrestuar drejtori i KEK-ut, Nagip Krasniqi. Sipas prokurorisë, Krasniqi është arrestuar për shkak të dyshimit se ka kryer veprat penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Ushtrim i ndikimit” dhe “Konflikt i interesit”. Ai është mbajtur për disa muaj në paraburgim, por më vonë është liruar. Arrestimi i tij ka ngjallur reagime të shumta, ku vlen të theksohen akuzat e pushtet, veçanërisht të kryeministrit Albin Kurti në drejtim të prokurorisë.

Komunat në veri udhëhiqen nga kryetarët shqiptarë

23 PRILL - Janë mbajtur zgjedhjet e jashtëzakonshme në katër komunat e veriut të Kosovës pas largimit të kryetarëve serbë. Këto zgjedhje janë fituar nga

kandidatët shqiptarë, pasi ato janë bojkotuar nga serbët lokalë. Erden Atiq (Vetëvendosjes) është zgjedhur kryetar i Mitrovicës së Veriut, ndërsa Lulzim Etemi (Vetëvendosje) është zgjedhur kryetar i Leposaviqit. Ndërsa kryetar i Zveçanit është zgjedhur Ilir Peci dhe kryetar i Zubin Potokut, Imri Zeqiri. Peci dhe Zeqiri vijnë nga radhët e PDK-së. Kryetarët në katër komunat në veri kanë dhënë betimin më 25 maj.

Përmbillet procesi i liberalizimit të vizave

25 PRILL - Vendimi për liberalizimin e vizave për Kosovën është botuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Me këtë veprim është përmbyllur edhe formalisht i gjithë procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Vendimi pritet të hyjë në fuqi më 1 janar të vitit 2024 - prej kur qytetarët e Kosovës që kanë pasaporta biometrike të lëshuara nga shteti i Kosovës, do të mund të udhëtojnë pa viza në atë që njihet si Zona Shengen dhe përbëhet



prej 27 shtetesh evropiane.

Serbët shkaktojnë dhunë në veri të Kosovës

26 MAJ - Grupe qytetarësh serbë janë përplasur me Policinë e Kosovës e cila po i ndihmonte kryetarët e rinj të tri komunave të banuara me shumicë serbe në veriun e vendit për të hyrë në zyrat e tyre. Policia ka përdorur edhe gazin lotsjellës dhe shok-bomba për t'i shpërndarë qytetarët e tubuar rreth tyre dhe për t'u mundësuar hyrjen në zyra kryetarëve të rinj. Ndërsa më 29 maj ka ndërhyrë edhe KFOR-i për ta qetësuar situatën pasi persona të maskuar sulmonin policinë në veri. Gjatë ballafaqimit me protestuesit janë lënduar 30 ushtarë të KFOR-it.

Tre policë të Kosovës kidnapohen nga forcat serbe

14 QERSHOR - Tre policë kufitarë të Kosovës janë kidnapuar të mërkurën nga forcat serbe gjatë një patrullimi në vendin e quajtur Tresave/Bare, në vijën kufitare në veri të Kosovës. Kryeministri Albin Kurti ka bërë thirrje për lirimin e menjëhershëm të zyrtarëve policorë dhe e ka ftuar faktorin ndërkombëtar ta dënojë, atë që ai e quajti, “akt agresioni të Serbisë”. E presidentja Vjosa Osmani ka theksuar se ky akt dëshmon edhe njëherë se Serbia nuk është e interesuar për paqe dhe stabilitet në rajon, por për të shkaktuar destabilizim të Kosovës dhe të gjithë rajonit. Policët e kidnapuar



janë liruar më 26 qershor.

Anulohet mbledhja e dy qeverive

14 QERSHOR - Mospajtimi i kryeministrit të Shqipërisë, Edi Ramës, sidomos me përgjigjen që kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka në raport me kërkesat ndërkombëtare për shtensionimin e situatës në veri, ka çuar në anulimin e një mbledhjeje të përbashkët të Qeverisë së Kosovës dhe të Shqipërisë, e paraparë të mbahej në qytetin e Gjakovës. Këto zhvillime janë parë si pikë e ulët në raportet ndërshtetërore Kosovë - Shqipëri.

Kosova nën sanksionet e BE-së

2 korrik - Bashkimi Evropian (BE) ka vendosur masa kundër Kosovës për shkak të mospërfilljes së kërkesave për hapa të menjëhershëm nga Qeveria e Kosovës për uljen e tensioneve në veri. BE-ja ka pezulluar punën e organeve të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Kosova, gjithashtu, nuk do të ftohet në ngjarje të nivelit të lartë dhe vizitat dypalëshe do të pezullohen, përveç atyre të fokusuara për diskutimin e krizës në veri të Kosovës në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja.

Kërcasin grushtet në Kuvendin e Kosovës

13 KORRIK - Kuvendi i Kosovës është

kthyer në një ambient grushtesh në mes të pushtetit dhe opozitës. Deputetet e PDK-së, Blerta Deliu dhe Floretë Zejnullahu, kanë vendosur në foltoren e Kuvendit dhe te vendi i kryeministrit parulla me mbishkrimin “Zdravo”. Megjithatë, ato nuk e penguan Kurtin të mbante fjalim para deputetëve. Situata u tensionua kur deputetja tjetër e PDK-së, Ganimete Musliu, vendosi në foltore përballë parullës “Zdravo” fotografinë e Kurtit. Pasi u largua Musliu, zëvendëskryeministri Besnik Bislimi u çua nga vendi dhe e shqeu atë fotografi, duke nxitur kështu reagimin e deputetit të PDK-së, Mërgim Lushtaku, i cili me shishe të ujit në duar i stërpiku Kurtin dhe Bislimin dhe këtu filluan grushtet në mes të ministrave dhe deputetëve të PDK-së. U desh ndërhyrja e sigurimit të kryeministrit për ta vënë situatën nën kontroll, ndërsa kryetari i Kuvendit kërkoi ndërhyrjen e policisë.

Veteranët e UÇK-së përjashtohen nga paga minimale

13 KORRIK - Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Pagën Minimale, ku paga minimale rritet në 264 euro. Me këtë ligj pushteti ka përjashtuar veteranët e UÇK-së të cilët do të vazhdojnë të marrin pension prej 170 eurosh. Lidhur me veteranët, ky ligj thekson se “deri në kategorizimin përfundimtar të listës së veteranit, Qeveria e Kosovës, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për financa, vendos për lartësinë e shumës së pensioneve të përcaktuara me këtë ligj, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual”. Ndaj përjashtimit të veteranëve nga paga minimale ka pasur reagime të shumta.

Kosova blen dronë Bayraktar

16 KORRIK - Republika e Kosovës ka blerë dronë Bayraktar TB-2 nga Turqia. Lajmin për blerjen e këtyre dronëve e ka bërë me dije kryeministri Albin Kurti. “Kosova tash është edhe më e sigurt përveçse gjithnjë krenare!” ka thënë Kurti, duke i përgëzuar pjesëtarët e FSK-së që e kanë kryer trajnimin për përdorimin e dronëve. Dronët e tillë, të llojit TB-2, përdoren nga ushtritë e disa shteteve dhe janë dërguar edhe në Ukrainë për t'i ndihmuar forcat e Kievit që të luftojnë kundër pushtimit rus.

Shkon Mehaj, vjen Maqedonci

8 GUSHT - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë, duke e



familjare”. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se e ka pranuar dorëheqjen e tij dhe e ka falënderuar “për punën e pandërprerë, kontributin mbresëlënës, bashkëpunimin e rregullt dhe angazhimin e tij shembullor nga dita e parë e marrjes së detyrës”. Kurti në vend të Mehajt, i cili kishte ardhur nga Norvegjia për t’u bërë pjesë e Qeverisë së Kosovës, ka emëruar ministër të ri të Mbrojtjes, Ejup Maqedoncin.

Afera “Vaji”, arrestohet miku i Kurtit

18 GUSHT - Me duar të lidhura nga Policia e Kosovës është shfaqur Ridvan Muharremi - Ridi, miku i ngushtë i kryeministrit Kurti. Policia e Kosovës, pasi ka bastisur edhe banesën që është në pronësi të Ridvan Muharremit, i njohur si Ridi, pronar i furrës së shndërruar në restorant “Bukë e Zemër”, ka arrestuar këtë të fundit. Po ashtu, policia ka arrestuar edhe drejtorin e Departamentit të Rezervave Shtetërore, Hafiz Gara dhe atë të Departamentit për Integritet Evropian, Irfan Lipovica. Personat e arrestuar dyshohet se kanë bërë keqpërdorime sa iu përket blerjeve të rezervave shtetërore. Pas qëndrimit disajavësh në paraburgim, ata janë liruar.

Sulm terrorist në veri, vritet reshteri Afrim Bunjaku

24 SHIATOR - Një grup terrorist ka sulmuar Policinë e Kosovës në Banjskë të Zveçanit, duke lënë të vrarë policin Afrim Bunjakun. Gjatë përlëshjeve të armatosura janë vrarë edhe tre sulmues serbë. Ish-nënkryetari i Listës Serbe, Milan Radojčić, e ka marrë përgjegjësinë për sulmin. Autoritetet e Kosovës e kanë akuzuar Serbinë se ka tentuar ta aneksojë verin e Kosovës. Sulmi në veri është dënuar edhe nga faktori ndërkombëtar, por Serbia nuk është ndëshkuar për këtë agresion të hapur ndaj shtetit të Kosovës.



Mbahet samiti i Berlinit në Tiranë

16 TETOR - Samiti i Berlinit e ka kthyer Tiranën në kryeqendër të politikës dhe medias evropiane. Në tryezën e përbashkët të udhëheqësve të Bashkimit Evropian dhe të atyre të Ballkanit Perëndimor është diskutuar për shumë tema, por është veçuar bashkëpunimi ekonomik, zgjerimi i BE-së, situata në veri të Kosovës dhe ngjarjet e fundit në Izrael pas sulmit të Hamasit.

Osmani nuk dekreton Blerim Isufajn në pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit

17 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka njoftuar të martën se nuk e ka dekretuar Blerim Isufajn në pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit. Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) më 8 prill 2022 i kishte dërguar propozimin Presidencës me emrin e Isufajt. Në një konferencë për medie në Prishtinë, Osmani ka renditur disa shkelje ligjore që ka thënë se janë gjetur në procesin e përzgjedhjes së kryeprokurorit, prandaj ajo ka marrë vendim që të mos e dekretojë atë. Presidentja i ka kërkuar Këshillit Prokurorial të propozojë një emër tjetër për këtë pozitë, duke u bazuar në merita dhe transparencë. Por, KPK-ja ka propozuar përsëri emrin e Isufajt për kryeprokuror.

Kosovës dhe Serbisë i dorëzohet draft-statuti i Asociacionit

21 TETOR - Diplomatatë euro-amerikanë u kanë propozuar Kosovës dhe Serbisë një draft-statut të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe për të cilin kryeministri Albin Kurti është shprehur i gatshëm ta nënshkruajë së bashku me marrëveshjen e Brukselit dhe aneksin e Ohrit, ndërsa presidenti serb Aleksandër Vučić e ka



refuzuar atë. Ky draft-statut fillimisht ishte mbajtur i fshehur nga publiku, por me vonë është bërë publik. Draft-statuti i Asociacionit është kritikuar nga opozita. Një draft-statut i Asociacionit është hartuar nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, por është refuzuar nga qeveria Kurti. Edhe organizata gjermane Friedrich-Ebert-Stiftung, në partneritet me Institutin Evropian për Paqe, në fillim të vitit kanë publikuar një draft-statut të Asociacionit.

Berisha akuzohet për korrupsion, i ndalohej dalja jashtë vendit

22 TETOR - Ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, është akuzuar për korrupsion pasiv dhe, si pasojë, i është ndaluar të udhëtojë jashtë vendit pas një vendimi të Prokurorisë së Posaçme të Shqipërisë (SPAK). Po ashtu, atij i



është hequr edhe imuniteti i deputetit nga ana e Kuvendit.

Abdixhiku rizgjedhet kryetar i LDK-së

19 NENTOR - Pa asnjë kundërkandidat, Lumir Abdixhiku është rizgjedhur kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Kuvendin e Dhjetë Zgjedhor të kësaj partie. Ai ka fituar pa asnjë votë kundër, pasi kandidatura e Faton Bislimi është refuzuar nga

kryesia e kësaj partie. Bislimi, të cilit nuk i është lejuar as ta merrte fjalën, ka thënë se vendimi ishte antistatut. Me 333 vota për, Lumir Abdixhiku është rizgjedhur sërish kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës edhe për një mandat.

Vritet Liridona Ademaj

29 NENTOR - Policia e Kosovës ka njoftuar se një grua është gjetur e vrarë në një veturë në Prishtinë. Viktima është Liridona Murseli-Ademaj, gruaja e Naim Murselit, këshilltarit të presidentit të AKR-së, deputetit të Kuvendit të Kosovës, Behgjet Pacolli. Ajo fillimisht ishte varrosur në vendlindjen e bashkëshortit. Ditën e varrimit policia ka arrestuar Naim Murseli, i cili dyshohet se ka orkestruar vrasjen e bashkëshortes. Po për këtë ngjarje tragjike janë arrestuar edhe dy persona të tjerë. Pas arrestimit të bashkëshortit të saj, familjarët e Liridonës e kanë

zhvarrosur atë dhe e kanë rivarrosur në vendin e lindjes.

Gjykata Kushtetuese i shpall të pavlefshme disa nene të Ligjit për Paga

26 dhjetor - Gjykata Kushtetuese ka shpallur të pavlefshme disa nene të Ligjit për Paga në sektorin publik, duke e pranuar kërkesën e Avokatit të Popullit për kushtetutshmërinë e këtij ligji. Kushtetuesja ka konstatuar se

“paragrafet 2, 3 dhe 4 të nenit 41, për shtetasit tranzitore, dhe paragrafi 2 i nenit 45 (shfuqizimi i Ligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës) të ligjit të kontestuar, shpallen të pavlefshëm me hyrjen në fuqi të aktgjykimit”. Vendimi i Kushtetueses nuk i prek “në asnjë mënyrë” zyrtarët dhe nëpunësit të cilëve u është ngritur niveli i pagës përmes Ligjit për Paga. Gjykata ka urdhëruar Kuvendin që në periudhën prej gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të vendimit të saj, t’i ndryshojë apo t’i plotësojë nenet e lartcekura në pajtim me Kushtetutën.

Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi shpallen “Qytetarë Nderi” të Drenasit

27 DHJETOR - Liderët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, janë shpallur “Qytetarë Nderi” të komunës së Drenasit. Propozimin për ta shpallur “Qytetarë Nderi” katërshen e UÇK-së e ka bërë kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci dhe është përkrahur nga të gjithë asamblistët e Kuvendit Komunal të kësaj komune.

Politika e jashtme në gjumë, asnjë njohje e re për Kosovën

Kosova ka përmbyllur vitin 2023 pa as edhe një njohje të re të shtetësisë së saj. Hera e fundit kur Kosova kishte pranuar njohje, ishte para tri vitesh, derisa një hendek i tillë kohor pa asnjë njohje po shihet si dështim i diplomacisë së Kosovës, sa që është venë në pikëpyetje nëse në Kosovë ekziston politika e jashtme. Opozita ka theksuar se ky është viti më i dështuar për Kosovën në politikën e jashtme.

Vdes Dick Marty

28 DHJETOR - Ish-senatori zviceran dhe raportuesi i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE), Dick Marty, ka ndërruar jetë në moshën 78-vjeçare. Trupi i pajetë i hartuesit të raportit kundër liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) është gjetur në shtëpinë e tij. Në vitin 2010, ai e kishte hartuar një raport mbi trafikimin e pretenduar të organeve në Kosovë, i cili implikonte pjesëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, mbi bazën e të cilit është ngritur aktakuzë mbi ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, përfshirë deputetin e Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi.





DERISA NË HAGË PO ZHVILLOHET BETEJA PËR PASTËRTINË E LUFTËS
ÇLIRIMTARE, POPULLI I KOSOVËS MBËSHTET UÇK-NË

VAZHDON GJAHU I SPECIALES

- Marashi për UÇK-në, gjykimet, arrestimet, lirimet dhe bastisjet nga Gjykata Speciale

Gjatë vitit 2023 kanë ndodhur zhvillime të shumta në Gjykatën Speciale në Hagë, në të cilën është duke u zhvilluar procesi gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së. Këto zhvillime përfshijnë fillimin e procesit gjyqësor ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit. Po ashtu, këto zhvillime përfshijnë edhe gjahun e Speciales ndaj njerëzve të luftës dhe arrestimin e disa prej ish-bashkëpunëtorëve të liderëve të UÇK-së. Gjatë vitit 2013 janë liruar dy drejtuesit e OVLUÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, ndërsa Salih Mustafa është dënuar nga Apeli i Speciales me 22 vjet burgim. Se lufta e UÇK-së ishte çlirimtare dhe e drejtë, ka dëshmuar marshi i mbajtur në Prishtinë më 2 prill

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Viti 2023 ka shënuar fillimin e betejës ligjore për mbrojtjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Gjykatën Speciale. Në fillim të muajit prill ka filluar procesi gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Në këtë kontekst gjatë gjithë këtij viti është zhvilluar beteja e ashpër ligjore në mes të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe mbrojtjes së liderëve të UÇK-së. Po gjatë këtij viti kanë ndodhur disa arrestime dhe bastisje nga Gjykata Speciale.

Krahas këtyre, Specialja ka liruar nga burgu Hysni Gucatin dhe Nasim Haradinajn, kurse ka dënuar Salih Mustafën me 22 vjet burgim.

Mbahet protesta më e madhe pas luftës në përkrahje të liderëve UÇK-së

Më 2 prill qytetarët e Kosovës i janë përgjigjur pozitivisht platformës "Liria ka emër" për të marshuar për drejtësi, në mbështetje të liderëve të UÇK-së, ndaj të cilëve më 3 prill ka filluar procesi gjyqësor në Gjykatën Speciale në Hagë. "Marshit për drejtësi" i janë bashkuar

përfaqësues të partive politike dhe familjarët e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Përpos flamurit kombëtar, të Kosovës dhe të UÇK-së, qytetarët mbanin edhe parullat: "Liria ka emër", "UÇK-ja, krenaria jonë", "Drejtësi për çlirimtarët" etj. Sa i përket masivitetit, kjo protestë (marsh) ka qenë më e madhja në Kosovën e pasçlirimit.

Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi deklarohen të pafajshëm

Në Gjykatën Speciale në Hagë më 3 prill ka nisur procesi gjyqësor ndaj

krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Në këtë seancë Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka paraqitur fjalën hyrëse. Në të kanë marrë pjesë fizikisht edhe Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi. Para se ZPS-ja ta vazhonte paraqitjen e fjalës hyrëse, gjykatësi Çarls Smith III ka kërkuar nga të pandehurit të deklarohen sërish për aktakuzën e plotësuar për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Hashim Thaçi në deklarinim e tij ka thënë se është i pafajshëm. "Jam plotësisht i pafajshëm", ka thënë Thaçi.

Edhe Kadri Veseli është deklaruar "tërësisht i pafajshëm". "Po, gjithsesi, shpreh pakënaqësinë time për një vonesë të tillë dyvjeçare e gjysmë, megjithatë ju falënderoj. Jam tërësisht i pafajshëm", ka thënë Veseli. Edhe Rexhep Selimi është deklaruar i pafajshëm. "Jam i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës", është shprehur Selimi. Ndërsa Jakup Krasniqi ka thënë se e kupton akuzën, por është tërësisht i pafajshëm. "S'kam asnjë lidhje me pikat që i lexoi prokuroria para pak kohësh. Akuzën e kuptoj, por nuk

pajtohem, pasi nuk mbaj asnjë përgjegjësi për atë që flet akuza. Jam plotësisht i pafajshëm", ka thënë Krasniqi.

Më pas ka filluar dëgjimi i dëshmitarëve. Deri më tani janë dëgjuar 39 dëshmitarë të ZPS-së, shumica prej tyre kanë dëshmuar në seanca private. Ata që kanë dëshmuar në seanca të hapura janë "çmontuar" nga mbrojtja e liderëve të UÇK-së. Në këtë kontekst vlen të theksohet Frederic Abrahams nga organizata "Human Rights Watch". Ai ka pranuar se raportet e kësaj organizate do të duhej të shkruheshin ndryshe për UÇK-në. Dëshmitarët e tjerë në këtë proces gjyqësor do t'i japin dëshmitë e tyre kah mesi i janarit të vitit 2024.

Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë që nga 5 nëntori i vitit 2020. Ata kanë bërë disa herë kërkesë për t'u mbrojtur në liri, por një gjë e tillë nuk është pranuar nga Specialja.

Specialja liron Gucatin dhe Haradinajn

Krahas mbajtjes së seancave gjyqësore, Gjykata Speciale ka

marrë vendim për lirim nga burgu të drejtuesve të Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së. Fillimisht, më 17 tetor, Specialja ka liru kryetarin e kësaj organizate, Hysni Gucati, i cili është pritur në vendlindje, Morinë të Skenderajt, nga familjarë dhe bashkëlulftëtarë. Gucati nuk ka pranuar të deklarohej për medie, duke kërkuar të kursehet nga pyetjet e tyre. Por shumë shkurt ai u ka thënë të pranishmëve në odën e tij, se të fala kanë prej të gjithëve, madje u shpreh se ata që janë në



Hagë janë më të fortë se kurrë. “Më kurseni mundësisht. Të fala ju kanë ba tanëve. Të jeni të bindur te Zoti që ata janë më të fortë se na”, ka thënë Gucati. Ndërsa më 14 dhjetor Specialja ka liru edhe nënkryetarin e OVL-UÇK-së, Nasim Haradinaj, i cili, po ashtu, është pritur në vendlindje, Gllogjan të Deçanit, nga familjarë dhe bashkëlulftëtarë. Gucati dhe Haradinaj ishin dënuar me nga katër vjet e gjysmë burgim kinse për pengim të drejtësisë.

Apeli ul në 22 vjet burgim dënimin ndaj Salih Mustafës

Më 14 dhjetor Paneli i Apelit në Gjykatën Speciale e ka ulur në 22 vjet burgim dënimin prej 26 vjetësh për ish-komandantin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Salih Mustafa, duke e përfshirë kohën e kaluar në paraburgim. Mustafa ndodhet në Qendrën e Paraburgimit në Hagë që prej shtatorit të vitit 2020. Vendimi për ulje të dënimit është bërë me dije nga kryetarja e trupit të Apelit, Michele Picard, në sallën e gjyqit në Hagë, ku i pranishëm ishte edhe Mustafa.



Arrestime dhe bastisje nga Gjykata Speciale

Përpos dëgjimit të dëshmitarëve në rastin e liderëve të UÇK-së, lirim të Gucatit e Haradinajt dhe dënimit të Sali Mustafës, Gjykata Speciale ka arrestuar disa persona të cilët tashmë gjenden në Qendrën e Paraburgimit në Hagë. Po ashtu, gjatë këtij viti Specialja ka kryer edhe disa bastisje në Kosovë. Në muajin tetor janë arrestuar Sabit Januzi dhe Ismet Bahtjari, ndërsa në nëntor është prangosur ish-

kryetari i Malishevës, Isni Kilaj. Gjykata Speciale nuk është ndalur me kaq, pasi në dhjetor është arrestuar ish-komandanti i UÇK-së, Haxhi Shala - “Topi”. Sipas Speciales, të arrestuarit akuzohen për pengim të drejtësisë. Këto akuza janë mohuar nga Januzi, Bahtjari, Kilaj dhe Shala. Policia e EULEX-it, në bashkëpunim me Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Hagë, gjatë vitit 2023 ka bastisur banesën e familjarëve të heronjve Fahri dhe Bahri Fazliu, e cila gjendet në lagjen “Kodra e Diellit” në Prishtinë. Po ashtu, janë bastisur edhe pronat e ish-bashkëpunësorëve të Hashim Thaçit, Blerim Shalës, Bashkim Smakajt, Adil Behramajt, Artan Behramit. Atyre u janë konfiskuar pajisjet elektronike (telefona dhe i-pad). Krahas këtyre, është marrë në pyetje në zyrat e EULEX-it edhe ish-komandanti i UÇK-së në Zonën e Llapit, Rrustem Mustafa, i cili ka dëshmuar në procesin gjyqësor ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqi.

Specialja ua pezullon kontaktet Thaçit, Veselit dhe Selimit

Gjykata Speciale më 23 nëntor ka marrë vendim që Hashim Thaçit,

Kadri Veselit e Rexhep Selimit t’u pezullohet përkohësisht çdo komunikim, duke përfshirë komunikimin me familjarë dhe vizitat. Ndërsa më 4 dhjetor Specialja ka dalë me vendim përfundimtar lidhur me kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) për ndalimin e komunikimeve dhe vizitave për Thaçin, Veselin dhe Selimin. Në mesin e rregullave strikte që u janë vënë për komunikimet dhe vizitat, treshes së UÇK-së u ndalohet të përdorin pëshpëritje apo kode gjatë komunikimit. Përmes këtij vendimi, paneli i gjyqtarëve nuk ka ndaluar vizitat për liderët e UÇK-së, mirëpo ka treguar se për realizimin e tyre duhet të kërkohej miratim paraprak nga sekretari i Speciales.

Kryetarja e Speciales pritet me protestë nga PSD-ja

Partia Socialdemokrate (PSD) më 29 nëntor e ka pritur me protestë kryetaren e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova, gjatë vizitës së saj në Kosovë të mërkurën. Me thirrjen “Poshtë Gjykata Speciale”, “UÇK-ja nuk mund të gjykohej”, aktivistët e PSD-së kanë protestuar përpara hotelit “Sirius” në Prishtinë, në të cilin Trendafilova mbante takim me shoqërinë civile. Protesta ka eskaluar pasi policia ka hedhur gaz lotsjellës e më pas ka arrestuar gjashtë aktivistë të PSD-së, në mesin e të cilëve edhe Dardan Molliqaj, të cilët janë liru më vonë.

Ndërron jetë avokati i ekipit mbrojtës të Kadri Veselit

Më 12 dhjetor ka ndërruar jetë avokati Andrew Strong, i cili ka qenë pjesë e ekipit mbrojtës në Hagë të Kadri Veselit. Vdekja e avokatit ka bërë që Gjykata Speciale t’i shtyjë seancat për Thaçin dhe drejtuesit e tjerë të UÇK-së për vitin e ardhshëm. Me kërkesë të mbrojtjes së Kadri Veselit, gjyqi për krerët e UÇK-së do të rifillojë pas pushimit dimëror më 15 janar 2024. Në nderim të avokatit Strong, në Prishtinë janë ndezur qirinj.





BEHXHET SH. SHALA - BAJGORA

VETËVENDOSJE KOMBËTARE, VETËVENDOSJE JUGOSLLAVE; FILLIMI DHE FUNDI I NJË IDEALIZMI MASHTRUES

Fillimi i idealizmit, ngjizja multietnike

VETËVENDOSJES: Albin Kurti ishte spiritus movens i embrionit të formimit të Vetëvendosjes, fillimisht si KAN multietnik, pastaj Lëvizje Vetëvendosje dhe tani Parti Vetëvendosje. U dallua si një ndër udhëheqësit e Lëvizjes Studentore që protestuan për lirim të objekteve universitare të okupuara nga Serbia. Me një dukje si Bob Marly dhe me një përmbajtje rebele ishte në ballë të protestës studentore të 1 tetorit 1997 deri në çastin kur inspektori i UDB-së Kovaç e tërhoqi për flokësh duke e dhunuar fizikisht. Ishte një përballje e studentëve të veshur me këmisha të bardha kundër policëve serbë me këmisha të zeza. Studentët, përveçse kërkonin lirinë e objekteve

universitare, dolën me kërkesa politike e që ishin të njëjta me qëllimet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që ishte aktive thuaja në tërë Kosovën. Në vitin 1996 Baca Adem Demaçi e lëshoi KMDLNj-në duke e marrë drejtimin e Partisë Parlamentare të Kosovës me qëllim që të bëhet zë politik i UÇK-së. Në Partinë Parlamentare u shkrinë idealistë të çështjes kombëtare që frymonin me të njëjtin ritëm si Baca Adem Demaçi. Baca nuk pranoi të kalojë edhe unë duke këmbëngulur të qëndrojë në KMDLNj. Pavarësisht kësaj, thuaja 24 orë ishim në kontakt me Bacën Adem dhe isha në disponim që ta përkrah personalisht, familjarisht dhe si KMDLNj, bashkë me Nuhi Ahmetin dhe Avdullah Dërgutin që, në aspektin

logjistik dhe financiar, e mbulonin Bacën 100 %. Ime shoqe, Fexhrije Shala, u zgjodh anëtare e Kryesisë së Partisë Parlamentare dhe bashkë me Zaim Kurtin bënë punë të jashtëzakonshme në shtrirje dhe fuqizim të kësaj partie. Angazhim të madh kishte edhe Shashivar Makolli me familje dhe Bajrush Behrami, që të dy tash në amshim. Më 7 shtator 1998 në Prishtinë u hap Zyra e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe përfaqësues politik u emërua Baca Adem Demaçi që pati efekte të mëdha sidomos në planin diplomatik. Thuaja i tërë potenciali politik i Partisë Parlamentare të Kosovës u bë pjesë e kësaj zyre ku Skender Kastrati ishte zëvendës i Bacës Adem sikur që Albin Kurti u ofrua të bëhet pjesë e ekipit të

Bacës. Në takimin e parë me Albinin, pasi Baca ia tregoi pasojat e mundshme të cilat Albini i pranoi, por Baca e këshilloi të bisedojë me babanë, Zaimin, para se të vendosë përfundimisht. Dhe, të nesërmen, në praninë dhe me pëlqimin e plotë dhe pa asnjë hezitim të Zaimit, Albin Kurti u bë pjesë e Zyrës së Përfaqësuesit Politik të UÇK-së, duke e shoqëruar Bacën gjatë vizitave që i bënin UÇK-së dhe takimeve me ushtarë dhe komandantë lokalë dhe rajonalë. Kishte raste kur Albinin nuk e lejonin të merrte pjesë në takime (nga disa komandantë). Albini përktheu për Bacën Adem gjatë takimeve me ndërkombëtarë sikur që ishte bashkë me Bacën Adem Demaçi në takim me Robin Kuk, ministër i Jashtëm i MB-

së, kur edhe refuzuan të marrin pjesë në Konferencën e Rambujesë. Pastaj Baca Adem, Skender Kastrati, Fexhrije Shala, Albin Kurti, Milot Caka, Shashivar Makolli dhe Bajrush Behrami dhanë dorëheqje shkaku i Rambujesë dhe Zyra e UÇK-së u bë jofunksionale. Gjatë bombardimeve të NATO-së mbi caqet serbe në Kosovë, Albin Kurti u arrestua dhe u dërgua fillimisht në Burgun e Lipjanit ku u keqtrajtua jashtëzakonisht shumë dhe pastaj u dërgua në Llogorin e Pozharevcit në Serbi ku, pas një përballje me ministrin e Drejtësisë së Serbisë që kontrabandohej si gazetar, Albin Kurti u keqtrajtua, porse mbrojti një qëndrim kombëtar dhe politik pa bërë asnjë kompromis. Këtë qëndrim e rikonformoi fuqishëm gjatë

gjykimit në Nish. Realisht, periudha nga protesta studentore e 1 tetorit 1997, gjatë angazhimit në Zyrën e UÇK-së dhe derisa u lirua nga burgu, në aspektin njerëzor, kombëtar dhe politik, ishte pa vërejtje dhe nga askush nuk mund të kundërshtohet. Albin Kurtit në atë kohë nuk i mungonte vullneti dhe as guximi të përballej me çdo sfidë apo sakrificë pavarësisht prej pasojave që mund t'i kishte. Ky është mendim im dhe për atë periudhë nuk kam asnjë fakt që do të më bind ta ndryshoj qëndrimin.

KAN-i: Ky emërtim nuk është në gjuhën shqipe, por angleze, si nga përmbajtja ashtu edhe nga qëllimi. KAN u përdor nga Kurti si thithës i anëtarësisë multietnike dhe për ta fituar një legjitimitet te ndërkombëtarët. Pasardhësit e dhunuesve shqiptarë që i shërbyen Jugosllavisë dhe Serbisë u bënë zemra e KAN-it. Organizonin ndeja dhe orgji të shfrenuara. KAN-i u bë qendër për rekrutim të elementit antikombëtar dhe nuk pengoj nga organet e sigurisë shkaku se nuk ushtronin dhunë ndaj askujt dhe nuk tregonin ambicie për aktivitete politike. Ishte një vëllazërim-bashkim jugosllav, tash në Kosovën e lirë, por që përballej ende me pasojat e luftës. Albin Kurti KAN-in e përdori për ta rritur anëtarësinë duke gatuar një gjellë nga e cila do të helmohej më vonë një pjesë e rinisë idealiste dhe skena politike në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Luginë dhe Mal të Zi. Në kohën e KAN-it u krijua ajo afera e suxhikut dhe batanijes së Albinit në Klinë që shumë herë u përmend në Kuvendin e Kosovës. KAN-i ka qenë një organizim krejtësisht i pamoralshëm, i pabesë, tinëzar, i dëmshëm dhe antikombëtar.

LV: KAN-i u shndërrua në Lëvizje Vetëvendosje! ku personaliteti i Albinit ishte i barasvlefshëm me Zeusin, Zotin e të gjithë zotëve, ndërsa Zyra e tij u shndërrua në Orakull ku jepeshin mendimet për çështje kombëtare, politike, ekonomike, kulturore, letrare dhe seksuale. Prej një multietniciteti dhe multikulturalizmi që ishte në KAN, LV tash këndonte këngë të patriotizmit të rëndë për flamurin kombëtar kuq e zi, kundër flamurit të kosovapetrollit - flamurit të Kosovës, për bashkim kombëtar si kusht i domosdoshëm për mbijetesë dhe zhvillim të kombit shqiptar. Ishte kundër decentralizimit në baza etnike, kundër Asociacionit të komunave serbe që e quante Zajednicë, ndërsa unë e quaj Zajebnicë (luajtje ko..sh).

Parulla kryesore mobilizuese, vepruese dhe shkatërruese për kundërshtarët politikë dhe ata që nuk e kishin mendësinë e tyre ishte: “Jo negociata - Vetëvendosje”. Ishin kundër politikanëve kosovarë të krahut të luftës dhe të paqes duke i akuzuar se po e vidhnin dhe po e shitnin Kosovën. Ishin kundër UNMIK-ut e mos të flasim se sa ishin “kundër Serbisë”. Nuk e pranuan pavarësinë e Kosovës e as Kushtetutën e saj. Proceset politike dhe të tjera u shkonin në favor duke i faktorizuar edhe më shumë. Përkrahja e Bacës Adem Demaçi në fillim dhe e imja, në të gjitha aspektet, nga ndërtimi i PR për Albinin dhe deri te përkrahja materiale kontribuuan në ngritjen dhe forcimin e karizmës së Albinit Kurtit e që automatikisht edhe të LV-së sepse kjo Lëvizje ishte vetë Albin Kurti. Pastaj siguruan përkrahje materiale edhe nga Amerika dhe disa shtete evropiane. Është interesante se asnjëherë nuk e kanë lëshuar asnjë dëshmi për paratë e pranuar dhe se nuk kanë hezitur të marrin para edhe nga ata që publikisht i kanë sulmuar dhe etiketuar si oligarkë dhe antikombëtarë. Kanë manipuluar skajshmërisht me familjet e personave të pagjetur, pa pikë empatie dhe pa pikë morali. Kanë ushtruar dhunë mbi Policinë e Kosovës e para policëve ndërkombëtarë nuk janë dëgjuar fare. Dhe, pas kësaj, vendosën të marrin pjesë në zgjedhje që mbaheshin sipas Pakos së Ahtisarit të cilën nuk e pranonin fare. U bënë edhe deputetë, shumë aktivë në Kuvend, duke dhunuar thuaja të gjitha institucionet, sidomos politikanët që ishin në pozitë. Caqe të preferuara ishin udhëheqësit politikë dhe ushtarakë të UÇK-së, tash udhëheqës të shtetit të Kosovës. Gjuajtën me vezë, shishe uji, gaz lotsjellës, mjete të forta, kubëza dhe gurë derisa e sulmuar edhe Kuvendin e Kosovës me granatahedhës. Nga perspektiva e kaluar mendoja se këtë po e bëjnë për të penguar procese të dëmshme për Kosovën ndërsa sot, me faktin se i kanë shkelur të gjitha në emër të të cilave ushtronin dhunë, qartazi po del se e kanë bërë për të ardhur në pushtet. Dërguan aktivistë në vrasje dhe vetëvrasje pastaj manipuluan me familjet dhe fatkeqësitë e tyre. Edhe sot po manipulojnë, natyrisht me përkrahje të familjarëve të varrëve dhe të atyre që janë vetëvarrë. E kanë bërë spastrimin klasik të trurit. Kanë ofruar shtet me të drejta dhe barazi sociale, e kanë shndërruar në shtet të lëmoshës, të dhunës ndaj të gjithë atyre që nuk ndajnë mendimet me ta duke e privuar rininë, jo vetëm rininë nga një të ardhme të cilën po e

kërkojnë anekënd botës, vetëm jo në Kosovë.

Qeveria projugosllave Kurti 1 e sidomos Kurti 2: Në mandatin e qeverisë Kurti 1, koha për të bërë diçka të mirë ishte e shkurtër, pastaj edhe pandemia e bëri punën penguese. Në të njëjtën kohë votat ishin të pamjaftueshme për ta marrë pushtetin absolut andaj hynë në koalicion me “profesorin e nderuar, Isa Mustafa” deri dje i brohorisnin: “Isë, Isë argat i Serbisë dhe Isa - Hasha, Esat Pasha”. Administrata amerikane me presidentin Tramp kishte vendosur “thikat mbi hartën e Kosovës...” sipas Kurtit, mirëpo të vetmin dëm e pati se e rrëzuan qeverinë Kurti 1. Realisht qeveria Kurti 1 fitoi më së shumti nga ky rrëzim. Opozita bëri gabim amator në aspektin moral duke e rrëzuar qeverinë Kurti 1 në kohën e pandemisë, ndërsa politikisht pse nuk u bë bashkë për zgjedhjet e radhës. Në këtë qeveri Kurti filloi ta mbushë qeverinë me projugosllavë dhe proserbë duke e bërë një distancim nga përcaktimi kombëtar. Si bingo për qeverinë Kurti ishte arrestimi i heronjve të luftës dhe ndërtuesve të shtetit që ende po mbahen peng në Burgun e Hagës. Konkurrenca u eliminua politikisht edhe me ndihmën e qeverisë Kurti.

Qeveria puro jugosllave Kurti 2: Fushata zgjedhore ku Kurti, bashkë me renegaten Vojsa Osmani, fitoi mbi 51 për qind të votave, ishte tipike gebelsiane; luftim me të gjitha mjetet e mundshme e kundërshtarëve që i konsideronte si armiq, futjen e sasive të mëdha të parave të sekserëve milionerë si Martin Berishaj që pastaj u bë ambasador, ngritja e një rrjeti medial përmes medieve të Jeton Qurroit, një projugosllav i thekur dhe pasionant të cilin pastaj e shpërbleu duke e bërë si Çezare Borxhian e qeverisë, një këlysh ia bëri ambasador sikur që edhe një familjar ia bëri këshilltar kryesor. E mbyti gjithandej frymën kombëtare me mbeturina të UDB-së, KOS-it, jugosllavëve dhe serbëve. Nga LV-ja e dikurshme që, së paku, verbalisht deklarohet si kombëtare, nuk mbetën as gjurmët. Kuvendi u bë si Shou i Mapetëve dhe, krahasuar me përbërjen e mëhershme të deputetëve të LV-së, këta të tashmit apo pjesa më e madhe, përveçse janë injorantë me fletë, në aspektin kombëtar janë mbetje të politikës shtypëse ndaj shqiptarëve. Ka përdorues të narkotikëve, budallenj të certifikuar dhe të poshtër me vërtetim të noterizuar. E pabesueshme, nga një lëvizje kombëtare që më parë i kam besuar 100 për qind, i kanë besuar 51 për qind të votuesve, u bastardua në një monstrum kundërkombëtar, hakmarrës

dhe përjashtues, në radhë të parë ndaj opozitës si dhe ndaj përkrahësve të djeshëm dhe mospajtuesve të sotëm. Në qeverinë Kurti 2 nuk bëhet garë se kush është më i miri, por se kush do të jetë injoranti numër 1 dhe kështu me radhë. Edhe ata që kanë trashëguar një të kaluar kombëtare, sot po e turpërojnë këtë trashëgimi dhe kujtim. Burrat e ministreshave sot ndajnë tenderë në ministri, të afërmit e ministrave përfitojnë tenderë, poste diplomatike, vende në borde dhe.. paprekshmëri para ligjit. Persona me simptoma të rënda të çrregullimeve mendore sot janë bartës të posteve të rëndësishme. Mbi 200 000 qytetarë jetojnë me më pak se 2 euro në ditë, ndërsa me dhjetëra mijëra, kryesisht të rinj, janë larguar nga Kosova. Ata që dje ua çollomitnin kokën policëve të Kosovës dhe përpilonin lista Wanted (si në perëndimin e egër) edhe sot e kësaj dite dhunojnë policët, tash me mjete politike dhe ekonomike. Urrejtja ndaj bartësve të luftës çlirimtare dhe krijuesve të shtetit sa po bëhet më intensive, nuk lëshohet rast pa i sulmuar dhe pa i dëmtuar edhe sa janë në burg. Në planin ndërkombëtar nuk siguruan asnjë njohje përveçse e denoncuan Trampin te Bajdeni pasi ky i fitoi zgjedhjet. Tash as Bajdeni nuk u pëlqen, sigurisht do ta denoncojnë te Trampi pasi ky do t'i fitojë zgjedhjet e ardhshme! Fort u angazhuan në Ukrainë dhe kundër Rusisë e cila qëmoti do të dorëzohej nga presioni i Besnik Rrencit dhe renegates Osmani, qoftë duke i vendosur sanksione ekonomike, qoftë duke e paralizuar politikisht ndërkombëtarisht. Luftën në Ukrainë e cilësuan si gjenocid nga Rusia, kurse Putinin si kryekriminel të krimeve të luftës. Ndërkaq, gjenocidin e Izraelit në Gaza, në krye me kriminelin e luftës, Benjamin Natanjahu, në të cilin janë vrrarë mbi 20 000 palestinezë dhe ku shkalla e shkatërrimit e tejkalon 85 për qind, nuk kanë guxim ta cilësojnë si gjenocid, por e arsyetojnë si e drejtë legjitime e Izraelit për ta luftuar Hamasin. Sa të poshtër dhe të panjerëzishëm! Shkaku i interesave politike, biznesore dhe se fëmijët i kanë dërguar (me para të shtetit) të studiojnë atje!

Kryeministri i qeverisë projugosllave, Albin Kurti: Albin Kurti i sotëm nuk ka asgjë të përbashkët me Albin Kurtin e djeshëm, ose pushteti e ka shpërfytyruar shumë, ose sekuencimi i roleve për marrje të pushtetit ia ka fshehur fytyrën dhe karakterin e vërtetë. Sot nuk i intereson bashkimi me Shqipërinë e as flamuri kombëtar. Nga duaje tënden (Shqipërinë), u dashurua më shumë me Norvegjinë. Nga të

qenit përbashkues i të gjitha forcave politike, u bë përçarësi më i madh në Kosovë, Luginë të Preshevës, Mal të Zi, Shqipëri dhe, së voni, e ka lëshuar spirancën e urrejtjes dhe të përçarjes edhe në Maqedoni të Veriut. Nga një “nxënës politik i Adem Demaçit”, u shndërrua në një pion të Jeton Qurroit. Nga një çkapës elektoral, u shndërrua në një megakapës real institucional. Nga një luftëtar për bashkim me Shqipërinë, me Marrëveshjen e Brukselit dhe bishtin e Ohrit, Kosovën po e afron me Serbinë. Albin Kurti, si spiritus movens dhe garantues suprem i Partisë VETËVENDOSJE!, i ka pasur të gjitha mundësitë të bëhet politikani që realisht do të ishte Hasan Prishtina i ditëve tona. Inteligent dhe i mençur, pa asnjë dyshim, me një mbamendje fotografike, orator i mirë, politikan me përvojë thuaja 20-vjeçare, bonvivan i vonuar, i përkrahur nga më shumë se 50 për qind të votuesve, pa një opozitë penguese, me një reputacion të pranuar nga shumica e shqiptarëve, me asgjë i penguar nga ndërkombëtarët ishin parakushte të arrijë majat. Mirëpo, urrejtja ndaj bartësve të luftës dhe të posteve kryesore shtetërore që po mbahen si pengje në Hagë që e bënë luftën dhe e bënë shtetin, hatërmbetja, arroganca e numrave, shpërfillja e skajshme e opozitës, ndjenja e theksuar e hakmarrjes, dëshira pasionante për të kontrolluar çdo gjë dhe për të nënshtruar gjithkënd dhe, mbi të gjitha, ndjenja e madhështisë, e zhveshën Albinin nga mundësia e vendosjes në panteonin e patriotëve shqiptarë. Çfarë tash? Albin Kurti ka deputetë dhe ministra që Kosovën e kanë atdhe të dytë, një vend pune dhe mundësi të pasurohen e pastaj; Rozeta Hajdari mund të shkojë në Indi, Donika Katran Gërvalla në Gjermani, Vojsa Osmani në Australi, Besnik Bislimi në Serbi, Hajrullah Çeko në Turqi, Hekuran Murati në Rusi, si kontabilist i mercenarëve të Wagnerit, Xhelal Sfeqla në Izrael, Elbert Krasniqi në Egjipt, Nenad Rashiqi në Shqipëri etj. Nuk po shoh se ka shqiptarë që edhe as për së afërmi i ngjajnë dhe trashëgojnë vlerat njerëzore, kombëtare, politike, morale dhe ato të sakrificës si të Bacës Adem Demaçi dhe komandantit legjendar Adem Jashari që ishin dy shtylla që mundësuan lirinë e shqiptarëve dhe që janë edhe sot engjëj mbrojtës të kësaj lirie, vetëdije dhe ndërgjegjeje kombëtare. Ne të tjerët silleshim rreth tyre, disa si kontribuues, tjerët si pengues. Gëzuar dhe urime për Vitin e Ri 2024, kësaj radhe nga Kosova, në vitin tjetër, ndoshta, nga baushtella apo ndonjë kamp refugjatësh!



Kosova është shndërruar më shumë në një shtet social sesa në një shtet zhvillimor

Njohësi i çështjeve ekonomike, ish-kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ka thënë se viti 2023 ishte një vit me përplot sfida. Ai ka theksuar se ekonomia gjatë këtij viti ka mbetur nën hijen e dialogut Kosovë - Serbi. Gërxhaliu ka thënë se viti 2023 do të mbahet mend për masat që BE-ja ia vendosi Kosovës, të cilat e kanë dëmtuar Kosovën në aspekt ekonomik dhe politik. Sipas tij, Kosova tashmë është shndërruar më shumë në një shtet social sesa në një shtet zhvillimor. Ai ka thënë se është shqetësuese se nuk kemi investime dhe investitorë të huaj

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR

“Epoka e re”: Gërxhaliu si e karakterizoni vitin 2023 sa i përket zhvillimit ekonomik?

Gërxhaliu: Viti 2023 ka qenë vit me përplot sfida. Agjenda politike ka dominuar në Kosovë. Hapësirë më të madhe mediale dhe orientuese ka pasur dialogu Kosovë - Serbi. Në këtë drejtim ekonomia ka mbetur nën hijen e kësaj dominance politike. Do të isha personi më i lumtur t'i numëroja sot efektet pozitive apo trendet pozitive ekonomike në Kosovë. Kemi pasur një vit të inflacionit, ngritje të çmimeve, ngrirje të pagave qoftë në sektorin publik apo atë privat, rënie të eksporteve dhe të

importeve. Këto besoj janë karakteristikat që e karakterizojnë këtë vit, dhe kur krejt kësaj i shtohet fakti që mungesa e stabilitetit politik e ka dëmtuar Kosovën përballë investitorëve dhe investimeve të huaja, është një argument shtesë. Si rezyme shqetësuese është fakti se viti 2023 do të mbahet mend për masat që BE-ja ia vendosi Kosovës, do të thotë masa të cilat e kanë dëmtuar Kosovën në aspekt ekonomik dhe politik, mbi të gjitha emocional. Masa të tilla në të kaluarën ka pasur vetëm Serbia në vitet e errëta '90. Sot kanë Rusia, Bjellorusia dhe Irani, prandaj besoj se për qytetarët e Kosovës është një njollë e cila ka dëmtuar imazhin e Kosovës. Dhe ajo çfarë vërtet është

shqetësuese është fakti se Kosova po zbrazet çdo ditë e më tepër dhe që nga 1 janari besoj se do të ketë një fluks më të madh të ikjes nga Kosova por, përveç brengës së ikjes së qytetarëve, është brenga e ikjes së kapitalit të bizneseve të Kosovës. Ishte një vit me mungesë të dialogut publiko-privat, një distancë e komunikimit mes pozitës dhe opozitës, mangësi e komunikimit mes nivelit qendror dhe atij lokal dhe në veçanti moskoordinim i aktiviteteve sa i përket politikës sociale. Prandaj, besoj se është një vit që duhet të mësohet më shumë dhe mësimi kryesor është që nuk mund të ketë zhvillim ekonomik pa stabilitet politik. E besoj se dialogu nuk ka

alternativë.

“Epoka e re”: Ju gjatë vitit që lamë pas keni qenë mjaft kritik ndaj pushtetit dhe opozitës. Si e keni parë përballjen mes këtyre dy palëve në aspektin ekonomik?

Gërxhaliu: Gjatë vitit që lamë pas vërtet e kemi pasur një opozitë e cila ka qenë shumë më tepër e gatshme për t'iu gëzuar dështimeve të pozitës sesa të jetë kritike dhe aktive në korrigjimin e kësaj qeverie. Është e vërtetë se me një opozitë sterile të tillë do t'i mundësohet pozitës apo qeverisë aktuale të udhëhequr nga Vetëvendosje një fitore në cilado zgjedhje që do të mbahen në të ardhmen, prandaj në këtë drejtim besoj duhet të kuptohet e vërteta që Kosova është e të gjithëve dhe roli i opozitës është jo vetëm të jetë vëzhguese, por të jetë një zë kritik në emër të qytetarëve dhe të votuesve. Në fund të fundit, nuk duhet t'i gëzohemi dështimit të Kosovës, por sukseseve të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim kemi më shumë arsye për brengosje se krenari, sepse kemi dështim në aspektin politik, kemi dështim në aspektin diplomatik, kemi trende

negative ekonomike dhe sociale. Besoj se të gjitha këtyre fenomeneve iu gëzohet opozita, gjë e cila e dëshmon një papjekuri që nuk korrespondon me partitë shtetformuese çfarë janë LDK-ja dhe PDK-ja. Nuk është zgjidhje e të gjitha problemeve vetëm dërgesa e disa ligjeve në Gjykatën Kushtetuese, por vërtet debat konstruktiv nuk kemi pasur dhe, si duket, dy partitë më të mëdha shumë më tepër janë marrë me aktivitete për ta gjetur rrugën e humbur drejt ardhmërisë sesa për të qenë një opozitë konstruktive, opozitë e cila me angazhim do të kontribuojë në zhvillim ekonomik të Kosovës, stabilitet politik, diplomaci aktive. Në fund të fundit, Kosova është e të gjithëve dhe jo vetëm e pozitës aktuale.

“Epoka e re”: Qeveria gjatë 2023-s ka ndërmarrë disa vendime që janë mirëpritur nga qytetarët si thirrja publike për subvencionim të pajisjeve eficiente për ngrohje për shtëpi dhe banesa dhe disa skema sociale?

Gërxhaliu: Nëse bëhet një analizë më e thellë e vitit 2023 definitivisht është një vit ku ka

dominuar aspekti social. Është e vërtetë që në një shtet ku kemi një orientim të tillë, politika sociale të jetë dominuese. Kemi një minimizim të vlerës së sektorit privat, kemi mungesë vizioni për një qëndrueshmëri ekonomike dhe një garanci drejt ardhmërisë. Për këtë arsye e pranuar apo jo të vërtetën, Kosova është shndërruar më tepër në një shtet social sesa në një shtet zhvillimor. Nuk kemi të bëjmë këtu vetëm me thirrje publike për subvencionim të pajisjeve efçente apo për disa skema sociale, por në përgjithësi orientimet buxhetore për vitin 2024 janë të drejtuara në këtë drejtim. Kjo është një qasje e cila nuk garanton stabilitet ekonomik dhe në qoftë se një shtet nuk ka stabilitet ekonomik dhe një vizion për stabilitet ekonomik, është topike të arrihen stabiliteti social, politik dhe të përshpejtohen proceset integruese e të jemi të përshpejtuar në përmirësimin e imazhit të Kosovës. Një politikë e tillë është më tepër ad-hoc sesa zhvillimore. Lind gjithmonë pyetja çka kur të shpenzohen këto ndihma të ofruara dhe a mund të mbijetojë shteti vetëm me skema sociale? Duhet vërtet të jemi të orientuar drejt një ekonomie me të zhvilluar. Pra, një ekonomi ku partneriteti me sektorin privat duhet të jetë shumë më aktiv dhe konstruktiv. Paramendoni të gjitha këto mjete të ishin orientuar në projekte të ndryshme në mbështetje të sektorit privat me siguri se do të kishim një stabilitet social shumë më të madh. Do të kishim punësim, eksporte, përmirësim të imazhit dhe jo ikje nga Kosova, por qëndrim të rinjve në Kosovë. Prandaj, tentativa për barazi në varfëri besoj është qasja më e gabuar që e dëmton Kosovën sot, por që

do ta ketë efektin negativ edhe në të ardhmen. Prioritet i prioritetëve gjithmonë duhet të jetë dhe është koha kur duhet të kuptohet rëndësia e zhvillimit ekonomik, një zhvillim ekonomik i ndërtuar në partneritet të mirëfilltë dhe jo me arrogancë të pushtetit përballë sektorit privat.

“Epoka e re”: Ku mendoni se ka pasur ngecje dhe zhvillim?

Gërxhaliu: Një ndër ngecjet më të mëdha janë masat e Bashkimit Evropian të cilat e kanë dëmtuar Kosovën në pole të ndryshme dhe besoj se vetë fakti që sot nuk kemi investitorë dhe investime të huaja është brenga më e madhe. Kjo e dëshmon Kosovën si një vend i pasigurt, e shndërron Kosovën në një vrimë të Ballkanit Perëndimor, sepse në qoftë se analizohen vendet e rajonit, qoftë Maqedonia, Shqipëria, Mali i Zi, Bosnja apo Serbia, ka investime të shumta, ndërkaq në Kosovë të vetmet investime janë ato që vijnë nga diaspora, duke blerë patundshmëri shumë më tepër. Në këtë drejtim, falë një mungese të një koordinimi të mirëfilltë të aktiviteteve, jemi këtu ku jemi. Krahas këtyre problemeve të krijuara kemi një dështim në aspektin e diplomacisë ekonomike dhe për këtë besoj se duhet të bëhet shumë më tepër.

“Epoka e re”: Edhe këtë vit nuk ka pasur interesim të investitorëve të huaj në vendin tonë. Pse?

Gërxhaliu: Viti 2023 do të jetë një ndër vitet më karakteristike sa i përket investimeve dhe investitorëve të huaj, për faktin se është shqetësuese se nuk kemi investime dhe investitorë të huaj, por është një brengë tjetër që nga Kosova është duke u derdhur kapitali i sektorit

privat, sepse vërtet këtu mungon një vizion i mirëfilltë për zhvillim ekonomik, mungon një përkrahje e mirëfilltë, mbi të gjitha frikësohem që biznesi dhe sektori privat shikohen shumë më tepër për t’u penalizuar dhe gjykuar sesa për t’u ndihmuar. Një qasje e tillë dhe një promovim i tillë i një politike joproduktive dhe jo pro ekonomisë e dëmton Kosovën në fusha të ndryshme. Në anën tjetër ju e dini që kemi një kundërshtarë çfarë është Serbia, e cila e ka një diplomaci të zhvilluar dhe çdo qasje apo momentum të Kosovës në aspektin negativ e zmadhon dhe e ekzagjeron, e promovon kudo aty ku ka mundësi dhe vërtet investitorët po largohen apo në një lloj forme po e pasojnë Kosovën. Vetë fakti që po flasim për investime të huaja dhe kemi shumë pak investime direkte në prodhim, në teknologji, në edukim nga diaspora e dëshmon më së miri brishtësinë e cila e ka kapluar Kosovën sa i përket stabilitetit politik. Pa stabilitet politik është utopike të mendohet ardhja e investitorëve të huaj dhe kur dihet fare mirë që kemi dhe barriera sa i përket tregtisë mes Kosovës dhe Serbisë, mirëpo kemi barriera të shumta me vendet e tjera të rajonit. Kosova vërtet po e humb atraktivitetin të jetë një destinacion i dëshiruar për investitorë dhe investime të huaja.

“Epoka e re”: Liberalizimi i vizave sa do të ndikojë në ekonomi?

Gërxhaliu: Sa i përket liberalizimit të vizave besoj se është një ëndërr të cilën qytetarët e kanë pritur. Është një vendim i vonuar, por besoj i argumentuar. Në aspektin ekonomik besoj se do të ketë ndikim te sektori privat në Kosovë. Duhet të pranohet e

vërteta që Kosova nuk u zbraz vetëm nga ky vit, por ka filluar me vite të tëra. Të fundit që po braktisen nga Kosova nuk po ikin vetëm të papunët dhe skamnorët, por po largohen edhe familje me një stabilitet ekonomik dhe social, sepse e kanë brengën e edukimit, të shëndetësisë, e kanë brengën e sigurisë së perspektivës dhe shumë mënyrave të tjera të cilat ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe për këtë arsye mendoj se në një aspekt kohor afatshkurtër do të kemi një tentativë për t’u larguar nga Kosova. E tëra kjo do ta ketë koston e vet ekonomike jo vetëm që do të ketë nevojë sektori privat, por këta që mendojnë për t’u larguar do të krijojnë edhe humbje të shumta ekonomike dhe ky do të jetë një dëm. Mirëpo duhet të kuptohet e vërteta që kanë munguar kampanja vetëdijësuese që t’i ndalin të rinjtë këtu. Në rend të parë duhet të kuptohet që Evropa nuk është ajo që ka qenë më parë dhe sot disa shtete evropiane janë në një recension ekonomik dhe kjo e dëmton pozitën e tyre. Në anën tjetër, besoj se duhet të kontrollohet komunikimi i pushtetarëve të Kosovës të cilët Kosovën e paraqesin si një shtet të përkohshëm. Çdo ditë kemi paralajmërime për luftë dhe për konflikt dhe jo për avancim të dialogut dhe stabilitet politik, dhe kur këto fjalë dominojnë atëherë vetvetiu krijohet një panik apo një ankth i cili i bën t’i mendojnë qytetarët të largohen nga Kosova. Duhet shumë punë për të bërë për të qëndruar në Kosovë. Krejt kësaj kur i shtohet një fakt tjetër që ne kemi zyrtarë shumë të lartë qeveritarë të cilët e argumentojnë migrimin e kosovarëve si kinse edhe evropianët migrojnë. Besoj është një prononcim shumë i

rrezikshëm. Ky gabim është i rrezikshëm nga fakti se vendet evropiane nuk e kanë armik Serbinë siç e ka Kosova dhe nuk e kanë një akademi të shkencave serbe siç e ka Serbia e cila harton drafte dhe strategji për ta zbrazur Kosovën, sepse për armiqtë vetëm Kosova e zbrazët është Kosovë e mirë dhe e dëshiruar. Për këtë arsye duhet të kemi kujdes me deklaratat dhe të punohet më tepër që të kthehet besimi i humbur nga qytetarët e Kosovës për të jetuar në Kosovë.

“Epoka e re”: Çfarë prisni në vitin 2024 për ekonominë?

Gërxhaliu: Besoj se viti 2024 do të jetë një vit i bartjes së sfidave ekonomike të vitit 2023. Shumë probleme po lëngohen dhe nuk zgjidhen. Sot në Kosovë kërkohet shumë më tepër arsyetim për dështime sesa për të gjetur rrugë për të dalë nga dështimi. Viti 2024 do të jetë vit i agjendës politike nëse analizohen projeksionet e buxhetit për vitin 2024 dhe një vit i orientimit social. Buxheti është i orientuar më shumë në zgjedhje sesa në zhvillim ekonomik. Prandaj do të ketë sfida të shumta, megjithatë ky është realiteti me të cilin duhet të ballafaqohemi. Mendoj se është momenti kur institucionet duhet të reflektojnë, në rend të parë me një politikë pro sektorëve privatë, në rend të dytë me një politikë pro ekonomisë dhe me një qasje më të mirë diplomatike në mënyrë që të inkurajohen investitorët dhe investimet e huaja, duke përfshirë edhe ato të diasporës. Nuk jetohe vetëm nga konsumi. Mendoj se nëse çdo indikator ekonomik në Kosovë do të vazhdojë të ndërtojë mbi konsumin, atëherë do të jetë një vit i dështuar ekonomik, si ky që po lëmë pas.





Shkruan: Dr. Edita TAHIRI
Ish-zëvendëskryeministre dhe kryenegociatore

Përgjegjësia për shtetin dhe një hero tragjik

Njohësi i çështjeve ekonomike, ish-kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ka thënë se viti 2023 ishte një vit me përplot sfida. Ai ka theksuar se ekonomia gjatë këtij viti ka mbetur nën hijen e dialogut Kosovë - Serbi. Gërxhaliu ka thënë se viti 2023 do të mbahet mend për masat që BE-ja ia vendosi Kosovës, të cilat e kanë dëmtuar Kosovën në aspekt ekonomik dhe politik. Sipas tij, Kosova tashmë është shndërruar më shumë në një shtet social sesa në një shtet zhvillimor. Ai ka thënë se është shqetësuese se nuk kemi investime dhe investitorë të huaj

Kur shtetet ofrojnë kushte të mirëqenies, siguri, prosperitet për popullin e tyre si dhe avancim në marrëdhënie ndërkombëtare atëherë ekziston përgjegjësia për shtetin nga ana e qeverisë që, sipas Kushtetutës, obligohet për këtë përgjegjësi. Por Kosova nuk e pati dhe nuk e pa përgjegjësinë për shtetin nga qeveria aktuale gjatë këtij viti që e lëmë pas.

Në fakt, Kosova ishte e nënshtruar, e sulmuar, e ndëshkuar dhe e dështuar gjatë tërë vitit 2023. Qeveria dhe Kurti si kryeministër vunë pushtetin para shtetit. Me populizëm, dinakëri dhe dyfytirësi, që i mundësuan pushtet dhe më pas duke shkelur të gjitha premtimet e bëra ndaj votuesve, humbi shpresa në sytë e atyre që i besuan, ndërsa zhgënjimi është duke u rritur në përmasa

dramatike.

Dështimi më i madh ishte përballja me armikun serb në dialogun e Brukselit. Kurti e dështoi Kosovën, bëri dështim historik, duke bërë marrëveshje me Serbinë pa njohje reciproke në shkurt të 2023-s. Edhe pse e kishte letrën e presidentit amerikan Bajden, e cila thoshte se dialogu i Brukselit ka në qendër njohjen reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë, Kurti nuk ishte i zoti ta realizojë këtë përkrahje të fuqishme nga shteti më i fuqishëm në botë. Ndonëse bëri çmos ta mbajë të fshehur atë marrëveshje, por edhe të gjitha të tjerat, me logjikën e strurit, mendoi se nuk do të dalin të vërtetat e dështimit të tij.

Çka është më e keqja, dogji Kuvendin e Kosovës mbi bazën e kundërshtisë së asociacionit që i

solli pushtet, madje 50 % pushtet, ndërsa pastaj e pranoi asociacionin, e mbajti të fshehur gjatë tërë kohës deri në fund të tetorit 2023 kur e pranoi hapur se kishte pranuar ta bëjë draftin e statutit të asociacionit në Bruksel, në takimin e ndërmjetësve të ri të dialogut të Brukselit, Macron, Scholtz dhe Meloni. E pranoi hapur gjoja sikur asnjëherë nuk kishte qenë kundër saj. Me një hipokrizi tipike për të vazhdoi të flasë për këtë çështje. Ndërkohë me një diskurs lufte u mundua të krijojë psikozën e frikësimit të përkrahësve të vet, për t'i bërë që të mos shohin qartë kompromiset e mëdha që po i bënte ndaj armikut serb.

Por jo vetëm kaq, Kurti jo vetëm që pranoi asociacionin, por i dha autonomi pakicës serbe në Kosovë përmes konceptit të

“vetëmenaxhimit” duke iu ofruar vetëqeverisje lokale serbe për serbët pakicë në Kosovë. Termi vetëmenaxhim nuk ekziston në Kushtetutën e Kosovës, pra është një parim kundër-kushtetues.

Kur ndërkombëtarët, respektivisht BE-ja si ndërmjetëse, shpalosi draft-statutit para liderëve të opozitës dhe para neve që kishim rast ta shohim, dolën në shesh kompromiset e mëdha të Kurtit. Ai, në fakt, me populizmin e vet e kishte pasur plotë gojën sovranitet, ndërsa duke përfshirë Rezolutën 1244 në statutin e asociacionit, ai ia kishte dorëzuar sovranitetin UNMIK-ut dhe Kosovën e kishte lënë pa sovranitet në raport me asociacionin e pakicës serbe.

Kosova sovraane dhe e pavarur që nga 2008, e konfirmuar ligjërisht nga Gjykata Ndërkombëtare për drejtësi në 2010, erdhi në situatë ta humbë sovranitetin nga një kryeministër i padijshëm, i paafte, por edhe me mangësi strategjike që mbeten të panjohura për arsyet e vërteta. Si autore e shkrimit nuk më takon mua t'i them arsyet, por analistët duhet të hulumtojnë dhe ta thonë hapur. E vërteta e hidhur është se Kurti nuk

mbrojti për interesat shtetërore dhe kombëtare në dialogun e Brukselit. Një bashkëpunëtor i ngushtë i Kurtit thoshte dikur: “Kush e pranon asociacionin është tradhtar”, mirëpo tash ka mbyllur gojën. Sepse hipokrizia është tipike e të tillëve.

Tutje sovraniteti shtetëror i Kosovës u cenua edhe me faktin se statuti i asociacionit parasheh mekanizmin e “arbitrazhit” që nënkupton se kur asociacioni i pakicës serbe ka mospajtime me Qeverinë e Kosovës, atëherë BE-ja i zgjidh këto konteste, pra BE-ja në këtë rast bëhet “sovranja” e shtetit të Kosovës, që e fituam me luftë, diplomaci dhe gjakun e derdhur të shqiptarëve të Kosovës. Në një mënyrë asociacioni i jepet si një “ministri e jashtme e vogël” me faktin se do të ketë qasje në BE, sipas draft-statutit të pranuar nga Kurti.

Me fjalë të tjera, statuti i asociacionit e krijon “republika srpskën” në Kosovë.

Po pse të habitemi për këto dështime të Kurtit? Kurti është ai që nuk dha asnjë kontribut për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës, nuk mori pjesë në luftën e UÇK-së, as në luftën paqësore të LDK-së, ndonëse e kishte moshën e duhur për të

POSAÇËRISHT PËR “EPOKËN E RE”

Politika e jashtme e Republikës së Kosovës në vitin 2024



Shkruan: Valon MURTEZAJ

Derisa po hyjmë në vitin e ri 2024 kemi të drejtë mendojmë se si do të jetë ky vit për Kosovën dhe politikën e jashtme të saj.

Fjala e parë që na vjen ndër mend është se ky vit do të jetë sfidues për shtetin e Kosovës. Por, në të njëjtën kohë, angazhimi i institucioneve qeverisëse të Republikës së Kosovës duhet të jetë i tillë që të krijojë mundësi për Kosovën në arenën ndërkombëtare.

Kontekstet shumë komplekse globale dhe evropiane kanë ndikim të paevitueshëm edhe për Kosovën dhe shtetësinë e saj. Agresioni i Rusisë në Ukrainë, politikat e zgjerimit të Bashkimit Evropian, zgjedhjet në Bashkimin Evropian (BE), padyshim që kanë ndikim direkt në

politikën e jashtme të Kosovës në vitin 2024.

Arena primare e angazhimeve të politikës së jashtme do të duhej të jetë konsolidimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. Kjo do të thotë se Kosova të njihet nga shtete të reja, të ketë thellim të marrëdhënieve diplomatike me shtetet që aktualisht e kanë njohur Kosovën dhe, po ashtu, të ketë anëtarësime në organizatat e ndryshme ndërkombëtare. Njohjet nga pesë vendet e Bashkimit Evropian (Greqia, Rumania, Qipro, Sllovakia, dhe Spanja) mbeten sfida të vështirë, në të njëjtën kohë mundësi e artë për Kosovën. Anëtarësimi në Këshillin e Evropës do të ishte arritje e madhe për Kosovën nëse kjo do të ndodhte në vitin 2024.

Prandaj, në mënyrë specifike këtu do të duhej të ishte angazhimi i fuqishëm dhe i plotë i Kosovës për të avancuar në këtë drejtim.

Diplomacia publike dhe dimensionet e tjera të diplomacisë duhet të jenë përkrahëse dhe të zhvillohen me intensitet dhe mençuri dhe përgatitje në mënyrë që efekti të jetë global.

Sidoqoftë, Republika e Kosovës tanimë është në hartën e shteteve të pavarura të botës, dhe rruga e saj për forcim të pozicionit në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare sado e vështirë të jetë, do të jetë e suksesshme. Gëzuar 2024!

***Autori është profesor i negociimit dhe diplomacisë në Paris të Francës**

qenë pjesë. Ai u mjaftua me protesta.

Në të njëjtën kohë premtoi reciprocitetin për shqiptarët e Luginës e Preshevës, por nuk e bëri, e dështoi, sepse Marrëveshja bazë në mes të Kosovës dhe Serbisë, e 27 shkurt 2023, nuk përmban reciprocitetin.

Po, në fakt, Kurti tha “nuk shkoj në dialog me Serbinë pa kërkuar Serbia falje për gjenocidin në Kosovë, nuk bëj kompromise, nuk e pranoj asociacionin”, e shumë të tjera premtime që dolën boshe. Në një intervistë me Grida Dumën në “Top Story”, në qershor 2023, kur i thashë se Kurti ishte i kufizuar mes populizmit dhe shtetit, duke vënë pushtetin para shtetit, ai i harroi dhe i la të gjitha premtimet ndaj atyre të shkretëve të LV-së që i besuan. Grida e përmbledhi bukur politikën populiste. Ajo tha: “Njëherë po po po, pastaj jo jo jo”.

Jo vetëm kaq, Kurti ishte ai që premtoi bashkimin kombëtar pastaj e pranoi se nuk mundet ta bëjë, madje shkoi në Lezhë, te varri i Skënderbeut tha publikisht: “Nuk mund ta bëj dot bashkimin kombëtar se nuk e lejon Kushtetuta”. Aq i besuan atij sa nëpër Shqipëri i krijuan edhe disa degë të LV-së; tani kanë mbetur rrugëve disa që u bënë kryetarë të këtyre degëve. Mirëpo, më e rëndë është ndëshkimi amerikan për Kosovën, pasi që Kurti shkeli

premtimet dhënë amerikanëve. Amerika u dha përkrahje zgjedhjeve lokale në pjesën veriore të Kosovës sepse ato ishin legale. Mirëpo Amerika kërkoi nga Kurti që hyrja e kryetarëve të zgjedhur në zyrat e tyre komunale të bëhej në mënyrën “teknike” dhe jopolitike. Kurti e bëri të kundërtën, e realizoi me manifestime politike hyrjen e kryetarëve në zyrat e tyre. Në vend se t’u kërkojë falje amerikanëve, Kurti vazhdoi me populizëm t’u hedhë hi syve të militantëve të vet, duke mos treguar se çfarë shkelje bëri. Pas kësaj shkelje që u bëri amerikanëve,

pasuan ndëshkimet e Amerikës ndaj Kosovës. Amerika ndëshkoi Kosovën jo pse deshi, por sepse Kurti e meritoi. Ishte ky një dështim kombëtar dhe strategjik i Kurtit. Amerika, aleatja jonë strategjike, me të cilën kishim krijuar aleancën strategjike në vitin 1992, atëherë kur presidenti Bush kërcënoi Serbinë e Millosheviqit, se nëse përshkallëzon dhunën në Kosovë, Amerika do të intervenojë, e njohur si “Kërcënimi i Kërshëndellave”. Kjo aleancë strategjike në mes të Kosovës dhe Amerikës, e cila u arrit falë diplomacisë së LDK-së, Ibrahim Rugovës dhe diplomacisë sime si ministre e Jashtme e Kosovës gjatë dhjetë vjetëve të okupimit. Pra aleancën që e krijuam plot 31 vjet dhe e kultivuar me

partneritet, erdhi një kryeministër i Kosovës që bëri që Kosova të ndëshkohet nga Amerika, aleatja kryesore dhe strategjike e Kosovës dhe kombit shqiptar. Kosova u ndëshkua dhe nga BE-ja për të njëjtat gabime të Kurtit. Tash kur kemi hyrë në vitin 2024, Kosova është ende e ndëshkuar. Ndërsa diplomacia jonë ishte dhe është në gjumë, as nuk arriti të bindë Amerikën dhe BE-në që t’i heqin sanksionet ndaj Kosovës, ndërkohë që Serbia mbetet e pandëshkuar edhe pse sulmoi Kosovën. E mos të flasim që asnjë njohje nuk i erdhi Kosovës qysh se ka ardhur në pushtet kjo qeveri. Pesë vendet mosnjohëse të BE-së nuk lëvizën, dhe s’kishin si, për arsye se diplomacia jonë ishte e paaftë. Ndërkohë dy figurat e diplomacisë, presidentja dhe ministrja e Jashtme, dështuan në rolin e tyre kushtetues, mbetën pa zë si në Kosovë ashtu dhe në diplomaci, sepse i dominoi pushteti politik i Kurtit, sepse pranuan të vijnë në pozita të larta shtetërore me votat e tjetërkuajt, që u kushtoi me dështime në funksionet e tyre.

Po ashtu, Kosova u nënshtrua dhe u sulmua gjatë vitit 2023. U dridh “Banjska” Kurti në mënyrë nënshtruese menjëherë e pranoi asociacionin, jo me gojë e vet, por kishte urdhëruar presidenten e cila, pas sulmit në Banjskë nga Serbia, deklaroi: “Me Amerikën po bëjmë asociacionin”. Pas saj edhe Kurti hapur foli se kishte

pranuar asociacionin dhe konfirmoi se u kishte thënë ndërmjetësve të BE-së, Macron, Sholtz, Meloni (pas shkarkimit të Borellit dhe Lajçakut), se ishte i gatshëm ta nënshkruajë statutin e asociacionit, madje pa pyetur fare Kuvendin e as opozitën.

Në fakt tensionet e krijuara në veri erdhën më shumë nga nevoja e Kurtit për të krijuar mjegull para kompromiseve për asociacionit. Kurti zgjodhi veriun si terren apo si mundësi për ta rritur pak patriotizmin e vet para se t’i bëjë kompromiset historike. E filloi që nga zbatimi i marrëveshjes për targa, të cilën e kisha arritur unë si kryenegociatore. Por nuk e bëri zbatimin. Përkundrazi, dështoi më keq sepse pranoi lejet e njoftimit të strukturave paralele serbe. Më pas, pas reagimit të pakicës serbe të manipuluar nga Serbia e Vuçiqit, vendosjes së barrikadave, tensionet nuk u ndalën, vazhduan për të keq. Serbia djallëzore armike shfrytëzoi këtë situatë për t’i tërhequr serbët e veriut nga institucionet e Kosovës, të cilët bojkotuan zgjedhjet lokale edhe sot e kësaj dite.

Pra, në vend të rivendosjes së sovranitetit shtetëror në veri të Kosovës, që Kurti e “trumpetonte” e të cilën e kishim arritur ne qeveritë e kaluara përmes dialogut të Brukselit, Kurti, në fakt, e la veriun pa sovranitet dhe me vendosje të një protektorati të shtuar të KFOR-it atje.

Sulmi i “Banjskës” ishte sulm hegjemon i Serbisë ndaj Kosovës.

Serbia pati dy qëllime: ta arrijë asociacionin dhe ta provojë ndarjen e veriut në mënyrë që t’i thoshte botës nuk ka qetësi e stabilitet në veri ndaj duhet të ndahet. Serbia e arriti qëllimin e parë, sepse Kurti menjëherë pranoi hapur asociacionin. Mirëpo, Serbia nuk e arriti as kurrë nuk do ta arrijë ndarjen e veriut, sepse Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe unitar e kemi arritur me luftë e gjak të derdhur. Nuk e lejojmë, e mbrojmë me të gjitha mjetet sepse ende jemi gjallë, populli dhe ne që e krijuam shtetin e Kosovës. S’ka kush që mund dhe as që guxon ta cenojë shtetin e Kosovës dhe integritetin territorial të tij.

Një ditë po bisedoja me një mik që kishte dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës (Muhamet Mavraj). I thashë jam duke bërë një shkrim me temën “Kosova, e nënshtruar, e sulmuar, e dështuar”. Ai më tha shtojë fjalën “e pusuar”. Dhe kishte të drejtë.

Të gjitha dështimet e Kosovës nga ana e Kurtit populist, pa vizion dhe pa strategji, u ngjajnë dështimeve të një “heroi tragjik”, për të cilët Aristoteli ka dhënë definicionin më të saktë. Aristoteli thotë: “Një hero tragjik është një lloj personazhi që merr simpatinë e publikut, por ka të meta ose bën gabime që përfundimisht çojnë në rënien e tij”. “Një njeri nuk bëhet hero derisa ta shohë thelbin e dështimeve të tij”, thotë Aristoteli.



BURIM RAMADANI

Hyrje në vitin me shumë të panjohura 2024

Kosova ka nevojë për vendimmarrje racionale dhe të unifikuar të institucioneve, spektrit politik, shoqërisë civile, ekspertëve dhe medieve. Pra, një unitet veprues dhe jo veprime përçarëse sikurse kemi parë gjatë vitit 2023

Një vit i rëndë për t'ia hapur rrugën vitit me shumë të panjohura. Kjo fjali, ndoshta, do të ishte më përshkruesja e vitit 2023 për Kosovën dhe sigurinë e saj nacionale, sikurse edhe për zhvillimet e vendimmarrjen politike e institucionale në Kosovë.

Veriu 2023: Serbia kërcënoi e sulmoi Kosovën, sfidoi NATO-n

Serbia hapi një fazë të re të rrezikimit të sigurisë kombëtare të Kosovës. Më e keqja është se nuk u ndëshkua zyrtarisht as nga NATO dhe as nga BE apo shtetet veç e veç për aktin e agresionit që bëri ndaj Kosovës. Kur më 24 shtator 2023 grupi paramilitar i Serbisë vrau oficerin e Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit, pakkush e besoi se muajt pastaj do të ishin të mjegullt dhe Serbia nuk do të merrte një goditje serioze të botës demokratike. Sidoqoftë, debati

nuk mbeti vetëm në Kosovë dhe kjo është pjesë e rëndësishme e të tërës. Mediet ndërkombëtare e pasqyruan të vërtetën e ndërhyrjes direkte paramilitare të Serbisë brenda Kosovës. Opinioni ndërkombëtar, i tronditur nga lufta e padrejtë e Rusisë në Ukrainë, tashmë e ka të qartë se interesi special i Rusisë është që Ballkani Perëndimor, sikurse edhe rajone të tjera në botë, të përfshihen në konflikte. Kjo do të mund ta sekuenconte fokusimin perëndimor dhe përqendrimin e NATO-s, prandaj Rusia do të ishte në gjendje ta vazhdojë luftën pushtuese ndaj Ukrainës në mënyrë të papenguar. Sido që të jetë, Kosova, ashtu sikurse edhe ishte paralajmëruar me javë të tëra, nëse jo me muaj e vite, u gjend në përballje serioze të kërcënimit të sigurisë kombëtare. Grupi paramilitar serb ishte organizuar, trajnuar dhe pajisur nga Ushtria e Serbisë dhe struktura e sigurisë serbe. Qëllimi

duket të ishte vënia e një korridori të veçantë në veriun e Kosovës, ku serbët e militarizuar do të shpallnin zona të kontrolluara nga “kryengritësit serbë që nuk po mund ta durojnë Kosovën”. Kështu, eventualisht, do të hapej një kapitull i ri i negociimit qoftë në Bruksel apo në kryeqytete të tjera vendimmarrëse, në mënyrë që të gjendej një zgjidhje e re bazuar në realitetin në terren. Në variantin tjetër, nëse luftimet do të mund të zgjeroheshin në pjesë të ndryshme të veriut të Kosovës dhe nëse KFOR-i do të priste mbështetje shtesë me trupa nga shtetet e NATO-s, skenari duket të ishte që Ushtria e Serbisë të futej brenda territorit të Kosovës me pretekstin “që t'i mbrojtë serbët e veriut derisa KFOR-i të jetë në gjendje të operacionalitetit të plotë”. Ky sigurisht ishte skenar lufte, i përgatitur në qarqet më të larta shtetërore të Serbisë, përfshirë këtu Vuçiqin, Mojsilloviqin, Vuçeviqin, Vulinin e të ngjashëm. Porse, reagimi profesional i Policisë së Kosovës e nxori Kosovën me faqe të bardhë. Të paktën për kohën që po flasim. Sepse plani i Serbisë duket që mori përgjigje profesionale, prandaj edhe nuk arriti ta kthejë atë në favor të qëllimeve të veta. Megjithatë, situata e sigurisë ka

mbetur tejet e kërcënuar në këtë kuptim të sigurisë. Pra, mbeten grupe të armatosura paramilitare që Serbia po i trajnon dhe përgatit për qëllime territoriale. Sulmi paramilitar i Serbisë më 24 shtator, në fakt, ishte sfidim i drejtpërdrejtë ndaj NATO-s, po ashtu. Sepse territori i Kosovës mbetet edhe më tutje në përgjegjësi finale të sigurisë në duart e NATO-s që nga qershori 1999.

NATO shtoi trupat në Kosovë derisa bota po trazohet

Rritja e numrit të trupave ushtarake të NATO-s në Kosovë tregon domosdoshmërisht shqetësimin serioz që NATO ka për situatën e sigurisë në rajonin e Ballkanit. Dhe, kjo ndodhi në fund të shtatorit 2023, derisa më 29 maj 2023 ishin rreth 95 ushtarë të NATO-s që u plagosën dhe u lënduan nga turmat huligane dhe të trajnuara të Serbisë dhe serbëve lokalë në veri. Madje disa prej këtyre ushtarëve (hungarezë dhe italianë) u lënduan rëndë, gjë që do ta përcjellë shëndetin e tyre përjetësisht. NATO është aleanca më e fuqishme ushtarake në botë dhe këtë e definojnë edhe shtetet

kundërshtarë të Perëndimit. Por, fakti që NATO është detyruar të rrisë për mbi 1 000 numrin e trupave ushtarake në Kosovë dëshmon dy argumente tepër të rëndësishme. Së pari, NATO është e vetëdijshme që situata në dhe rreth Kosovës është në prag të shpërthimeve serioze të sigurisë, prandaj ka vendosur me shpejtësi të rrisë numrin e trupave, madje të njëjseve luftarake. Së dyti dhe ndërlidhur me të parën, Serbia qartësisht është shteti destabilizues në Ballkan, duke synuar t'i shërbejë edhe në dimensionin më të vrazhdë Rusisë. Ndërkohë që pothuajse të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor janë anëtare të NATO-s, është Serbia ajo që ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023 të armatoset rëndë me pajisje dhe sisteme armatimi nga Rusia, Kina dhe Irani. Të tri këto shtete që furnizojnë Serbinë me armatim janë shtete kundërshtarë të NATO-s, respektivisht të demokracisë. Prandaj, Serbia ka zgjedhur të furnizohet nga Rusia, Kina e Irani, sepse sistemi i pajisjeve, armatimit dhe komunikimit të atyre shteteve është në shpërputhje me standardet e NATO-s. Rrjedhimisht, Serbia dhe strategët e saj të mentoruar nga Rusia po

Fundi i izolimit, pa viza nga 1 janari 2024

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, DHJETOR - Qytetarët e Kosovës nga 1 janari i vitit 2024 do të mund të udhëtojnë pa viza në 27 shtete të Zonës Shengen deri në 90 ditë brenda periudhës prej 180-ditësh. Ky regjim, megjithatë, bart disa rregulla që duhet të ndiqen, në të kundërtën pason gjoba ose ndalesa e hyrjes. Presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti në fundvit u kanë bërë thirrje qytetarëve t'i respektojnë të gjitha rregullat që janë pjesë e sistemit të liberalizimit të vizave. Udhëtimi pa viza u mundëson qytetarëve të Kosovës të

udhëtojnë pa vizë për qëndrime të shkurtra si turistë, por edhe t'i vizitojnë miqtë apo familjarët, të marrin pjesë në ngjarje kulturore apo sportive, takime biznesi, trajtim mjekësor, për programe arsimore afatshkurtra si seminare, konferenca, punëtori, shkolla verore dhe çdo aktivitet i ngjashëm. Një qytetar mund të qëndrojë 90 ditë në çdo periudhë 180 ditore brenda Zonës Shengen. “Nëse udhëtoni disa herë, duhet të llogaritni me kujdes ditët e qëndrimit, pasi periudha e përgjithshme e qëndrimit nuk duhet të kalojë totalin prej 90-ditësh brenda periudhës 180 ditore”, ka njoftuar Integrimi Evropian i Kosovës.

Për të udhëtuar pa vizë kërkohen dokumente të rëndësishme si pasaportë biometrike, dëshmi mbi qëllimin e udhëtimit, rezervimin e vendit të qëndrimit, detajet e udhëtimit, dokumentet për veturën nëse udhëtoni me të, dhe dëshmi për mjete të mjaftueshme financiare. Megjithatë, liberalizimi i vizave nuk ju mundëson të punoni, ta ndiqni shkollimin ose të kryeni studime në Zonën Shengen. Shkeljet e rregullave apo abuzimi i kësaj të drejte mund të sjellin pasoja të rënda, duke përfshirë gjoba financiare, shënim në pasaportën tuaj dhe ndalim të hyrjes në Zonën Shengen deri në pesë vjet. Si funksionon rregulli i tre

muajve afat në pasaportë për të hyrë në Zonën Shengen? “Për të hyrë në Zonën Shengen është e rëndësishme të keni pasaportë me afat të mjaftueshëm. Pasaporta juaj duhet të jetë e vlefshme për së paku tre muaj pas datës së planifikuar të largimit nga Zona Shengen. Për shembull, nëse planifikoni të hyni në Zonën Shengen më 1 mars 2024 dhe deklaroni te policia kufitare se do të qëndroni deri më 15 mars 2024, atëherë pasaporta juaj duhet të jetë e vlefshme së paku deri më 15 qershor 2024, pra tre muaj pas datës së planifikuar të kthimit”, ka njoftuar Integrimi Evropian i Kosovës. Institucionet e vendit kanë nisur

një fushatë njëmuajore në të gjitha komunat për t'i informuar qytetarët për procedurat e liberalizimit të vizave. Qytetarët janë informuar mbi rregullat e lëvizjes pa viza përmes materialeve informuese dhe kuisit mbi integrimin evropian. Përveçse janë shpërndarë informata dhe dhurata, qytetarët kanë pasur mundësinë përmes kuisit të bëhen pjesë e shortit për udhëtimin e parë pa viza në Vjenë. Fushata për informimin e qytetarëve do të vazhdojë ende përmes televizioneve, rrjeteve sociale dhe përditësimit të informatave në uebfaqen zyrtare të integritimit evropian.



→ bëjnë përgatitjet luftarake eventuale me pajisje të cilat nuk komunikojnë me NATO. Në një rast të caktuar lufte midis Serbisë dhe ndonjë anëtarit rajonal të NATO-s, atëherë pajisjet ruse, kineze e iraniane të Serbisë mund të paraqesin shpërputhje serioze. Por çfarë po ndodh në rajonin e Ballkanit? Serbia, Republika Serbe në Bosnjë dhe pushteti aktual në Malin e Zi janë të përbashkuar në qëllimet e tyre të përbashkëta territoriale. “Të gjithë serbët të jetojnë në një Serbi” është qëllimi territorial që e ka përcjellë Serbinë, të paktën në formë të shkruar që nga Nacertanije e Garashaninit në vitin 1804. Tash ky qëllim ka marrë epitete të ndryshme gjatë periudhave të ndryshme. Ajo njihet edhe si “Serbia e Madhe” (Millosheviqi), “Bota Serbe” (Vuçiqi, Vulini etj.) dhe, së fundmi, “Konfederata e Trojeve Serbe” (kryetarët e parlamenteve në Serbi, Republikën Serbe dhe Mal të Zi). Rrjedhimisht, Kosova dhe Bosnjë-Hercegovina mbeten

caqet kryesore të Serbisë. Normalisht, ajo nuk mund ta sulmojë ndonjërin prej shteteve që tashmë janë anëtare të NATO-s, sikurse Kroacia, Mali i Zi apo Maqedonia e Veriut. Porse, për ato shtete, Serbia ka vazhduar të ndërtojë politika ndërhyrëse, sidomos në Podgoricë dhe në Shkup. E tërë kjo po ndodh në periudhën kur bota po trazohet, apo veçse është trazuar mjaftueshëm. Lufta pushtuese në Ukrainë dhe shpërthimi i luftës në Lindje të Mesme kanë dhënë argumente të shumta për përzierje të mëdha të shteteve të fuqishme në botë. Situata në Gadishullin Korean, në ishullin e Tajvanit, avancimi në armatimin e Iranit, situatat e reja në Amerikën Latine, sikurse edhe një seri e madhe e grusht-shteteve në Afrikën Qendrore, kanë dëshmuar se Bota është sot në periudhë kritike, e cila mund të çojë në ndryshime radikale. Dhe, pikërisht ndryshimet radikale në gjeopolitikë është ajo

që Serbia po pret, në mënyrë që të ndërmarrë aksione luftarake territoriale. Tekefundit, këtë e tha edhe vetë Vuçiqi pak ditë para zgjedhjeve në Serbi të datës 17 dhjetor 2023.

Konfuziteti rreth Asociacionit

Ndërkohë brenda Kosovës pothuajse i tërë debati gjatë vitit 2023 ishte i ndërlidhur në dy tema: siguria në veri dhe Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. Që të dy temat as nuk u definuan mirë dhe as nuk u zgjidhën deri në fund të vitit. Tema e sigurisë mbetet shqetësim, ndërsa tema e Asociacionit mbetet konfuzitet pothuajse i plotë. Opinioni publik i Kosovës, më 11 nëntor 2023, për herë të parë pati mundësi të lexojë saktë se çfarë Statuti të Asociacionit ishte hartuar nga ndërmjetësit. Nuk u mohua vërtetësia e publikimit sepse do të ishte marrëzi të

mohohej. Por, as nuk u avancua dhe as qartësua pozicioni i institucioneve shtetërore të Kosovës. Të paktën, jo për publikun. Tashmë konfuziteti nuk mbetet nëse është pranuar apo jo Drafti. Konfuzioni mbetet te rruga përpara që do të ndiqet dhe nëse kjo rrugë do të funksionalizohet para apo pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, që pritet të mbahen gjatë vitit 2024 në Kosovë. Institucionalisht, Drafti i dorëzuar nga ndërmjetësit duhet të përcillet në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Por, a do të japë opinionin e vet Gjykata Kushtetuese apo do ta konstatojë papranueshmërinë e trajtimit duke u thirrur në aktgjykimin e vitit 2015? Unë besoj që Gjykata Kushtetuese do të duhej ta trajtojë plotësisht Draftin. Po, po, ky drafti që kam publikuar më 11 nëntor është. Vetëm Gjykata Kushtetuese do të mund të zhbëjë disa pjesë serioze të atij dokumenti që, në thelb, ndikon në ndryshime radikale

brenda Kosovës, kryesisht në ndarjen reale të komunitetit serb si i tërë nga sistemi juridik e politik i Kosovës. Në këtë rast, Statuti i Asociacionit do të rridhë në përputhje me kornizën kushtetuese që ekziston në Kosovë. Në rastin e kundërt, pra nëse Gjykata Kushtetuese refuzon ta trajtojë Statutin e Asociacionit duke u thirrur në Aktgjykimin e vitit 2015, atëherë Kosova do të sillet në të njëjtin rreth vicioz edhe për, ndoshta, 10 vjet të ardhshme! Sepse në atë situatë Asociacioni do të mbetej plotësisht çështje politike dhe, si e tillë, do ta ndante e përçante edhe më keq shoqërinë e Kosovës. Kështu, bazuar në fushat dhe temat e lartpërmendura, domsdoshmërisht Kosova ka nevojë për vendimmarrje racionale dhe të unifikuar të institucioneve, spektrit politik, shoqërisë civile, ekspertëve dhe medieve. Pra, një unitet veprues dhe jo veprime përçarëse sikurse kemi parë gjatë vitit 2023.



KOSOVA GJATË 2023-s NË EKONOMI

Kuvendi e miraton buxhetin për vitin 2024

Më 14 dhjetor Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Ligjin për Buxhetin për vitin 2024 në një seancë të jashtëzakonshme, e cila është braktisur nga opozita. Nga 64 deputetë të pranishëm në sallë, 63 votuan për, ndërsa një abstenoj. Projektligji ishte aprovuar nga Qeveria e Kosovës më 31 tetor, ndërsa shumica e paraparë buxhetore kap vlerën mbi 3.3 miliardë euro - nga 3.2 miliardë sa ishte në këtë vit. Për vitin 2024 Qeveria e Kosovës ka planifikuar të ndajë dukshëm më shumë para për disa ministri, si Ministrinë e Ekonomisë dhe atë të Mbrojtjes, në krahasim me vitin 2023. Nga kjo shumë, mbi 1 miliard euro parashihet të shkojnë për subvencione dhe transfere, mbi 850 milionë euro për shpenzime kapitale, mbi 800 milionë euro për paga dhe shtesa dhe afër 500 milionë euro për mallra dhe shpenzime.

Tensionet në veri, me ndikim negativ në ekonomi

Trazirat e njëpasnjëshme në veri të Kosovës, zonë e banuar me shumicë serbe, kanë bërë që investorët ndërkombëtarë të hezitojnë ta shtrijnë kapitalin e tyre jo vetëm në Kosovë, por në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Sa herë që bisedohet për mundësinë e ardhjes së ndonjë kompanie të huaj në Kosovë, mbizotëron tema e veriut. Brenda 15 vjetëve të fundit vlera e investimeve të huaja direkte në Kosovë kap vlerën e mbi 4.5 miliardë eurove. Situata në veri e ka ndikuar edhe në mënyrë tjetër ekonominë e Kosovës, pasi Bashkimi Evropian ka ndërmarrë në fund të qershorit disa masa ndëshkuese ndaj vendit, pasi Qeveria e Kosovës nuk u është bindur, sipas bashkësisë ndërkombëtare, kërkesave të saj për ta shtensionuar situatën në veri. Këto masa kanë përfshirë

pezullimin e programimit të fondeve për Kosovën, përfshirë ato nga IPA - Instrumentet e Para-Anëtarësimit në BE - dhe nga Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor.

Qytetarët e Kosovës u bal-lafaquan me rritje të çmimeve

Çmimet e produkteve ushqimore kanë vazhduar të rriten për çdo ditë në Kosovë. Njëjtë ka ndodhur edhe gjatë vitit 2023. Qytetarët vazhdimisht janë ankuar për rritjen e çmimeve, sidomos të produkteve elementare. Shumë prej tyre janë ankuar se me pagat që marrin e kanë të vështirë t'i mbulojnë nevojat më elementare për jetë. Sipas njohësve të ekonomisë, rritja e çmimeve në treg ka qenë për shkak të çmimit të lartë të importit të mallrave. Ndërsa ASK-ja në fund të vitit ka theksuar se familjet në Kosovë kanë shpenzuar rreth 300 për qind më shumë para për ushqim sesa për banim. Në anën tjetër, UNDP-ja ka bërë me dije se për vitin 2023 varfëria në Kosovë është rritur për 16 për qind.

Mbi 1.2 miliard euro vlera e dërgesave nga mërgata

Mbi 1.2 miliard euro është vlera dërgesave të mërgatës që janë sjell në Kosovë deri në muajin nëntor të vitit 2023, gjë që paraqet rritje prej 10.2-përqindësh krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kështu thuhet në statistikat e remitançave dhe institucioneve të tjera financiare për muajin nëntor 2023 të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), duke shtuar se vlera e tyre, sipas vlerësimeve, ishte 101.3 milionë euro në muaj. Sipas raportit, prurjet më të mëdha të remitançave ishin nga institucionet financiare jobankare me pjesëmarrje prej

65-përqindësh, pasuar nga kanalet e tjera me 19 për qind dhe bankat me 16 për qind.

Qeveria ndan 100 euro për fëmijët dhe pensionistët

Më 13 dhjetor Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që të ndajë nga 100 euro për të gjithë fëmijët nën 16 vjeç në muajin dhjetor. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se pushteti synon që vitin e ardhshëm ta avancojë skemën, sipas parimit që ata që kanë më pak të ardhura, të përfitojnë më shumë. Deri më tani Qeveria ka ndarë nga 10 euro për fëmijët nën moshën 16 vjeç dhe nga 20 euro për fëmijët deri në dy vjeç. Kurti është zotuar se në të ardhmen fëmijët do të përfitojnë nga shtesat prej 50 deri 150 euro. Në mbledhjen e parafundit të qeverisë, Kurti ka thënë se këtë muaj edhe pensionistët do të përfitojnë nga 100 euro, përveç pensionit të rregullt.

AKP-ja rimerr disa asete në Mal të Zi

Më 29 nëntor Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka njoftuar se ka arritur të kthejë tetë asete në Mal të Zi të një ndërmarrjeje nga Kosova. Sipas një njoftimi, AKP-ja tha se fitoi rastin gjyqësor, në shkallë të dytë, për asetet në Mal të Zi të KBI Kosova Export - Industria e Mishit nga Fushë-Kosova. Pronat e KBI Kosova Export - Industria e Mishit ndodhen në Podgoricë, Tivar dhe Budvë. KBI Kosova Export - Industria e Mishit ka gati 1 000 metra katrorë hapësira biznesi në lokacione prestigjioze në Mal të Zi. Në qendër të Podgoricës janë shtatë të tilla me një sipërfaqe totale prej 700 metrash katrorë - prej të cilave 500 janë në katet

përdhes të objekteve të banimit dhe 200 në bodrumet e tyre. Në qendër të Budvës është një hapësirë prej 60 metrash katrorë, ndërsa në Tivar prej 137 metrash katrorë, plus 47 metra katrorë bodrum.

Kushtetuesja shpall të pavlefshëm Ligjin për Çmimet Tavan për produktet bazë

Ligji për masat e përkohshme të produkteve themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg është shpallur i pavlefshëm nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Gjykata ka konstatuar se ai nuk është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Në aktgjykimin e publikuar më 24 nëntor është bërë me dije, po ashtu, se kërkesa për masë të përkohshme është refuzuar me shtatë vota për, ndërsa një ishte kundër. Aktgjykimi i Kushtetueses vjen pas shqyrtimit të rastit të parashtruar nga deputeti Arben Gashi, i përkrahur edhe nga nëntë deputetë të tjerë të Kuvendit të Kosovës. Tri partitë më të mëdha opozitare në Kuvendin e Kosovës e patën kundërshtuar ligjin e hartuar nga Qeveria e Kosovës për vendosjen e çmimeve tavan në produktet themelore.

Kushtetuesja vendos në favor të qeverisë për faljen e tatimit në pronë

Gjykata Kushtetuese e Kosovës vendosi që vendimi i Qeverisë së Kosovës për faljen e tatimit në pronë, përmes ndryshimeve në Ligjin për Tatim në Pronë, nuk cenon përgjegjësitë komunale. Në gusht komuna e Prizrenit dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për ta kontestuar nenin 5 të ligjit të ndryshuar, që parasheh faljen në vlerë prej 100 eurosh të tatimit në pronë për çdo tatimpagues për

vitin tatimor 2023. Nga komuna e Prizrenit kishin argumentuar se neni 5 i këtij ligji shkurton buxhetin e komunave të Kosovës. Më 4 shtator Kushtetuesja kishte pranuar kërkesën e komunës së Prizrenit dhe kishte vendosur masë të përkohshme për ligjin deri në një vendim përfundimtar.

Minatorët e Trepçës ndër-presin grevën

Më 2 nëntor minatorët e kombinatit metalurgjik "Trepça" kanë ndërprerë grevën pas 10 ditësh. Marrëveshja u arrit mes Bordit të përkohshëm të Drejtorëve të Trepçës dhe disa deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje. Sipas marrëveshjes, minatorët dhe përfaqësuesit e partisë në pushtet u pajtuan që ekzekutimi i pagës së minatorëve të bëhet nga data 6 deri më 10 të çdo muaji, të shpallet konkursi për zgjedhjen e kryeshefit ekzekutiv të Trepçës, të përmirësohen kushtet e sigurisë dhe të tërhiqen vendimet e ndërmarra gjatë grevës 10-ditore. Sa i përket kërkesës për sigurim shëndetësor dhe jetësor, minatorët janë pajtuar që këto çështje të trajtohen më vonë.

Kosova e humb arbitrazhin me Contour Global

Qeveria e Kosovës e ka humbur arbitrazhin ndërkombëtar me kompaninë amerikane Contour Global për mosrespektim të kontratës. Lajmi u bë më 5 tetor. Kosova detyrohet tani t'ia paguajë Countour Globalit mbi 20 milionë euro dëmshpërblim në bazë të vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar. Zyrtarët e Ministrisë së Drejtësisë thanë se Avokatura Shtetërore dhe përfaqësuesi ligjor i kontraktuar e kanë analizuar vendimin final të arbitrazhit dhe se do të ankohen ndaj tij në Gjykatën Civile në Mbretërinë e Bashkuar.



Shtohen paratë false në tregun e Kosovës

Nga janari deri në shtator të vitit 2023 në laboratorin e Agjencisë së Forenzikës u ekzaminuan mbi 35 000 monedha të falsifikuara dhe 2 209 kartëmonedha të falsifikuara. Në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ekspertët e forenzikës ekzaminuan 9 309 monedha të falsifikuara dhe 645 kartëmonedha. Më të falsifikuarat gjatë vitit 2023, sipas tyre, ishin monedha prej dy eurosh dhe kartëmonedha prej 50 eurosh. Kosova nuk është pjesë e Eurozonës, por përdor euron. Nga shtetet e tjera të rajonit ashtu vepron edhe Mali i Zi. BQK-ja ka theksuar se paratë false e dëmtojnë ekonominë e Kosovës.

Votohet Fondi Sovran

Më 15 dhjetor Kuvendi i Kosovës ka miratuar Projektligjin për Fondin Sovran. 62 deputetë të pushtetit votuan pro këtij projektligji, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Si pjesë e projektligjit për Fondin Sovran në lexim të dytë u përfshin 47 amendamente. Sipas ekzekutivit, Fondi Sovran do të jetë një mekanizëm i ri dhe efektiv për orientimin e investimeve, përmirësimin e qeverisjes korporative, ngritjen e konkurrueshmërisë dhe cilësisë, rritjen e shkathtësive dhe të punësimit, si dhe eliminimin e keqpërdorimit dhe korrupsionit në sektorin e ndërmarrjeve publike. Opozita e ka kundërshtuar projektligjin e këtij fondi duke e dërguar në Gjykatën Kushtetuese.

Paga minimale rritet në 264 euro

Më 13 korrik me 60 vota të deputetëve të Kuvendit të Kosovës është miratuar në lexim të dytë projektligji që mundëson rritjen e pagës minimale. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se me këtë projektligji mundësohet rritja e pagës minimale. Nga 130 euro e 170 euro, në 264 euro bruto për të gjithë. Për punëtorët nën 35 vjeç rritje e pagës minimale për 103 %, ndërsa për punëtorët deri në 65 vjeç rritje për 55 %. Po ashtu, hiqet tatimi në të ardhurat personale për pagat deri në nivelin e pagës minimale. Nga kjo rritje do të përfitojnë rreth 100 mijë punëtorë, ndërsa nga heqja e shkallës së parë tatimore do të përfitojnë të gjithë punëtorët.

Kosova pranon 67.5 milionë euro nga BE-ja si mbështetje ndaj krizës energjetike

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve më 17 mars ka njoftuar se ka pranuar tranzhin e parë prej 67.5 milionë eurosh nga Bashkim Evropian, nga 75 milionë sa është mbështetja totale ndaj krizës energjetike. Këto fonde do të përdoren për zbatimin e masave mbështetëse për energji, të cilat përfshijnë mbështetjen ndaj familjeve më në nevojë, nxitjen e kursimit për konsumatorët familjarë, mbështetjen për energji eficiente për banesa dhe shtëpi, mbështetjen për blerjen e pajisjeve shtëpiake eficiente, si dhe nxitjen e kursimit nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

Marrëveshja financiare prej 38 milionë eurosh për rehabilitimin e rrjetit hekurudhor në Kosovë

Më 9 shkurt ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe udhëheqësi i Operacioneve të Bankës Evropiane për Investime për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, Matteo Rivellini, patën nënshkruar marrëveshjen financiare të financimit shtesë për rehabilitimin e Linjës Hekurudhore 10 në Kosovë. Marrëveshja në vlerë prej 38 milionë eurosh synon rehabilitimin e 139 km të linjës hekurudhore, përkatësisht në sinjalistikë dhe telekomunikacion. Ky projekt pritet të ketë një ndikim të rëndësishëm në rritjen e shpejtësisë së udhëtimit dhe ngritjen e kapaciteteve për pasagjerë dhe mallra.

Lansohet platforma e punësimit për të rinj “superpuna”

Më 6 shkurt qeveria ka lansuar platformën “superpuna”, qëllimi i së cilës është ndërmjetësimi i të rinjve punëkërkues 18-25 vjeç me punëdhënësit potencialë. Punëdhënësit mund të jenë nga sektori privat, publik dhe sektori joqeveritar. Përmes “superpuna” çdo punëdhënësi mund të angazhojë deri në 30 % të stafit ekzistues. Pra, nëse një biznes ka 10 të punësuar, përmes “superpuna” mund të angazhojë edhe 3 punëtorë të rinj. Pas ndërmjetësimit të suksesshëm në mes të punëdhënësve dhe punëkërkuesve, qeveria bën subvencionimin e pagës prej 264 eurosh në muaj për 6 muaj me

radhë. Çdo punëdhënësi ka të drejtë ta shtojë vlerën e pagës për punëtorin e angazhuar.

Telekomi i Kosovës, fitim 5.9 milionë euro neto në vitin 2023

Në periudhën janar-nëntor të këtij viti Telekomi i Kosovës ka shënuar fitim prej 5.9 milionë eurosh neto, duke përmirësuar performancën financiare. Investimet të cilat planifikohen të bëhen janë qenësore për Republikën e Kosovës si zgjerimi dhe përfundimi i rrjetit në mbarë territorin, ku pritet që vitin tjetër të fillohet me shërbimin 5G. Fitimet të cilat i ka shënuar Telekomi i Kosovës janë duke u kthyer në investimet teknologjike si dhe në modernizim të rrjetit e të cilat kanë munguar që nga viti 2015.

Dogana mbledh më shumë 1.5 miliard euro të hyra

Dogana e Kosovës ka përmbyllur raportin e të hyrave për vitin 2023 me 1.5 miliard euro. Ky rezultat është edhe një rekord tjetër i shënuar për periudhën në të cilën flasim. Të hyrat sivjet tejkalojnë të hyrat për të njëjtën periudhë me 124 milionë apo 9 % më shumë të hyra. Dogana e Kosovës është duke shënuar rezultate shumë pozitive edhe në luftimin e ekonomisë joformale dhe mbrojtjen e shoqërisë nga mallrat e ndaluara. Edhe raporti i fundit për vendin nga Komisioni Evropian ka theksuar performancën e mirë të Doganës së Kosovës në disa fusha të rëndësishme.

Rryma shtrenjtohet mbi 15 për qind

Energjia elektrike në Kosovë është shtrenjtuar për 15.4 për qind. Kështu vendosi më 30 mars Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji. Tarifat e reja të rrymës kanë hyrë në fuqi nga 1 prilli. Kosova ka kapacitet të prodhojë rreth 800 megavat rrymë në orë, ndërsa nevojat e saj, në ditë dimri, arrijnë deri në 1 300 megavate në orë. Këtë diferencë ajo e importon nga jashtë. Faturat e muajit dhjetor kanë ardhur me çmim të lartë, duke bërë që për këtë gjë të reagojnë shumë qytetarë dhe partitë e opozitës.

Qytetarëve u humbin miliona euro të kursyera në Trust

Në shtator është raportuar se kriza globale ka ndikuar që Trusti të humbë miliona euro të kursimeve të qytetarëve. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, rënia e investimeve të këtij institucioni përgjatë periudhës janar-korrik 2022 ka arritur në 161.7 milionë euro. Për këtë çështje është deklaruar edhe ministri i Financave, Hekuran Murati, i cili ka pranuar se Trusti është duke pësuar humbje të kursimeve pensionale. Sipas tij, në bursat ndërkombëtare ka luhatur të çmimeve për shkak të krizës në tregjet ndërkombëtare. Edhe në fillim të 2023-s deputetët e Kosovës i thanë jo një tërheqjeje të re nga Trusti, edhe pse opozita ishte pro tërheqjes së këtyre mjeteve.





PROF. DR. KUDUSI LAMA, GJENERAL NË PENSION

Nacionalistë i vërtetë dhe paraqitja si nacionalistë

Nacionalistë, një term që duhet vlerësuar por, për çudi, ndër ne shqiptarët është negativizuar në kufi të fundit sepse uniformën e nacionalistit e kanë veshur gjithnjë ata që nuk kanë pasur të drejtë ta veshin.

Pse mendoj kështu?

Sepse ka nacionalistë dhe vrasës e simpatizant të nacionalistëve. Prej këtej evidencoj se ka që janë nacionalistë, por ka shumë që janë thjesht simpatizantë të nacionalizmit dhe deklarohen si të tillë duke qëndruar larg këtij qëndrimi praktikisht e duke vrarë në mënyra nga më të ndryshmet nacionalistët e vërtetë dhe çdo qëndrim nacionalist. Për fat të keq, ndër shqiptarë duket shumë kjo kategori dhe që janë pikërisht këta të cilët bëjnë më së shumti deklarata për nacionalizmin, si dhe janë më agresivë ndaj çdo qëndrimi të qartë nacionalist. Për këtë kategori veprim nacionalist është vetëm ai veprim e qëndrim që kryhet e mbahet prej vetë atyre, le të jetë edhe qëndrim kundër atdheut e kombit.

Për të mos ecur larg në histori, mund të rreshtojmë disa fakte që na bëjnë karshillëk me nacionalizëm duke qenë veprime kundër atdhetare e kombëtare.

Në vitin 1924 Ahmet Zogu bën një marrëveshje me kryeministrin e Serbisë Nikolla Pashiç ku, ndër të tjera, në përmbajtjen e saj ka të tilla qëndrime “atdhetare”, si: “1. Shqipëria impenjohet t'i bashkohet Jugosllavisë me bashkim personal; 2. Kryetar i shtetit shqiptar do të jetë Ahmet Zogu, që më vonë do të njohë dinastinë Karagjorgjeviq; 4.

Ministria e Luftës Shqiptare do të anulohet dhe Shqipëria heq dorë që të ketë një ushtri Kombëtare; 14. ... Në rast gjendje lufte midis Italisë dhe të Greqisë kundrejt Shqipërisë, ushtria, jugosllave do të ketë të drejtë të okupojë gjithë tokën shqiptare për t'i siguruar kështu Shqipërisë gjithë tokën e saj nga invadimi eventual italian ose grek etj”. Prej këtej duket se në emër të nacionalizmit firmoset pushtimi i atdheut dhe zbehet qenia kombëtare thjeshtë për interesa personale. Ndërkohë ky “nacionalist” i jep të drejtën vetes në emër të nacionalizmit të vrasë Bajram Currin, Avni Rustemin, Luigj Gurakuqin, Hasan Prishtinën etj., se sipas tij megjithëse ata vepronin e luftonin për komb e atdhe nuk dinin t'i shërbenin atdheut e kombit si dinte të ishte nacionalist Ahmet Zogu, i cili kur iu rrezikuan interesat iku nga sytë këmbët vetëm me familjen e tij në prill të vitit 1939.

Po kështu, kjo lojë vazhdon edhe gjatë Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, ku nacionalistë quhen të gjithë ata që bashkëpunuan me pushtuesit nazifashistë dhe luftëtarët e Ushtrisë Nacional Çlirimtare etiketohen komunistë dhe megjithëse luftonin nëpër frontet e luftës me pushtuesin, bëheshin të gjitha përpjekjet nga nacionalistët se këta nuk ishin shqiptarë, por ishin të huaj që luftonin ta prishnin Shqipërinë që ishte mirë si e pushtuar. Dhe kjo vetëm pse në udhëheqje politike të kësaj ushtrie që luftonte pushtuesin ishte Partia Komuniste Shqiptare. A thua se ua ndaloj

rrugën dikush të tjerëve të ngriheshin dhe të krijonin kapacitete luftarake më të mëdha se sa krijoj Ushtria Antifashiste Nacional Çlirimtare. Dhe për çudi edhe sot vazhdon të punohet me ngulm për të quajtur të gabuar e të pa pranueshme Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare. Edhe dëshmorët e rënë në luftë etiketohen kriminelë, edhe luftëtarët e njohur për trimërinë dhe atdhetarizmin e tyre, etiketohen si kriminelë. Kurse të gjithë ata që kanë hyrë si diversantë në Shqipëri, që kanë vrarë gra e fëmijë, që kanë djegur edhe çerdhet e fëmijëve e shkollat, që kanë shkatërruar pasurinë e Shqipërisë në mënyra nga më të papranueshme e kriminalet, konsiderohen nacionalistë dhe që sipas këtij mendimi duhen nderuar se kanë luftuar kundër komunizmit, a thua se këta komunistët nuk ishin shqiptarë por trajtohen sikur ishin të huaj. A thua se këta komunistët nuk kanë jetuar e nuk jetojnë edhe sot në Shqipëri.

Ky fenomen ka ndodhur edhe në trevat e Kosovës e tokave të tjera shqiptare nën Jugosllavi. Edhe sot ata mbi 50 mijë luftëtarë të Ushtrisë Antifashiste Nacional Çlirimtare të Kosovës e tokave të tjera shqiptare nën Jugosllavi, quhen si të mos kishin ekzistuar. Çka është e turpshme për historinë, pasi pa atë luftë sot nuk do të kishte shqiptarë në Kosovë, aq sa kanë mbetur në Çamëri, ku nuk u luftua kundër fashizmit. Është gjetur një mekanizëm që u bashkëpunua me fashizmin sepse nuk donim të kthehej Serbia. Por

nuk merret në Konsideratë fakti se vendimet ishin që popujt bashkëpunëtor të fashizmit do të pastroheshin etnikisht në interes të popujve antifashistë.

Dhe sot shumëkush vazhdon në Kosovë me mendimin se po të mos ishte krijuar ushtria antifashiste në Kosovë, ajo mund të ishte çliruar nga Jugosllavia e Serbia, e cila pastroj mbi 500 mijë gjermanë nga Vojvodina si bashkëpunëtorë të nazizmit e jo do të linte 550 mijë shqiptarë në Jugosllavi edhe pse ishin në tokat e tyre. Sa të lehta janë fjalët për t'i thënë e sa të vështira punët për t'i bërë.

Prandaj do të ishte mirë, që të mos bëjmë lojë fjalësh me termat nacionalizëm e nacionalistë. Ne e dimë se nacionalizmi ka si mision që ta bëjë kombin të vetëqeveriset dhe të jetë i lirë e i pavarur, por kjo nuk arrihet duke deklaruar e duke shtrembëruar historinë.

Ka disa që deklarojnë se nuk janë nacionalistë radikal dhe se nuk kanë e nuk manifestojnë urrejtje racore. Po a ka nacionalistë më radikalë e më racist se ata që mohojnë veprat kombëtare të bashkëkombësve të tyre, vetëm për të marrë vlera për vete pa bërë asgjë? A ka nacionalistë më radikalë se ata që përpiqen të rrëzojnë edhe mitet kombëtare, vetëm që të jenë ata në krye të piramidës kombëtare pa u lodhur për asgjë, përveç për interesat e tyre? A ka nacionalistë më radikalë se ata që janë të gatshëm të bashkëpunojnë edhe me armikun, vetëm që në përfundim të jenë ata që të sundojnë kombin e tyre qoftë edhe nën pushtetin e

pushtuesit a të armikut që e ka sjellë në atë gjendje?

Nacionalistët duhen nderuar. Por cilët janë ata? Të tillë përgjithësisht po e konsiderojnë veten ata që duken nëpër sallone kancelarish, jo ata që bëjnë sakrifica për atdheun. Në krijimin e shtetit shqiptar më 1912 përmenden shumë figura, por ai që ishte komandanti suprem i kryengritjes së përgjithshme për pavarësi nuk përmendet askund. A mund të jetë i plotë akti i krijimit të shtetit shqiptar pa figurën e Hasan Prishtinës? Po pse ky luftëtar i madh nuk përmendet fare kur vjen puna te akti i krijimit të shtetit shqiptar? Kujt i bën hije? Pse duhet shmangur? Këto janë veprime që nuk na bëjnë nder. Mund të ketë në atë aktin e krijimit të shtetit shqiptar shumë prej atyre që kanë vlera si nacionalistë ashtu sikurse mund të ketë që nuk kanë asnjë vlerë e nuk kanë luajtur as dorën, as gishtin e as këmbën e gojën për çështjen kombëtare. Por kjo nuk ka rëndësi. Ama që mungon Hasan Prishtina, ka shumë rëndësi dhe duhet të tërheqë vëmendjen për të kthyer vështrimin drejt këtij akti të rëndë që është cënues i rëndë i vlerave të nacionalistëve të vërtetë. Ashtu mund të thuhet edhe për figura të tjera madhore të kohës, si Idriz Seferi, Bajram Curri etj.

Është e nevojshme të ndikohet në kulturën kolektive dhe në kujtesën kombëtare, për të shpërfaqur vlerat, për të cilat kombi ka nevojë, por edhe që i kanë bërë shërbimin e duhur në çastet e tij të vështira. Lexoj nëpër shkrime të ndryshme, edhe të studiuesve, etiketime të

tilla si: nacionalistët dhe komunistët, nacionalistët dhe antikomunistët, duke i vënë këto etiketime sipas interesit të shkruesit të radhës a të quajturit studiues të çështjes që i qaset. Duket njëlloj sikur thuhet shqiptarët dhe serbët, çlirimtarët dhe pushtuesit, luftëtarët e lirisë dhe armiku. A konsiderohet normale logjikisht kjo qasje? Mendoj se jo. Është thjeshtë lojë fjalësh me etiketime për t'i dhënë vlera atij që nuk ka.

Unë kam lexuar dhe jam i bindur se nacionalizmi si parim politik e sheh kombin jo thjesht si emër për një grup të caktuar popullate, por si një entitet politik sovran. Dhe brenda tij ka njerëz me pikëpamje, qëndrime dhe programe e ideologji të ndryshme. Ama të gjithë i përkasin kombit dhe në shërbim të çështjes nacionale janë njëlloj si me obligime ashtu edhe me të drejta.

Ndërsa sot e quan veten më shumë se të tjerët atdhetar ai që deklaron se: “Me këqyr historinë, nacionalizmi dhe patriotizmi nuk ka pru kurrë të mira, sidomos Kosovës”. Pse duhet të bjerë mendimi deri në këtë nivel kur flitet për këto çështja kaq të rëndësishme? Duket qartë, se kjo vjen si rrjedhojë se ai apo ata që kanë mendime të tilla e bëjnë deklarime të tilla, as që kanë idenë se çfarë është veprimi nacionalist. Kjo për arsyen e thjeshtë, se ai ose ata janë mësuar të quajnë nacionalistë pikërisht ata që nuk kanë bërë asgjë për këtë komb.

Populli shqiptar ka një fjalë të urtë që thotë: “Të mençur pas kuvendit e trima pas luftës ka mjaft”. E që ka të tillë unë e kam kuptuar, parë e përrjetuar. Por që të lejohen ta bëjnë institucion mençurinë pas kuvendit e trimërinë pas luftës, këtë nuk po arrij ta kuptoj si mund të ndodhë e pse duhet të ndodhë, sepse çdo hap në rrugën kombëtare ka dëshmitarë, e të tillë është me vlerë të thonë ndal kur duhet thënë. Por jo, duket sikur dëshmitarëve të vlerave kombëtare dikush ua zë bishtin me derë si i thonë dhe ata nuk guxojnë të thonë çka është e vërtetë e çka është e pa vërtetë. E kjo shpie në atë që shumëkush mendon se të jesh nacionalist do të thotë ta mbushësh veten me një ndjenjë superioriteti ndaj të tjerëve. Dhe ky mendim vjen për arsye se pikërisht ata që nuk kanë bërë asnjë hap në rrugën e nacionalizmit, por e shpallin veten si të tillë, ia veshin vetes atë ndjenjën e superioriteti, se po të shikosh nacionalistët e vërtetë, ata as që ndihen e as që i veshin vetes atribut. Ata thjeshtë konsiderojnë se kanë kryer një obligim për kombin dhe kaq.

Prandaj edhe është kthyer nacionalizmi në një fushë ku përgjithësisht ndeshen të pandershmit. Ku interpretimet, keqpërdorimet, spekulimet dhe përplasjet nuk ndalen. Dhe të gjitha këto vetëm për t'i shërbyer një politike të caktuar e përgjithësisht politikës së të fortit, pa përjashtuar rastet kur i shërbehet politikës së familjes apo të klanit të cilit i përket. Prandaj edhe po t'i vësh re politikanët, sa herë ndodhen në vështirësi për të humbur pushtetin apo për të rënë nga fuqia e tyre, do të gjejnë

mënyrën të thirren në nacionalizmin, sepse e kanë të qartë se shqiptarët e thjeshtë e duan atdheun dhe kombin e tyre sa gjakun e trupit të tyre. E duke qenë të qartë për këtë, thirren në nacionalizmin që të duken sa më atdhetar të qëndrueshëm vetëm për të mashtruar në çastet e dobësisë së tyre. Shembuj të tillë kemi plot. Edhe kur furnizohet me naftë Serbia në kohën e embargos mbarëbotërore për të, flitet në emër të nacionalizmit, edhe kur i jepen Greqisë 400 km² det, deklarohet se veprohet në emër të nacionalizmit, edhe kur u hiqen ushtarëve fishekët nga armët që të vijnë grekët t'i vrasin nëpër repartet e tyre deklarohet nacionalizëm. Edhe kur pihet alkool me Millosheviqin në Beograd e edhe kur gëzohesh se u shfarosën Jasharët e lavdishëm përsëri në emër të nacionalizmit flitet. Është bërë ky termi nacionalizëm e nacionalistë në gojën e tyre, si robe e pa larë.

Unë e nderoj nacionalizmin e natyrshëm, i nderoj nacionalistët e provuar në betejat kombëtare me pendë dhe me pushkë. Por nuk mundem t'i nderoj nacionalistët e salloneve, të kafeve e të deklaratave pranë kolltukëve të sundimit të atdheun, duke u tërhequr zvarrë e duke deklaruar se janë atdhetar fluturues.

I dua nacionalistët që luftojnë me shpirt për ta parë atdheun e kombin në nivelet e kombeve të zhvilluara e të qytetëruara. I dua nacionalistët që janë atdhetarë dhe që bëjnë sakrifica për çështjen e atdheut, pa cenuar interesat e atdheut të të tjerëve. E të tillë kemi mjaft në trojet shqiptare e ndër shqiptarët, që gjithçka e bëjnë në emër të atdhetarizmit e të kombëtarizmit.

Ndërsa, kur shpallen nacionalistë ata që konsiderojnë veprim atdhetar vetëm veprimin e tyre, ata që konsiderojnë armiq të atdheut të gjithë ata shqiptarë që nuk mendojnë si ata ose që nuk janë në turmën që duartroktojnë ata, ata që e identifikojnë atdheun me veten, identifikojnë shtetin me veten, identifikojnë kombin me veten dhe identifikojnë popullin me veten, më duket se duhet të ndalemi e të mos bëjmë se nuk shikojmë e nuk dëgjojmë. Duhet të ndalimi e të themi ndal për të tillët, se na konsiderojnë edhe të pa aftë e edhe budallenj nëse i lëmë të vijnë me tej me mendësinë e tyre dhe për interesat e tyre. Të tillët po të lejohen më tej nuk shpallen thjeshtë nacionalistë, por dalin edhe mbi ligjin. Shikoni se ka të tillë, që i thonë edhe ligjit nuk je përpiluar për ne por për të tjerët.

Për mua nacionalizmi është ideja e rritjes së fuqisë së kombit. Që arrihet duke u bërë njësh me të. E pikërisht ai që bëhet njësh me kombin e tij, mund të quhet nacionalist. Ndërsa ai që del mbi kombin e tij, duhet hedhur tej. Por kjo bëhet kur kombi është i shkolluar. E kombin e shkollon pikërisht ai që është nacionalist. Ai që e di se fuqia e kombit mbështetet në mendjet e ditura. Ai që e di se të diturit nuk mund të skllavërohen.

Le ta shohin veten në pasqyrën e ndërgjegjes së tyre të gjithë ata që nacionalizmin duke ia veshur

vetes e kanë bërë rrobë të pa larë. Mund të ketë dikush mendimin pse unë në këtë shkrim nuk i them edhe me emra disa prej atyre që e shpallin veten nacionalistë, megjithëse nuk janë të tillë e nuk kanë bërë asgjë për të qenë të tillë, pa folur për ata që duke u deklaruar nacionalistë kanë bërë shumë vepra kundërkombëtare. Mendoj se nuk ka nevojë për emra, pasi të gjithë ata që i përkasin kësaj familjeje, nëse do ta lexojnë shkrimin tim, ju siguroj se me vete do të thonë e paska pasur fjalën për mua. Pasi vërtetë për atë e kam fjalën.

Nacionalistët e vërtetë i dinë detyrat dhe detyrimet e tyre, sepse ndjenjën atdhetare e kombëtare e kanë të gdhendur në gjakun e tyre, në gjenin e tyre, ata nuk mund të veprojnë ndryshe veçse si të tillë. Sepse e ndjejnë se duhet të bëjnë pikërisht atë që e fuqizon kombin, që e çliron kombin, që e rrit personalitetin e kombit, që e zhvillon kombin, që e zbukuron jetën kombëtare, që e ndriçon jetën kombëtare dhe bën të shihet e ardhmja e sigurt.

Në historinë kombëtare individualitetet historike konsiderohen të gjitha njëlloj të shenjtë dhe të respektueshme, pasi historia e kombit është fuqi për të ardhmen. Por gjithnjë duke iu referuar atyre figurave që me të vërtetë kanë bërë vepra nacionaliste të pa kontestueshme, duke mos i lëkundur vlerat dhe karakteristikat e nacionalizmit tradicional, jo agresiv, jo të dhunshëm, jo diktatorial dhe jo intolerant. E dua nacionalizmin që nuk rrëshqet në shovinizëm, por theksoj se gjithnjë drejt shovinizmit ecin ata të quajtur nacionalistë që nacionalizmin e kanë thjeshtë rrobë për ta veshur dhe nuk kanë asgjë tjetër që i lidh me të, as vepër, as traditë, as trashëgimi.

Nacionalistët e vërtetë e konsiderojnë kombin e tyre popull që mund të shkojë te e ardhmja duke e perfeksionuar vë vijmësi vetveten, duke marrë mbi vete detyra dhe virtyte për të kontribuar në zhvillimin e progresit shoqëror të përbotshëm, që të jetë rezistues ndaj ndryshimeve, duke u bërë kështu kontribuues në zhvillimin dhe sigurinë e përbotshme, pa u konsideruar në asnjë çast vetëm konsumues i sigurisë, por edhe investitor i fuqishëm në sigurinë e të sotmes dhe të ardhmes së përbotshme.

Nacionalistët e vërtetë nuk besojnë dhe nuk pranojnë që të tjerët janë të destinuar të sundohen prej kombit të tyre, ashtu sikurse nuk pranojnë që të sundohen për asnjë arsye prej asnjë kombi a populli tjetër. Këto janë urdhërime të përhershme të nacionalizmit shqiptar, që nacionalistët e vërtetë i kanë busull orientuese në gjithë rrjedhën e veprës së tyre kombëtare.

Nacionalistët e vërtetë shqiptarë gjithnjë kanë qenë realist dhe dinamikë. Prandaj edhe kombi ynë ka arritur të mbijetojë me gjithë traumat që ka pasur nëpër shekuj, të cilat kombe edhe më të mëdhenj se kombi ynë i kanë zhdukur nga historia e nga planeti tokë. Ky fakt na lejon të dalim në

përfundimin e nacionalistët shqiptarë kanë qenë të suksesshëm në veprën e tyre. Por tërheq vëmendjen fakti se nacionalistët e vërtetë kanë pasur fuqinë për ta bërë drejtësinë me fjalë, me politikë dhe me armë. Ama sa ka përfunduar procesi i bërjes, kur ka filluar administrimi i arritjes, kanë dalë në sipërfaqe nacionalistët mashtrues, të cilët të ndodhur pranë kolltukut të qeverisjes dhe të pushueshëm, kanë marrë në dorë frenat e pushtetit dhe kanë administruar si kanë dashtë vetë, jo sipas objektivave të nacionalistëve të vërtetë të cilët e bënë veprën kombëtare. Dhe ajo që është më e keqja, këta nacionalistët mashtrues, të cilët në kushtet e lirisë kanë qasje edhe në media e edhe në kapacitete të burimeve financiare, fillojnë e etiketojnë nacionalistët e vërtetë, i përfolin, i akuzojnë, i emërtojnë me emërtime përcmuese, i akuzojnë për vepra kriminale, i përçajnë, i quajnë se kanë pasur synime kundërkombëtare etj. A nuk ka ndodhur kështu në Kosovë? A nuk po ndodhë edhe sot e kësaj dite e njëjta gjë? A nuk jemi edhe sot përballë të gjitha shëmtive e llumit që prodhojnë gjirizet e ndyra të armiqve, ku pa u tronditur, me shumë kënaqësi e dëshirë po mbështeten edhe ata që prej vitit 1999 kanë marrë pushtet në Kosovë e po vijnë edhe sot të venë etiketime mbi luftëtarët e lirisë që me gjak e sakrifica na sollën lirinë dhe na krijuan shtetin? Shikoni kush po e bën këtë prej vitit 1999 e deri sot. Pikërisht të vetëshpallurit nacionalistë pa hedhur asnjë hap në bërjen e Kosovës të lirë dhe shtet të pavarur e sovran.

Ata që e deshën dhe e duan Kosovën dhe kombin shqiptar më shumë se gjithkush tjetër, e kanë treguar me luftën e tyre dhe me sakrificat e gjakun e tyre se mbi atdheun dhe lirinë e tij nuk venë asgjë, as jetën e tyre. Ata e bënë luftën. Por duke fituar lirinë për atdheun humbën lirinë e tyre. Sot të gjithë luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë të kërcënuar nga klani pengmarrës që duhet gjykata Speciale për krimet e luftës së UÇK-së, vetëm sepse dikush nuk duhet të marrë vlera, pasi pa mohuar vlerat e luftëtarëve të UÇK-së askush nuk mund të ketë vlera të shtuara që të tjerët ta nderojnë. Prandaj duhet bërë kështu.

Ka ndodhur në vitet '70 në Tiranë që një shkencëtarë ushtarak i nivelit të lartë i cili të gjitha tekstet mësimore të akademisë ushtarake i kishte punuar vetë dhe mbanin emrin e tij, u akuzua nga të tjerë se tekstet i kishte punuar duke shfrytëzuar literaturë borgjezo – revizioniste, prandaj duhej hequr nga detyra dhe duhej burgosur e tekstet duheshin djegur. Dhe ashtu ndodhi. Shkencëtari përfundoi në burg se bashkëkolegët e akuzuan, tekstet e tij u dogjën dhe bashkëkolegët i ribotuan ato tekste por tani me emrin e tyre dhe ”pa shfrytëzimin e literaturës borgjezo - revizioniste”. A kështu do të vijnë gjithnjë? A kështu fitohen vlera? A kështu mendohet se duhet të lejohet të na sundojnë pseudonacionalistët? Mirë është

që të ndalen nga kjo mësymje të ashtuquajturit nacionalistë sepse po e dëmtojnë çështjen kombëtare për interes të tyre e besoj se do të vijë një ditë që do t'u kërkohet llogari, sepse në këtë botë gjithnjë haku ka shkuar te i zoti e kjo rrjedhë nuk ka për të ndryshuar për hatër të askujt.

Mendoj se ka ardhur koha kur nacionalizmi të mos mund të përdoret më si strehë e atyre që nuk duan të bëjnë sakrifica, e atyre që nuk i vlerësojnë detyrimet kombëtare, e atyre që nuk kanë nderim për atdheun e kombin, e atyre që kanë urrejtje, e atyre që kanë smirë, e atyre që mbivlerësojnë veten, e atyre që venë interesat e tyre mbi interesat e kombit, e atyre që nuk kanë dashuri për t'u dhënë të tjerëve, e atyre që janë të mbushur me urrejtje, e atyre që nuk duan të vetëzhvillohen e të zhvillojnë edhe të tjerët, e atyre që nuk e duan punën, e atyre që nuk duan të ndërtojnë të ardhme të sigurt për atdheun e kombin por shkojnë me mendimin: pas meje le të bëhet kiameti.

Ashtu sikurse kërkoj që kush thirret në emër të qenies nacionalistë duhet të deklarojë se nuk do të bëjë asnjë lëshim në dëm të interesave të atdheut e kombit për hatër të askujt e me diktatin e askujt. Ai që mendon se lirinë na e kanë sjellë të tjerët, se na mbrojnë të tjerët, se për ne punojnë të tjerët, se ne duhet të jemi të përlulur para të tjerëve, se ne duhet t'i mbajmë armët ulur ose të mos kemi armë fare se na kanë kujdes të tjerët, nuk kanë të drejtë të thirren në nacionalizëm dhe ta quajnë veten nacionalistë. Për këtë duhet drejtuar nacionalistëve të vërtetë, sepse pa të tillët nuk mund të ketë të ardhme të kombit e as liri të atdheut. Të cilët megjithëse një pjesë të tyre na i kanë marrë peng në Hagë vetëm për të na dobësuar, as që bëhet fjalë se mund të na bëjnë të lëkundemi në qëndrimet tona për të ardhmen kombëtare shqiptare.

Këtë e tregoi edhe ajo lufta e vogël që ndodhi më 24 shtator 2023 në veri të Kosovës. Ajo luftë, që megjithëse e vogël, tregoi gjithë madhësitinë kombëtare të kohës, është treguesi se luftëtarët janë aty, të gatshëm për ta bërë luftën e tyre për atdheun e kombin. Ja pra, ata luftëtarë të atij fronti dhe komandanti që e udhëhoqi atë operacion janë atdhetarët, janë nacionalistët e vërtetë. Kush të jetë si ata është vërtet nacionalist dhe kombi duhet t'i besojë.

Megjithëse unë e di se shqiptarët, sa herë të shfaqen probleme në Ballkan i konsiderojnë fajtorë dhe se ata kanë shfaqur nacionalizëm. A thua se janë shqiptarët fajtorë, që territoret e tyre i kanë të copëtuara në gjashtë shtete. A thua se janë shqiptarët fajtorë pse nuk mund të qëndrojnë më në pozicionin e skllavit në kohën e Evropës moderne. Prandaj nëse duan të rrinë urtë shqiptarët le t'i lënë në të drejtën e tyre kombëtare dhe qytetare. Shqiptarët nuk mund të vdesin që të kënaqen serbët e grekët. Jo, shqiptarët do të jetojnë dhe do të sundojnë përjetësisht në tokat e tyre, edhe në ato që akoma nuk i kanë çliruar.

Posaçërisht për “Epokën e re”



SHKRUAN: FERAT SHALA

Pabarazia, model i qeverisjes në Kosovë

“Qeveritë populiste shpesh përdorin pabarazinë si një mjet për ta ndarë shoqërinë dhe për të mbajtur një segment të popullsisë në varësitë e tyre, duke kërcënuar kështu thelbin e demokracisë”, Amartya Sen

Këtë thënie adekuate për shoqërinë tonë, me theks të veçantë për qeverinë, po e elaborojmë duke marrë për bazë momentin aktual, social e ekonomik të Republikës së Kosovës, në relacion me veprimet qeveritare. Për ta ilustruar dhe argumentuar thënien e lartshënuar, do t'i analizojmë dy veprime/argumente të fundit që qeveria ka ndërmarrë. Veprime këto që mbjellin pabarazinë, varshmërinë dhe shkeljen e parimeve demokratike dhe civilizuese, siç është Kushtetuta. Shembulli i parë ilustrues është ndarja e buxhetit për vitin 2024, i dyti Ligji për Fondin Sovran.

1. Ndarjet buxhetore 2024

Në çdo shoqëri demokratike parim bazë është barazia sociale dhe politike. Fatkeqësisht kjo nuk po ndodh në Qeverinë e Kosovës, e cila në Ligjin për Buxhetin ka shpërfaqur vetitë politike, egot

individuale dhe klanore, hakmarrjen dhe pabarazinë më të lartë në raport me rajone dhe me kategori të caktuara të shoqërisë, krejtësisht mbi bazën e një historie politike nga e kaluara deri më sot. Qeveria e Kurtit, si asnjëherë më parë, diskriminoi me buxhet kategoritë e dala nga lufta, pjesëtarët e ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) të cilët vunë themelet e këtij shteti të cilin e kemi sot. Kjo qeveri goditi rëndë me buxhet komunat të cilat politikisht dhe historikisht nuk ishin votues të partisë në pushtet. Shih ndarjet buxhetore për komunat Skenderaj, Drenas, Kaçanik, Mitrovicë etj. Cili pushtet dhe cila qeveri mund të pajtohet me logjikën që në komuna të caktuara të ketë zero projekte kapitale të reja siç ka ndodhur me këtë ndarje buxhetore për vitin 2024? Nuk mund ta argumentojmë ndryshe, përveçse orvatje për të krijuar varësi elektorale për kategoritë sociale dhe biznese

të caktuara, të cilat do të jenë përfitues të 32 për qind të totalit të buxhetit (prej 1.1 miliard eurosh), krejt kjo në zërin buxhetor të subvencioneve. Definitivisht më shumë se politika majtiste mund t'i quajmë këto, për faktin se këto nuk kanë asnjë premisë zhvillimore, strategjike, nuk kanë asnjë premisë të hapjes së vendeve të punës, të rritjes së prodhimit vendor, të eksporteve, pra e vetmja premisë e këtij buxheti është krijimi i kategorive që kanë varësi nga subvencionet ose paraja cash e shpërndarë nga “autoriteti/lideri i mitizuar” si shpëtimtar.

2. Ligji për Fondin Sovran

Kultura dhe mentaliteti i liderit për të kontrolluar gjithçka me çdo mjet e praktikë, pa analizë e pa të ardhme, e kamufluar me kopje të zbehtë nga shtete të caktuara perëndimore, është edhe Ligji për Fondin Sovran, i cili ka kaluar tashmë në Kuvendin e Kosovës, pa vota të opozitës. Në esencë, këtu kemi shpërfaqjen më ekstreme të orvatjes së liderit, për të vendosur dorën politike mbi asete dhe resurse të cilat nuk mund të qeverisen dhe nuk

kanë perspektivë me këtë logjikë ekstreme majtiste, centraliste, në kundërshtim me parimet e tregut të lirë e të konkurrencës.

Praktikat e shteteve tregojnë se formimi i Fondit Sovran ka ardhur si rezultat kur janë shfaqur teprica të burimeve natyrore shtetërore të njohura si;

- rezervat e tepërta nga të ardhurat,
- tepricat tregtare,
- rezervat bankare që mund të grumbullohen nga tepricat buxhetore,
- operacionet në valutë të huaj,
- paratë nga privatizimet dhe
- pagesat e transfereve qeveritare.

Nëse merren për bazë këto parime, Ligji aktual i Fondit Sovran të Kosovës është në kundërshtim të plotë, pasi që asnjë nga këto parime nuk i plotëson ky ligj. Në rastin e Kosovës kemi të bëjmë me bartje të aseteve dhe jo me tepricën e pasurisë kombëtare. Po ashtu të gjitha ndërmarrjet që janë propozua të jenë pjesë e Fondit Sovran operojnë me humbje dhe kanë rezultuar financiar negativ, përjashtoj këtu KEK-un. Këto humbje janë thelluar në vitet 2022/2023, edhe pse është rritur financimi

nga Qeveria me rreth 40 milionë euro.

Nuk ka asnjë argument të qëndrueshëm analitik, swot analizë, costbenifit, që japin garancitë që Fondi Sovran do të ndikojë në stabilitetin ekonomik. Të gjitha praktikat e shteteve tjera, por edhe parimet e Santiagos, marrin për bazë që fondet sovran të pasurisë, menaxhojnë tepricën e pasurisë kombëtare, jo asetet bazë.

Për shembull, çfarë ofron Trainkos si vlerë e shtuar, kur dihet se operon me humbje, apo shumica e kompanive që kanë menduar të investojnë/bartin në Fond, janë me humbje siç paraqiten edhe në raportin e performancës. Nuk ka argumente të qëndrueshme pse është e nevojshme që Kosova të ketë një Fond dhe çfarë ofron kjo për ekonominë e vendit, le të themi në raport me atë që ka bërë deri me tani Agjencia Kosovare e Privatizimit!?

Ku qëndron dallimi në mes të Fondit Sovran dhe AKP-së, pasi që ligji i AKP-së ofron pothuajse të gjitha mundësitë për investim, shitje, transformim apo dhënie me qira të aseteve të NSH-ve edhe tani. Është e rëndësishme të

Sektori i emergjencave civile vazhdon të mbetet i neglizhuar në Kosovë



TAHIR AHMETI

Sektori i emergjencave civile në përgjithësi dhe shërbimi i zjarrfikjes dhe shpëtimit në veçanti po hyn në vitin 2024, i patrajtuar dhe i anashkaluar, me probleme të mëdha të grumbulluara e të pazgjidhura. Rregullimi juridik i shërbimit të zjarrfikjes dhe shpëtimit, përmirësimi i kushteve të punës dhe mjeteve e pajisjeve, kompensimet e duhura në bazë

të ligjeve, janë domosdoshmëri dhe, për të arritur këtë, qeveria duhet ta ndryshojë qasjen në raport me emergjencat civile. Qasje tjetër sigurisht nënkupton vendosje të vëmendjes buxhetore, njerëzore dhe teknike për këtë dikaster të rëndësishëm të sigurisë në vend. Emergjencat civile duhet të vendosen në prioritet në vitin që vjen. T'i jepet vëmendje e plotë

institucionale, fatkeqësisht e munguar deri më tash.

Ka mungesë të planifikimeve dhe mungesë të burimeve në këtë sektor.

Çështje tjetër që duhet fokusuar, po ashtu, është nevoja për koordinim më të mirë ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe ngritje të gatishmërisë së institucioneve, kur kemi të bëjmë me reagimin e tyre në rast

të ndonjë fatkeqësie natyrore. Gjithashtu, duhet të punohet për ngritjen e vetëdijes së popullatës në raport me rrezikun nga fatkeqësitë natyrore dhe njohjen me rolin e emergjencave në trajtimin e këtyre fatkeqësive.

Situatat emergjente kërkojnë reagim të menjëhershëm dhe të saktë.

Menaxhimi i emergjencave

është me rëndësi sepse jo të gjitha rreziqet nga fatkeqësitë natyrore mund të parandalohen, por institucionet gjithmonë duhet të jenë të gatshme të intervenojnë për t'i shkurtuar apo zvogëluar dëmet njerëzore dhe materiale.

Pra, viti 2024 duhet të jetë vit i ndryshimit të qasjes së qeverisë në raport me emergjencat civile. Ky ndryshim duhet të ndihet.

merret parasysh fakti që Fondi Sovran është në kundërshtim me Nenin 10 të Kushtetutës, pra me parimet e ekonomisë së tregut të lirë.

Në kundërshtim me këtë parim, ku në Fondin Sovran shuhet liria e ndërmarrësisë dhe shpirti ndërmarrës i të rinjve dhe të rejave, bizneseve në Kosovë, marr parasysh faktin se afër 90 për qind e bizneseve në Kosovë janë biznese individuale, nga të cilat Qeveria mbledh taksat, dhe

financon Fondin Sovran. Përkrahje selektive duke financuar me taksa dhe kapital shtetëror Fondin Sovran dhe ndërmarrjet shtetërore, të cilat nuk janë të barabarta në kushtet e tregut me sektorin privat. Financimi i Fondit është një pikë shumë e diskutueshme, pse kapitali fillestar i Fondit duhet të jetë barrë e buxhetit të shtetit apo taksave të qytetarëve. Neni 19 Kapitali themeltar dhe aksionet, pika 1 dhe 2; në kundërshtim të plotë me Nenin

10 të Kushtetutës. Ky parim i diskriminon 90 % të ndërmarrjeve të sektorit privat. Nëse bazohemi në atë që Republika e Kosovës siguron mjedis ligjor për tregti, ndërmarrësinë e lirë dhe sigurimin e pronës private dhe publike, si mund të minimizohet diskriminimi në treg, pasi fondi është, le të themi, një "ndërmarrje e madhe" që mund të ketë një portofol të gjerë, mund të ketë fonde të mëdha, që potencialisht nuk përfaqëson

konkurrencë të ndershme në treg në raport me bizneset e tjera.

Aspekti i pavarësisë dhe qeverisjes së Fondit është shumë i diskutueshëm, ka nuanca politike, dhe është instrument për akomodimin e interesave të ngushta politike të anëtarëve të partisë në pushtet. Fondi Sovran në aspektin menaxhues, do të krijoj mekanizma duplikues në strukturën e hierarkisë menaxheriale, dhe do të krijoj burokraci shtesë, gjë që edhe me

tepër do ta ndal efikasitetin dhe transparencën. Është e rëndësishme për t'u theksuar se menaxhimi i aseteve bazë nga fondet sovranë, duhet të bëhen me përgjegjësi dhe me synimin e zhvillimit afatgjatë të vendit. Përdorimi i arsyes dhe transparencës në procesin e vendimarrjes, është gjithashtu një element kyç për të siguruar që pasuria kombëtare të përdoret në avantazh të popullsisë dhe të shoqërisë në tërësi.



Ngjarjet më kryesore që përcollën botën në 2023

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Luftë e pamëshirshme në Ukrainë, një përpjekje për rebelim në Rusi, konflikt në Kaukaz, dhunë në Lindjen e Mesme, një verë me ngjarje të motit ekstrem, të nxitura nga ndryshimet klimatike. Këto janë disa prej ngjarjeve kryesore që karakterizuan vitin 2023.

Mbi 80 të vranë në sulmin vetëvrasës në një xhami në Pakistan

30 JANAR - Një sulmues vetëvrasës hodhi veten në erë brenda një xhamie plot me njerëz, në një kompleks policor, në Peshavar të Pakistanit, duke vrarë më shumë se 80 persona e duke plagosur të paktën 200 të tjerë. Për sulmin zyrtarët pakistanezë fajësuan organizatën Tehreek-e-Taliban

Pakistan, apo TTP, e cila e mohoi përfshirjen.

Tërmeti në Turqi dhe Siri ua merr jetën 50 mijë personave

6 SHKURT - Një termet prej 7.8 ballësh goditi Turqinë juglindore dhe pjesë të Sirisë, në orët e hershme të 6 shkurtit, i pasuar nga tërmete të shumta më të vogla. Numri i të vdekurve e kaloi shifrën 50 mijë në të dyja vendet. Tërmetet dëmtuan dhe shkatërruan qindra mijëra ndërtesa, duke lënë edhe një numër të madh të njerëzve pa strehë.

Lëshohet fletarrestim kundër Putinit

17 MARS - Gjykata Ndërkombëtare Penale lëshoi një fletarrestim ndaj presidentit rus Vladimir Putin, duke e

akuzuar atë për përgjegjësi për krime lufte të kryera gjatë pushtimit të vazhdueshëm të Ukrainës nga Rusia. Akuzat përfshijnë dërgimin e paligjshëm të fëmijëve dhe transferimin ilegal të njerëzve nga Ukraina drejt Rusisë. Kremlini e quajti vendimin të papranueshëm dhe tha se ky fletarrestim është i pavlefshëm brenda Rusisë.

Arrestohet ish-kryeministri i Pakistanit

9 MAJ - Agjencia Kundër Korrupsionit e Pakistanit e arrestoi ish-kryeministrin Imran Khan në Gjykatën e Lartë të Islamabadit. Khan ishte rrëzuar nga posti në vitin 2022 dhe përballej me akuzat se kundërligjshëm kishte shitur dhurata shtetërore dhe kishte fshehur pasuri si kryeministër. Mbështetësitë e tij u ngritën kundër arrestimit të tij, teksa

policia shtypi protestat duke përdorur gaz lotsjellës dhe topa uji.

Charles III, zyrtarisht Mbret i Anglisë

6 MAJ - Në Angli është mbajtur ceremonia madhështore dhe fetare në Westminster Abbey për kurorëzimin e monarkut Charles III. Kurorëzimi është ndjekur nga shumë personalitete që kanë marrë pjesë nga e gjithë bota dhe mijëra njerëz që ishin mbledhur në Londër. Kryepeshkopi i Canterbury Justin Welby ia ka vendosur kurorën e Shën Eduardit mbi kokë Charles III, pjesa më e rëndësishme e shërbimit të kurorëzimit. Kjo është hera e vetme që Charles do ta mbajë kurorën e Shën Eduardit, e cila është e rezervuar për kurorëzimin e një monarku të ri. Mediet britanike kanë shkruar se ky është kurorëzimi i parë i

Britanisë në 70 vjet, teksa kurora 360-vjeçare është mbi 30 cm e gjatë, me peshë rreth 2.23 kg dhe e bërë prej ari të ngurtë 22 karatësh.

Erdogani rizgjedhet president i Turqisë

28 MAJ - Rexhep Tajip Erdogan është shpallur edhe një herë fitues i zgjedhjeve presidenciale në Turqi, duke e mposhtur kështu rivalin e tij Kemal Kilicdaroglu. Erdogan tash e nëntë vjet e udhëheq vendin si president, ndërkaq pjesë e udhëheqjes së shtetit ka qenë që 20 vjet. Në vitet 1970 dhe 1980 Erdogan ishte aktiv në qarqet islamike, duke iu bashkuar Partisë pro-islamike të Mirëqenies. Në vitin 2001 ai themeloi një parti të re, me rrënjë islamike, Partinë për Drejtësi dhe Zhvillim (AKP), ku në vitin 2002 AKP kishte fituar shumicën në





zgjedhjet parlamentare dhe që atëherë ka qeverisur vendin. Erdogan ishte kryeministër i Turqisë nga viti 2003 deri më 2014, duke kaluar pastaj po këtë vit në president të vendit. Prej 2018-s në Turqi presidenti është kreu i shtetit, i cili drejton edhe qeverinë. Zyra e kryeministrit nuk ekziston më.

Rusia shkatërron digën Nova Kahovka në Ukrainë

6 QERSHOR - Shpërthimi i digës Nova Kahovka në lumin Dnjepër shkaktoi vërshime masive në një zonë të okupuar nga Rusia në Jug të Ukrainës. Fshatra dhe qyteza u përmytën, ndërsa mijëra njerëz u detyruan të evakuhohen. Ukraina akuzoi Rusinë, e cila kontrollonte digën që nga muaji e hershëm të vitit 2022, për sabotim të qëllimshëm. Zyrtarët rusë në territoret e okupuara në bregun lindor të Dnjepit thanë se ishte Ukraina ajo që shkatërroi digën për ta larguar vëmendjen nga mungesa e sukseseve në fushëbetejë.

Kanadaja dhe ShBA-ja përfshihen nga zjarret

7 QERSHOR - Zjarret pyjore u përhapen nëpër Kanada ndërsa tymi arriti deri në lindje të Shteteve të Bashkuara duke ngritur alarmin për cilësinë e ajrit, qindra kilometra larg vatrave të tyre. Për zjarret e përhapura u fajësua moti i pazakonshëm i nxehtë dhe i thatë, i nxitur nga ndryshimet klimatike. Ngjarje të tjera të shkaktuara nga moti ekstrem u regjistruan më vonë gjatë verës. Muaji korrik ishte muaji më i nxehtë i regjistruar, ndërsa pjesë të mëdha të Evropës u ballafaquan me përmytje dhe zjarre të rrezikshme gjatë gushtit.

Ndërron jetë Silvio Berlusconi

12 QERSHOR - Ish-kryeministri i Italisë, i cili ishte përballur me skandale të shumta, është ndarë nga jeta në moshën 86-vjeçare. Përtej përpjekjeve të tij politike, ai

ishte një biznesmen i suksesshëm, dhe njihet për themelimin e kompanisë më të madhe mediatike italiane. Kryeministri italian më jetëgjatë i pasluftës është përfshirë në skandale dhe akuza për korrupsion. Ai e ka udhëhequr Italinë tri herë midis viteve 1994 dhe 2011, gjithsej për 9 vjet.

Wagneri merr nën kontroll Rostovin, vritet Prigozhini

24 qershor - Forcat e armatosura të grupit mercenar Wenger, të udhëhequra nga Yevgeny Prigozhin, morën kontrollin e qytetit jugor rus Rostov. Prigozhini dërgoi disa prej forcave private të tij drejt Moskës, duke e quajtur avancimin “marsh për drejtësi”, për largimin e komandantëve të korruptuar ushtarakë, që ia i fajësoi për humbjet në Ukrainë. Kremlinin arriti një marrëveshje me Prigozhinin për t'i dhënë fund rebelimit, duke thënë se udhëheqësi i mercenarëve do të largohet drejt Bjellorusisë, dhe se ndaj tij nuk do të zhvillohet rast penal. Prigozhini dhe udhëheqës të tjerë të Wangerit më vonë u konfirmuan të vdekur, pas rrëzimit të një avioni në rajonin rus Tver, më 24 gusht.

Mbahen protesta masive kundër kodeve të veshjeve të grave në Iran

15 KORRIK - Në korrik në Iran vazhduan protestat masive kundër zbatimit të kodeve të ashpra të veshjes fetare për gratë. Në Teheran gratë dhe vajzat hoqën shamtë e tyre të kokës në një teatër plot njerëz. Në Rasht demonstruesit u ballafaquan me policinë, e cila u përpoq t'i arrestonte gratë protestuese. E ashtuquajtura “polici e moralit” e Iranit shtoi patrullimet për t'i zbatuar kodet e veshjes, mes zemërimit dhe protestave në mbarë vendin, pas vdekjes së një gruaje iraniane, MahsaAmini, gjatë kohës sa ishte në paraburgim në shtatorin e vitit 2022. Ajo ishte arrestuar për shkak se gjoja nuk e kishte veshur si duhet hixhabin.

Ngrehet aktakuzë kundër Donald Trumpit

1 GUSHT - Departamenti amerikan i Drejtësisë akuzoi ish-presidentin Donald Trump për konspiracion për mashtrimin e Shteteve të Bashkuara përmes pengimit të Kongresit për caktimin e fitores së presidentit Joe Biden në zgjedhjet e vitit 2020. Trumpi i hodhi poshtë akuzat. Më vonë gjatë muajit gusht Trumpi u ngarkua me disa akuza të tjera penale në shtetin e Xhorxhias, për korrupsion me bashkëpunëtorët e tij për ta zhbërë humbjen e tij zgjedhore më 2020. Ai, po ashtu, po përballet me akuza për mashtrim biznesor, për shkelje gjatë fushatës dhe për nxjerrje të dokumenteve të ndejshme nga Shtëpia e Bardhë në kohën kur ai po vazhdon garën e tij për t'u kthyer në pozitën e presidentit më 2024.

Azerbajxhani nis operacionin për ta rimarrë Nagorno-Karabakun

19 SHTATOR - Forcat azerbajxhanase nisën një operacion për ta rimarrë në kontroll Nagorno-Karabakun, një territor i kontestuar, i banuar me shumicë armene. Protestat shpërthyen në kryeqendrën e Armenisë, Jerevan, teksa turmat e zemëruara kërkuan dorëheqjen e kryeministrit Nikol Pashinian. Forcat separatiste armene në Nagorno-Karabakun u pajtuan për një armëpushim më 20 shtator, vetëm 24 orë pas fillimit të operacionit ushtarak. Sulmi shtyu mbi 100 000 armenë të ikin nga territori brenda më pak se një jave. Pashinian akuzoi Azerbajxhanin për “spastrim etnik” në rajon, një deklaratë që u mohua kategorikisht nga Bakuja.

Narges Mohammadi fiton Çmimin Nobel për Paqe

6 TETOR - Komiteti Norvegjez ia dha Çmimin Nobel për Paqe për vitin 2023 aktivistes iraniane për të drejtat e grave, Narges

Mohammadi, e cila po vuan një dënim me burgim prej 12 vjetësh. Komiteti i Nobelit i bëri thirrje Iranit ta lirojë Mohammadin, e cila ka bërë fushatë për të drejtat e grave dhe për shfuqizimin e dënimeve me vdekje. Ajo ishte ndër mijëra protestuesit e arrestuar gjatë demonstratave masive më 2022.

Hamasi sulmon Izraelin, lufta vazhdon

7 TETOR - Grupi radikal palestinez Hamas nisi një sulm të befasishtë në jug të Izraelit, duke lëshuar raketa nga Gaza dhe duke dërguar luftëtarë matanë kufirit. Sulmuesit e Hamasit vranë mbi 1 200 persona dhe morën pengë rreth 240 izraelitë. Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, u tha qytetarëve se vendi ndodhej në luftë. Izraeli u kundërpërgjigj me bombardimin më të ashpër të Rripit të Gazës në historinë 75-vjeçare të konfliktit të tij me palestinezët. Gjatë muajve pasues sulmet ajrore dhe tokësore vranë më shumë se 18 600 palestinezë. Rreth dy milionë njerëz u detyruan të largohen nga shtëpitë e tyre, duke nxitur kritika ndaj operacioneve të Izraelit nga ana e disa qeverive të huaja.

Afganistani goditet nga tërmetet

7 TETOR - Një varg tërmetesh goditën provincën e Heratit në Afganistan dhe në ditët pasuese duke shkaktuar shkatërrim të madh. Shpëtimtarët nxituan të gjejnë të mbijetuar mes rrënojave, disa prej të cilëve u dërguan në spitale me transport ajror. Organizata Botërore e Shëndetësisë tha se gati 1 500 njerëz u mbytën nga tërmetet.

Pakistani dëbon dhjetëra mijëra afganë

30 TETOR - Në fund të tetorit dhjetëra mijëra afganë që jetonin në Pakistan nxituan drejt kufirit para skadimit të një afati që u

kërkonte atyre të largoheshin nga vendi. Islamabadi tha se rreth 1.7 milion refugjatë dhe emigrantë pa dokumente duhej të largoheshin deri më 1 nëntor, në të kundërtën do të përballeshin me arrestim dhe dëbim. Vendimi nxiti kritika të shumta nga agjencitë e OKB-së dhe grupet për të drejtat e njeriut. Mbi 400 000 njerëz hynë në Afganistan deri në dhjetor, teksa grupet humanitare thanë se shumë njerëz nuk kishin strehim adekuat, ushqim, ujë të pijshëm dhe tualete.

Henry Kissinger ndërron jetë në moshën 100-vjeçare

29 NËNTOR - Diplomati amerikan dhe nobelisti Henry Kissinger ka ndërruar jetë në moshën 100-vjeçare. Duke shërbyer si këshilltar i shquar i presidentëve Richard Nixon dhe Gerald Ford, Kissingeri kishte pasur ndikim të fuqishëm në politikën e jashtme të ShBA-së. Ndërsa shumë e admiruan përvojën e tij, të tjerë e cilësuan si “kriminel lufte për shkak të mbështetjes së tij për diktaturat”, veçanërisht atë të Amerikës Latine. Në vitin 1973 Kissingerit dhe Le DucTho të Vietnamit u është dhënë dhe ndarë çmimi Nobel për Paqe. Kjo përzgjedhje bëri që ata të jepnin dorëheqje, e cila është thënë se kishte ardhur shkaku i bombardimit sekret amerikan të Kamboxhias.

BE-ja pajtohet për hapjen e negociatave me Ukrainën

14 DHJETOR - Teksa Ukraina po vazhdon një luftë gati dyvjeçare kundër pushtimit rus, Bashkimi Evropian u pajtua për hapjen e bisedimeve për anëtarësim me vendin e dërrmuar. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky mirëpriti vendimin si votim besimi ndaj Ukrainës, teksa ajo po kërkon ndihma për luftën e saj, përfshirë fondet e propozuara nga Shtetet e Bashkuara që po vazhdojnë të kundërshtohen në Kongres.





Ngjarjet më të mëdha kulturore gjatë vitit 2023 në vendin tonë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Arkeologjia në 2023-n ka zë vëmendje të veçantë nga Ministria e Kulturës, ku u zbulua mbishkrimi i Perandorit Justinian në qytetin dardan të Ulpianës. Ky projekt i MKRS-së i gërmimeve në bashkëpunim me Francën dhe Italinë vazhdon drejt zbulimeve të reja edhe në vitin 2024.

Edhe viti 2023 ishte vit i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, promovimit të artit dhe monumenteve të shpëtuar falë ndërhyrjeve emergjente dhe restaurimeve. Gjithashtu, përmes skemave të granteve është përkrahur komuniteti i artit dhe trashëgimisë kulturore. Gjatë vitit 2023 me gjashtë akte nënligjore është kompletuar edhe legjislacioni i trashëgimisë kulturore. Një nga to është edhe rregullorja për gërmime arkeologjike.

Muzeu i Kosovës në vitin që lamë pas u bë pjesë e ekspozitës “First Kings of Europe” në Shtetet e Bashkuara, ku po ekspozohet një pjesë e thesarit arkeologjik të Kosovës.

Nga data 4 deri më 12 gusht është organizuar edicioni i 22-të i Festivalit Ndërkombëtar “Dokufest”. Në festivalin i cili u

mbajt në Prizren morën pjesë shumë artdashës nga Evropa, për të përjetuar këtë edicion, pjesë e të cilit ishin 105 filma që u shfaqën për nëntë ditë me radhë. “DokuFest” u është bashkuar shtatë festivaleve kryesore të dokumentarëve në Evropë për nominimin e një filmi të metrazhit të gjatë dhe një filmi të metrazhit të shkurtër për çmimet “Doc Alliance”. Këtë vit në Prishtinë është organizuar edicioni i 15-të i Festivalit të Filmit “PriFest”. Nga data 12 deri më 17 shtator filma vendorë dhe ndërkombëtarë garuan për çmimet e rëndësishme të festivalit në kategorinë e filmit të metrazhit të shkurtër dhe të mesëm.

Nga zbulimet arkeologjike e deri te festivalet e muzikës, ky vit pati një shumëllojshmëri të veprimtarive që kanë mbushur skenën kulturore me emocion dhe kreativitet, mirëpo ne kemi ndarë me ju vetëm disa nga ngjarjet që shënuan vitin 2023.

Miratohet Projektligji për Artin dhe Kulturën

Kuvendi i Kosovës në dhjetor ka miratuar Projektligjin për Artin dhe Kulturën. Ky ligj i ri do të ofrojë kushte më të favorshme për krijimtari artistike, më pak burokraci, më shumë program artistik e

kreativitet, forma të reja të mbështetjes së institucioneve publike të artit dhe skenës kulturore, bazë ligjore për themelimin e Muzeut të Artit Bashkëkohor dhe Këshillit Kombëtar të Arteve, njohje ligjore të skenës së pavarur dhe statusit të artistit të pavarur e artistëve meritore. Me këtë ligj vendoset standard i ri, politikë kulturore me vizion të qartë zhvillimor.

Kosova bëhet anëtare e EYCA-s

Kosova është anëtarësuar në Organizatën Ndërkombëtare EYCA - European Youth Card Association (Shoqata Evropiane e Kartës Rinore). Me seli në Bruksel, EYCA bën bashkë 30 shtete të Evropës të cilat lëshojnë Kartën Evropiane të Rinisë për mbi 7 milionë të rinj. Pas aplikimit të suksesshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, qeveria do ta ofrojë kartën pa pagesë për të gjithë të rinjtë nën moshën 30-vjeçare, pavarësisht gjinisë, përkatësisë etnike, aftësive apo statusit socio-ekonomik. Karta do të jetë e qasshme në formë digjitale, në të gjitha gjuhët zyrtare të vendit tonë. Karta do t’u japë të rinjve qasje në mbi 60 000 zbritje dhe benefite në transport, akomodim, kulturë,

sport, arsim, shërbime dhe produkte kudo në Evropë.

Autostrada Biennale, ndër 10 ekspozitat më të mira në Evropë

Autostrada Biennale është përzgjedhur një nga 10 ekspozitat më të mira në Evropë për vitin 2023 nga Frieze Edicioni i katërt i Autostrada Biennale, “Të gjitha imazhet do të zhduken, një ditë” kuruar nga Joanna Warsza dhe Övül Ö. Durmusoglu, është vlerësuar nga magazina Frieze si një nga 10 ekspozitat më të mira në Evropë për vitin 2023. Autostrada Biennale e cila nisi rrugëtimin fillimisht në Prizren, pastaj u shtri edhe në Prishtinë, Mitrovicë e Pejë ka mbështetës kryesor Ministrinë e Kulturës.

Filharmonia e Kosovës përmbylli 2023-n me mbi 50 aktivitete

Një vit i jashtëzakonshëm i Filharmonisë së Kosovës, e cila e përmbylli 2023-n me mbi 50 aktivitete. Viti 2024 do të jetë ende më emocionues. Parapërgatitjet për koncertin e 25-vjetorit të Çlirimit të Kosovës kanë filluar qysh tash, ashtu sikur për aktivitetet e

tjera që do t’i sjellin për publikun në Kosovë dhe jashtë saj.

Ndërron jetë artisti Mirush Kabashi

Më 5 dhjetor ka ndërruar jetë mjeshtri i teatrit dhe kinematografisë shqiptare, Mirush Kabashi. Ai ishte një nga interpretuesit më të mëdhenj të poezisë për kontributin e madh në rreth 100 role në teatër dhe filma duke veçuar atë të Sokratit tek “Apollogjia e fundit e Sokratit” që shënon kulmin e tij artistik, si prezantues e pedagog. Për të arriturat e tij flasin çmimet e shumta vendore e ndërkombëtare si dhe titujt “Nderi i Kombit”, “Artist i Merituar” dhe “Mjeshtër i Madh i Punës”.

Rita Ora dhe Taika Waititi në Kosovë

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, pritën më 27 nëntor në takim yllin botëror nga Kosova, Rita Ora, bashkëshortin e saj, regjisorin Taika Waititi, aktoren e producenten Odessa Rae, të dy fitues të çmimeve Oscar, si dhe Besnik Sahatçiu dhe Elena Orën. Gjatë takimit folën për



fushën e artit dhe kulturës në Kosovë.

Pasurohet koleksioni i Galerisë Kombëtare të Kosovës me 60 vepra të reja

Koleksioni i Galerisë Kombëtare të Kosovës është pasuruar me mbi 60 vepra të reja nga 40 artistët e përzgjedhur përmes thirrjes së këtij viti për blerjen e veprave, të cilët kanë filluar dorëzimin e veprave në GKK. Me një fokus të fortë në diversifikimin e koleksionit dhe duke përfshirë artistë dhe medime të nënpërfaqësuar dhe të reja, blerjet e fundit përfshijnë vepra si nga artistë të njohur ashtu edhe në zhvillim dhe mbulojnë një gamë të gjerë të temave dhe medimeve që variojnë nga skulptura dhe piktura te video dhe instalimet, punimet në letër, grafikat, fotografia, zëri dhe tekstili.

Kosova me Festival të Këngës

Për organizimin e kësaj ngjarjeje historike e madhështore më 27 tetor, Ministria e Kulturës ka dhënë 300 000 euro. Drejtori i Festivalit të Këngës në RTK, Adi Krasta dhe prezantuesi Besim Dina, ishin fytyrat kryesore të kësaj ngjarje të rëndësishme të cilët me një ndërthurje të mahnitshme moderuan gjithë festivalin. Ngjarja është më shumë se një festival. Është kthesë serioze për muzikën shqipe, duke e afruar më pranë zemrës së publikut dhe, njëkohësisht, duke e shtruar rrugën për në Eurosong.



Miratohet Projektligji për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta

Më 21 shtator deputetët e Kuvendit të Kosovës miratuan Projektligjin për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe 27 amendamentet e këtij ligji. Përmes projektligjit, ndër të tjera, do të sigurohet një nivel i lartë i mbrojtjes të të drejtave të autorit, krijimtarisë shkencore e artistike, rregullohet statusi i Task Forcës kundër Piratërisë, ofrohet mundësia e zgjidhjes së kontesteve në të drejtën e autorit përmes mjeteve alternative si ndërmjetësimi dhe arbitrazhi.

Vdes aktori Xhevat Qorraj

Më 23 gusht ka ndërruar jetë aktori Xhevat Qorraj. Përveç si artist i jashtëzakonshëm i roleve dhe çmimeve të shumta, Qorraj ishte një figurë e respektuar dhe aktivist i përkushtuar për kulturën. Përmes angazhimit të tij për të promovuar vlerat e artit, ai ka ndikuar në ndërgjegjen kulturore të shoqërisë. Kontributi i tij i veçantë për artin dhe kulturën e Kosovës ka bërë që emri i tij të mbetet një shembull frymëzues për të ardhmen.

Baleti Kombëtar i Kosovës sjell dy çmime nga Italia

Prania kulturore e Kosovës në skenën ndërkombëtare është lartësuar edhe në vitin 2023. Performanca magjepsëse “Shtegtim”, e realizuar në mënyrë të përsosur nga trupa e Baleti Kombëtar i Kosovës, pas shfaqjeve në dy qytetet italiane,

Villapiana dhe Altomonte, ka siguruar dy çmime. Më 17 korrik balerinët Fatmir Smani dhe Aulonë Nuhii u shpërblyen nga Festivali Ndërkombëtar ‘Finì Dance Festival’, në kategoritë ‘Kërcimtari më i mirë’ dhe ‘Kërcimtarja më e mirë’. Ky sukses është dëshmi e talentit, pasionit dhe punës së palodhur të balerinëve tanë.

Vdes Shyqri Nimani, kaligrafisti i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës

Më 22 qershor ka ndërruar jetë profesori dhe artisti kombëtar Shyqri Nimani. Ai la prapa një karrierë të bujshme dhe gjurmë të thella artistike. Teksa kujtojmë vetëm disa nga veprat e tij, si dorëshkrimin e artë në aktin themeltar të shtetit tonë, Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, krijimin e logos identifikuese të Grand Hotelit, Kosova Filmit deri te simboli i Universitetit të Prishtinës, Nimani me meritë të plotë e të padiskutueshme ka zënë një vend nderi në listën e gjatë të krijuesve dhe studiuesve të kohës sonë.

Miratohet Ligji për Kinematografinë në Kosovë

Më 15 qershor Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Kinematografinë, i cili i dërgon filmat tanë në nivele më të larta të suksesit ndërkombëtar. Me miratimin e këtij ligji niveli i mbështetjes publike për nivelin e filmave ngrehet 80 %, ndërsa për filmbërësit deri në 100 %. Krijohet skema e rabatit për tërheqje të investimeve të huaja



në Kosovë, që parasheh rimbursimin e 30 % të investimit për produksionet e huaja që prodhojnë filma në territorin e Kosovës. Këto janë vetëm disa nga risitë në ligjin e ri.

Hapet Pavijoni i Kosovës në edicionin e 76-të të Festivalit të Kanës

Për të dymbëdhjetin vit me radhë, më 17 maj, Qendra Kinematografike e Kosovës prezantohet në tregun më të rëndësishëm të filmit ‘Marche Du Film’ në Festivalin e Kanës. Ndër të tjera, do të promovohen filmat e fundit kosovarë në kategori dhe faza të ndryshme të zhvillimit, takime me partnerë ndërkombëtarë të kinematografisë, fonde filmi, përfaqësues të festivaleve të rëndësishme ndërkombëtare, producentë e distributorë.

Lansohet programi “Arti në shkollë”

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe institucione të tjera partnere në nivelin qendror dhe lokal, më 12 maj u lansua programi ndërmintor “Arti në Shkollë”. Programi parasheh orë të veçanta të artit të cilat do ta sjellin artistin në klasën shkollore; vizitat direkte në institucionet kulturore dhe në monumente të trashëgimisë kulturore; organizmin e nxënësve për pjesëmarrje në shfaqje të ndryshme artistike; themelimin e art klubeve në shkollë, që do të shërbejnë si platforma për aktivizmin e nxënësve që shprehin interesim dhe talent në cilëndo gjini të caktuar artistike: lexim, teatër,

muzikë, trashëgimi kulturore apo të tjera.

44 asete nga lista e trashëgimisë kulturore në rrezik mbrohen përmes programit të MKRS-së

44 asete nga lista e trashëgimisë kulturore në rrezik do të mbrohen përmes programit të MKRS-së për ndërhyrje konservuese - restauruese. Kërkesa për rialokim të mjeteve financiare është aprovuar në mbledhjen e 12 prillit të Qeverisë së Kosovës. Në këtë mbledhje u tha se përmirësimi i gjendjes fizike të aseteve të trashëgimisë kulturore në rrezik dhe rifunksionalizimi i tyre mbetet ndër prioritetet kryesore.

Vdes arkeologia Edi Shukriu

Më 17 janar ka ndërruar jetë arkeologia Edi Shukriu. Edi Shkuriu ishte një emër i njohur në fushën e arkeologjisë, poezisë e veprimtare politike. Ajo inicioi dhe themeloi Degën e Antropologjisë në Fakultetin Filozofik, me drejtimet Antropologji Kulturore dhe Arkeologji, ku ligjëroi disa lëndë. Ishte autore e shumë botimeve monografike nga fusha e arkeologjisë dhe historisë, por edhe nga fusha e letërsisë. Veprimtaria e saj shkencore dhe profesionale në fushën e arkeologjisë dhe historisë antike, në mbrojtjen e integruar të trashëgimisë kulturore dhe prezantimit të trashëgimisë kulturore në vend, do të mbahet mend gjatë dhe do të çmohet gjithmonë.



‘EPOKA E RE’ PËR HERË TË PARË E PUBLIKOI FJALIMIN E RAMIZ CERNICËS



Ismet SYLEJMANI

Më 25 nëntor 2022, në Gjilan, u hodh gurthemeli për Shtatoren e Tribunit të Kombit Ramiz Cernica!

Më 28 nëntor 2023, u inaugurua Shtatorja e Tribunit të Kombit Ramiz Cernica në Gjilan!

Fjalimi historik i Deputetit të popullit shqiptar, Heroit të Kuvendit të Kosovës Ramiz Cernica, i mbajtur më 8 Korrik 1945, në Seancën e Parë Themeluese të Parlamentit të Kosovës në Prizren i dalë pas përfundimit të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të Luftës së Dytë Botërore, për herë të parë u bë e mundur të sigurohej dhe u publikua në portalin e gazetës Epoka e Re me 4 Gusht 2023!

Fjalimi historik i Ramiz

Cernicës në Kuvendin e Kosovës në Prizren, do të mbetet si një nga thesaret më të rralla, për të cilin nuk dihen shkaqet dhe arsyet, pse nuk është publikuar më parë!

DËSHIRA E POPULLIT PËR BASHKIM ME SHQIPËRINË, ËSHTË SHPREHUR E SHKRUAR EDHE NË REZOLUTËN E KONFERENCËS SË BUJANIT

“... Sot jemi mbledhur ne të deleguarit e popullit të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit për të shprehur vullnetin dhe dëshirën e popullit (shqiptar) të kësaj Krahine!

Unë jam i deleguar i popullatës së rrethit të Gjilanit! Këtu sot do të vendoset për fatin e Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit!

Siç dëgjova nga referati i paraqitur pak më parë, Partia paska vendosur që Krahinën tonë t’ia bashkojë Serbisë pa e pyetur fare popullin e saj!

Unë shpreh mospajtimin tim



me këtë synim!

Populli i Krahinës sonë është kundër bashkimit me Serbinë! Ai është për bashkim me Shqipërinë!

Kjo dëshirë e popullit për bashkim me Shqipërinë është shprehur e shkruar edhe në Rezolutën e Konferencës së Bujanit!

partizane dhe pushteti i ri i vendosur do të jetë i drejtë!

Mirëpo, nuk na doli ashtu!

Partizanët të përzier me çetnikë dhe drejtuesit e këtij pushteti të quajtur popullor, brenda shtatë muajve treguan fytyrën e vet!


Ju na vratë, na pretë, na masakruat, na burgosët e na gjykuat vend e pa vend e pa pikë faji, sepse gjatë okupacionit, shqiptarët nuk janë sjellë keq ndaj serbëve dhe nuk u kanë bërë zullum!

Pra, unë nuk po shoh ndonjë dallim ndërmjet këtij pushteti popullor dhe atij jopopullor të paraluftës!

Të gjitha të këqijat na i keni bërë, vetëm se hala nuk keni filluar të na shpërngulni për në Turqi si Jugosllavia e kajlave”!

RAMIZ CERNICA,
Prizren, 8 Korrik 1945!

(Fjalimi nuk ishte publikuar më parë, por është ruajtur nga rrëfimi ekskluziv i Deputetit të Kombit Ramiz Cernicës, të cilin e ka mbajtur në shënim, djali i vëllaut të Tij, veprimtari e atdhetari i madh, ish i burgosuri politik nipi i tij Kadri Halimi!



Për ne Serbia është njerjë, kurse Shqipëria është Nënë! Kush kujdeset më fort për evladin e vet - nëna apo njerka?

U muar vesh se nëna kujdeset me gjithë zemër e pa hile, kurse njerka gjithherë i bën hile e padrejtësi!

Pra, unë jam për t’iu bashkuar Kosova Shqipërisë, sepse me këtë po shpreh dëshirën e popullit!

Gjatë luftës në këtë drejtim e kuptim i kemi folur edhe popullit tonë! Domethënë, fjalët i kemi pasur ndryshe, e sot na doli krejt e kundërta! Nuk dua që brezat e rinj të më mallkojnë përjetë!

Prandaj po them, me Serbinë - JO!, me Shqipërinë - PO! Kam shpresuar se ushtria

Para se të publikohej për herë të parë në portalin e gazetës Epoka e Re, tekstin e fjalimit e kam marrë nga libri monografik “Për një atdhe të lirë e të bashkuar”, kushtuar veprimtarit të çështjes kombëtare, mish-te burgosurit politik Nazmi Hoxha, shkruar nga Agim Sylejmani, faqe 36-37, libër ky i promovuar më 26 Nëntor 2021)!

Prishtinë, 28 Dhjetor 2023!

NJË LIBËR DHURATË PËR KRISHTLINDJE



SELMA LAGERLÖF

Jemi ulur në tryezën e madhe në mbrëmjen e Krishtlindjeve në Mårbacka. Babai në njërin skaj të dhomës, nëna në tjetrin. Xhaxhai Wachenfeldt është aty. Ai ka zënë kryevendin në të djathtë të babit, pastaj tezja Lovisa, Danieli, Anna, Gerda dhe unë. Gerda dhe unë jemi ulur, si gjithmonë, përballë mamit, sepse ne jemi më të vegjlit. Unë mund t'i shoh të gjithë. Ne kemi ngrënë tashmë peshk, qull orizi dhe pasta me gjalpë. Pjatat, lugët, thikat dhe pirunët i kemi larguar, por mbulesa e tavolinës ka mbetur, dy qirinj të bërë nga ne digjen në shandanët e tyre në mes të tryezës dhe rreth tyre qëndrojnë ende kriporja, tasi i sheqerit, mbajtësja e tryezës dhe një kupë e madhe argjendi, e mbushur me birrë. Meqenëse vakti ka mbaruar, ne do të duhej të ngrihemi. Por, jo. Qëndrojmë ulur duke pritur shpërndarjen e dhuratave të Krishtlindjeve. Nuk ka asnjë vend tjetër në këtë zonë ku shpërndahen dhuratat e Krishtlindjeve në tryezën e mbrëmjes pasi ta kesh ngrënë qullin e Krishtlindjes. Por është një zakon i vjetër në Mårbacka, që na pëlqen. Nuk ka asgjë të keqe të qëndrosh dhe të presësh orë pas ore në prag të natës së gjatë të Krishtlindjeve dhe të dish se më e mira ende nuk ka ardhur. Koha kalon ngadalë, shumë ngadalë, por ne jemi të bindur se fëmijët e tjerë, të cilët morën dhuratat e tyre të Krish-tlindjeve në orën shtatë ose tetë, nuk kanë ndierë aspak këtë kënaqësi sa ne tani, kur më në fund ka ardhur çasti aq i pritur. Sytë ndriçojnë, faqet janë të skuqura zjarr, duart dridhen, kur hapet dera nga ato dy vajzat, të cilat janë veshur si cjep të Krish-tlindjeve dhe tërheqin disa shporta të mëdha, të mbushura me pako dhuratash për Krishtlindje, dhe i lëshojnë aty ku është nëna. Pastaj nëna merr paketë pas pakete pa u nxituar shumë. Ajo lexon emrat e marrësve, duke shqiptuar ngadalë emrat me rimat e Krishtlindjeve të shkruara në mënyrë të paqartë dhe shpër-ndan dhuratat e Krishtlindjeve. Ne jemi pothuajse të heshtur në çastet e para derisa grisim

mbështjellësit dhe letrën. Por së shpejti njëri pas tjetrit lëshojnë brohoritje të gëzuara. Pastaj flasim, qeshim dhe hulumtojmë shkrimet e dorës dhe krahasojmë dhuratat tona dhe gëzimi ynë ngjitet deri në tavan. Natën e Krishtlindjeve për të cilën tani po mendoj, unë sapo kam mbushur dhjetë vjeç. Jam ulur në tryezën e Krishtlindjeve me pritjen më të padurueshme të mundur. Unë e di shumë mirë se çfarë dua. Nuk janë fustanet e bukura, veshjet ose dantellat, karficat, patinat ose qeset me konfekte, por është diçka krejt tjetër. Dashtë Zoti që dikush të ketë pasur idenë për një dhuratë të tillë. Dhurata e parë e Krishtlindjeve që e heq nga kapaku është një kuti qepëse dhe menjëherë e kuptoj se kjo është nga nëna ime. Ka shumë xhepa të vegjël në të, dhe në to ajo ka vënë letra gjilpërash dhe fije leshi, një kukull prej mëndafshi të zi, dyllë dhe penj. Mami ndoshta dëshiron të më kujtojë se duhet të për-piqem të jem pak më e mirë në qepje dhe të mos mendoj vetëm në lexim. Nga Ana pastaj marr një jastëk të shkëlqyeshëm, të bukur e të vogël, të qëndisur me gjilpërë, i cili përshtatet në një ndarje në kutinë e qepjes. Halla Lovisa më dhuron një unazë të argjendtë, kurse Gerda më ka qëndisur një leckë të vogël, katrore, në mënyrë që tani të mund t'i qëndis vetë çorapet dhe faculetat. Aline dhe Ema Laurell kanë shkuar në shtëpi në Karlstad, por kanë menduar për mua dhe për të gjithë ne për dhurata për Krishtlindje. Nga Aline marr një palë gërshtë qepjeje në një këllëf, që i ka lidhur një me një karavidheje dhe një copë mëndafshi. Ema më dhuron një iriq të vogël prej leshi të kuq, i cili është plot me gjilpëra në vend të gjembave. Këto të gjitha janë gjëra shumë të bukura që m'i kanë dhuruar, por kam filluar të shqetësohem pak. Kam marrë kaq shumë gjëra për qepje. Imagjino sikur të mos marr atë që dua! Shikoni, do t'ju them, se ka një rregull në Mårbacka, që kur të shkosh në shtatë në prag të Krishtlindjeve, duhet të vendosësh një tryezë pranë shtratit dhe të vendosësh një qiri aty, dhe atëherë ke të drejtë të qëndrosh dhe të lexosh për aq kohë sa dëshironi. Dhe kjo është më e mira nga të gjitha kënaqësitë e Krishtlindjeve. Asgjë nuk mund të krahasohet me një libër të ri argëtues si dhuratë e Krishtlindjeve, një libër që nuk e ke parë kurrë më parë dhe që askush tjetër në shtëpi nuk e njeh, dhe kur e di se mund të lexosh secilën faqe,

për aq sa mund të qëndrosh zgjuar. Por çfarë duhet të bësh natën e Krishtlindjeve nëse nuk ke marrë dhuratë ndonjë libër për Krishtlindje? Kjo është ajo për të cilën mendoj tani, ndërsa hap, njërën pas tjetrës, pakot me pajisje qepëse. Veshët më nxehen gjithnjë e më shumë. Është padyshim një komplot i vërtetë. Imagjino sikur të mos marr një libër dhuratë për Krishtlindje! Danieli më jep një dorezë të butë me grep, nga Johani marr një hell për lëmshe të vegjël fijesh. Më në fund babai vjen me një dhuratë të madhe, një hark qëndisjeje, të cilin e ka porositur nga marangozi i shkëlqyer në Askersby. Është identik me një të tillë, me të cilin kishin qepur motrat e tij në rininë e tyre, thotë ai. - Ti me siguri do të bëhesh një rrobaqepëse e madhe, ti që ke marrë kaq shumë dhurata të bukura për qepje, thotë nëna. Të tjerët qeshin me të madhe. Me siguri vihet re se unë nuk jam aq e kënaqur me dhuratat e Krishtlindjeve, e ata, mbase, men-dojnë se më kanë bërë një tallje vërtet të mirë. Ndarjes së dhuratave ka filluar t'i vijë fundi, dhe unë tashmë kam marrë të gjitha dhuratat për të cilat mund të shpresoja. Nuk kam asgjë më shumë për të pritur. Halla Lovisa ka marrë një roman dhe dy kalendarë, Svea dhe Nornani dhe unë do t' i kemi librat prej tyre më vonë, por së pari do t'i lexojë vetë tezja. Po, sigurisht që nuk është një gjë e lehtë të dukesh e lumtur dhe të kesh një fytyrë të qeshur. Kur nëna heq paketën e fundit nga shporta e dhuratave të Krishtlindjeve, unë shoh nga forma që është një libër. Por sigurisht që nuk është për mua. Me siguri kanë rënë dakord që unë të mos marr ndonjë libër. Por pakoja

me të vërtetë më adresohet mua, dhe kur e marr në duar, ndiej menjëherë se është libër. Skuqem nga gëzimi dhe me të vërtetë bërtas në padurimin tim për t'i marr gërshtë dhe për t'i prerë penjtë. I shqej letrën me vrull dhe para meje shfaqet libri më i bukur, një libër përrallash. Këtë mund ta kuptoj nga fotografitë në kapakë. Ndiej që të gjithë në tryezë më shikojnë. Sigurisht ata e dinë që kjo është dhurata ime më e mirë e Krishtlindjeve, e vetmja që vërtet më bën të lumtur. - Çfarë libri ke marrë? - thotë Danieli, duke u përkulur mbi mua. Atëherë unë e hap faqen e parë, ulem dhe shikoj titullin. S'kuptoj asnjë fjalë. - Ta shoh! - thotë ai dhe lexon: "Nouveaux contes de fées pour les petits enfants par Mme la comtesse de Ségur". Ai e mbyll librin dhe ma jep përsëri. - Është një libër me përralla në frëngjisht, - thotë ai. Tani ke diçka për t'u argëtuar. Unë kam studiuar frëngjisht një semestër për Aline Laurell, por tani kur marr dhe e shfletoj librin, nuk kuptoj asnjë fjalë. Të marrësh dhuratë një libër në frëngjisht është thujse më keq sesa të mos marrësh fare libër. Është mjaft e vështirë ta për-mbash të qarën. Por, për fat të mirë, brenda në një faqe të librit shoh një ilustrim. Është princesha e vogël, më e adhureshmja, hipur në një karrocë, të cilën e tërheqin dy strucë dhe në shpi-nën e njerit prej strucëve kalëron një djalosh fisnik me një kapelë të palosur dhe një xhakëtë të qëndisur. Vetë princesha mban mëngë të gjera të fryra dhe një jakë të fryrë në qafë. Strucat kanë kapela me pendë të larta në kokë dhe rripat e pëlhurës me zin-xhirë të gjerë prej ari.

Nuk mund të shihje gjë tjetër më argë-tuese. Ndërsa shfletoj më tutje, gjej një mori portretesh të prin-ceshave krenare, të mbretërve madhështorë, të kalorësve fisnikë, të zanave të lavdishme, magjistarëve të neveritshëm, kështjellave të mrekullueshme përrallore. Nuk është një libër për të cilin duhet qarë, ndonëse është në frëngjisht. Gjatë gjithë natës së Krishtlindjeve qëndroj zgjuar dhe shikoj fotografitë, veçan të parën, atë me strucat. Ajo ofron argëtim të mjaftueshëm për shumë orë. Në ditën e Krishtlindjeve, meqë kemi qenë në meshën e Krishtlindjeve, unë marr një fjalor të vogël të frëngjishtes dhe filloj të lexoj frëngjisht. Është vështirë. Unë kam mësuar vetëm metodën e Grönlundit. Nëse në këto përralla do të flitej për "kapelën e vogël të njeriut të madh" ose "ombrellën e gjelbër të marangozit të mirë", atëherë do ta kuptoja, por si mund ta kuptoj një tekst koherent francez? Libri i përrallave fillon kështu: Il y avait un roi. Çfarë do të thotë kjo? Me siguri më mori një orë kohë derisa arrita të kuptoj se kjo fjalë duhet të përkthehet kështu: "Na ishte një mbret". Por ilustrimet janë tërheqëse. Më duhet të kuptoj se çfarë për-faqësojnë ato. Mundohem të hamendësoj, kërkoj në fjalor, dhe merrem me secilën fjali, njërën pas tjetrës. Dhe në fund të pushimeve të Krishtlindjeve, nga libri im i vogël e i bukur unë kam mësuar më shumë frëngjisht sesa do të kisha mësuar për disa vjet sipas metodës së Aline Laurellit dhe Grönlundit.

Përzgjedhi dhe përktheu nga origjinali: Qerim RAQI



SHUMËDIMENSIONALITETI IDEOESTETIK I NJË ROMANI

Enver Visoka, “Nata e përjetshme”, Sh. B. “Koliqi”, Prishtinë, 2022



SADIK KRASNIQI

Ka krijues që nuk shquhen në inkuadrimin e vazhdës së skotës zhurmuese, me paraqitje kudo dhe kurdo, duke menaxhuar e reklamuar “artin” e tyre “të denjë” për çmime dhe dekorata letrare. I tillë është shkrimtari dhe poeti Enver Visoka, që krijon dhe jeton, siç do të thoshte Gynter Grasi, në “vetminë e bekuar”.

Në tre romanet e tij, *Muri i hekurt*, *Dimensioni i panjohur* (botuar edhe në gjermanisht me titull *Die unbekannte Dimension*) dhe *Nata e përjetshme* vërehet një përshtesim ideoestetik gjithnjë e në ngritje. Ndërsa në romanin e parë paraqitet në mënyrë reale realiteti i një kohe të një vendi konkret, në romanin e dytë vjen në shprehje trajtimi i një teme dhe vendi ekzotik, përmes një fantazie dhe imagjinatë të befasueshme, kurse romanin që po trajtojmë e shquan një përthyerje e realitetit në një fiksjon të përkajshëm onirik.

Romani *Nata e përjetshme* është roman i detajeve. Sekuencimi i ngjarjeve, i fenomeneve, personazheve, situatave, diskursivitetit, magjisë, filozofisë, mistikës, evokativës, profecisë të epokalipsit zotërohet përmes një dinamike shumë të shpejtë, por me një koherencë në shërbim të semantikës dhe semiotikës poetike. Romani fillon me tri sentenca si paratekste autoriale, të cilat janë mjaft implicite dhe shkojnë në funksion ideor, ashtu siç janë shënjuar edhe tri kaptinat e librit: *Për urinë dhe etjen; Për artin, pusin e turbullt të ekzistencës, zanafillën, kohën e ikur dhe të pikur, Pika e tërheqjes së gjurmëve të njeriut në planet*, që shprehin jo si ndarje kompozicionale të strukturës së romanit, por janë interferenca ideosugjестive për eklektiken e ligjërimit fabular, apo siç shprehet autori: “*i konstalacionit të çuditshëm ndjenjash, në orën policore të të menduarit*”. Vetë titulli i veprës *Nata e përjetshme* sinjifikon një nokturno.

Nata e përjetshme, pos të tjerash, është roman personazhi, gjegjësisht kryepersonazhi. E gjithë fabula e veprës ndërthehet përmes kryepersonazhit Prole (emër ky me konotacion, i zhveshur nga çdo kamje), duke u

nyjësuar me gjendjen e tij intelektual e emocionale për rrethanat ku ai gjendet e që janë tejet komplekse e të ndërlikuara. Prole është një “i huaj”, që ka të bëjë me një realitet, të cilin e determinojnë të tjerët. Ky realitet ka të përditshmen monotone, të vrazhdë, të varfër, të mërziqshme, banale dhe të gërditshme.

Në këto rrethana Prole është i detyruar ta ushtrojë zanatin “*e punës për bukë*”, siç shoshte Kafka, për ta ushqyer familjen, duke i shërbyer zonjës Haike, e cila është e robëruar nga tekat, dëshirat, manitë e shfrenuara e obsesive për pushtetin e ndyrë. Raportin e tij me realitetin Prole e ndërton përmes mllëfit të shprehur mes dialogut ironik me njerëzit në njërin anë, dhe bisedës së singertë me Mailon, qenin e shtëpisë.

Biseda me Mailon është një solilokuim, pra një dialog me një kafshë që s’kupton e që në thelb është monolog. E potencuam këtë element, ngaqë Mailo është shoqëruar i përhershëm i personazhit gjatë tërë romanit dhe duke qenë pjesë interiere e ambientit, lexuesin e vë në lajthitje ta mendojë si mace. Por llojin e tij autori e zbulon me të lehurën e tij të vetme dhe pak para se ai të japë frymën e fundit. Realja në këtë roman, si veprim i kryepersonazhit, është shumë e paktë në krahasin me arealen, që është jermi, vegimi, shajnia dhe ëndrra e tij. Fabula përmes Onirikes si dominante e romanit, është një subjekt i gjetur bukur përmes fisit të stërllashtë Go. Fisi Go është përtej realitetit e jashtë kohe, në orbitën ku Prole transformohet përmes gjendjes së tij në trans. Fisin Go e shquan misticizmi i ritualeve, besëtytnive, kulteve, magjisë së bardhë dhe supersticiozitetit. Ky fis është njëherazi zanafilla e organizimit të shoqërisë në një ambient rural ende të virgjër e të paprekur nga interesi personal, ideologjik e teknik. Në këtë ambient fisnor, Prole gjendet si një alien, por i metamorfozuar në njeriun ujk dhe me dhëmb ujku si shenjë e keqe fatale për atë ambient.

Fati i tij përcaktohet nga gjyshja e fisit, e cila e vërteton se ky nuk ishte vrasësi, vetëm se trupi i tij ishte i zënë nga fryma e keqe e ujkneriut dhe, ai shpirt i trazuar duhej larguar, nxjerrë jashtë nga trupi përmes magjisë së bardhë dhe, krejt kjo duhej të ndodhë në majat e larta të bardhësive; në kohën dhe vendin e caktuar. Pasi shërohet nën këshillat e plakës së fisit dhe përmes dashurisë së vajzës më të bukur të fisit, Prole fiton simpatinë dhe besimin e fisnarëve, saqë bëhet orientues dhe misionar i tyre. Përmes vizionit dhe diturisë së këtij njeri të ardhur

nga një dimension tjetër, fillon një jetë e re e tyre drejt organizimit shoqëror. Përmes arsimimit dhe këshillave të tij, të mbartura nga një botë tjetër, nis transformimi shoqëror i fisit dhe kalimi nga komuniteti primitiv deri në popull, e më vonë në shtet. Por mu në këtë stad të transformimit shoqëror deri te forma e shtetit, për shkak të interesave egoistë dhe etjes për pushtet, prijësi i tyre Drilo kthehet në despot dhe prish minishtetin e tij në një mënyrë donkishoteske, duke u mbrojtur me uniformat e ushtarëve të braktisur, të cilat i mbush me kashtë e byk.

Drilo, i mllëfësuar nga braktisja e të gjithëve, uniformave me kashtë u vë flakadanët për ta ndritur natën dhe pallatin, po që digjet së bashku me ta. Në këtë roman hasim fenomenin e ëndrrës në ëndërr, por edhe të ëndrrave paralele. Sublimacioni për art, po ashtu, është fabularitet i jermë dhe i ëndërrt. Me Poezinë, Lirikën e Fantazinë, kryepersonazhi nuk ka vetëm raporte estetike, por edhe raporte familjare, ndaj Prole është një Pikmaleon që dashurohet me to, jeton me to dhe fundi i vjen në krahët e tyre. Subjekti i tërë këtij kompleksitetit fabular në këtë roman zhvillohet përmes personazheve disa llojesh: ato reale si, Prole, Haike, Sasha, Uve, Zhaklina, Berta, Maria grua, (kjo edhe si personazh vegimtar), Gerta, Maile, Roku etj. Personazhet onirike: gjyshja e fisit, Drilo, Eposi, vajza e bukur, kryeplaku, ushtarët prej kashte të Drilos etj. Personazhet diskursive, si Poezia, Lirika, Fantazia, vargu, si dhe personazhet hipotetike: Zëri i dytë, Zëri i tretë, Zëri frymës, Zëri i panjohur, Zëri i largët, Zëri i pafytyrë, Zëri i errësirës etj. Tema e romanit ndërtohet përmes një ligjërimi të një poetike të ndërlikuar dhe tejet komplekse. Pluraliteti i tekstit të këtij romani të jep pluralizmin e interpretimit, siç do të thoshte Agron Y. Gashi. Ky pluralizëm interpretues vjen nga amza e diskursit ligjërues të romanit, i cili përmban disa fenomene të veçanta letrare, të cilat e bëjnë këtë roman të qëndrojë nën ombrellën e postmodernes. Prole duke qenë njeri hënak, i ikur nga koha e fikur, i kapur nga hija e mallkuar e ujkneriut, i bindet urdhrit të Zërit të dytë: “*Dëgjo këtu, mësohu të jetosh me ëndrrat, i shkoqur nga hallkat e trupit të dheut e të shpirtit, se në fund të fundit, nga të gjitha ndërskamcat që t’i ngritin, mbetet e dëlirë dhe e lirë vetëm ëndrra, e cila është, po ashtu, një jetë*” (f. 41).

Diegjetika në roman përmban interspektivën e personazhit, e

cila zhvillohet përmes monologut të shpeshtë. Ky monolog shtjellohet si retrospektiv dhe perspektivë. Retrospektiva është evokative, ndërsa perspektiva është profeci. Figura e metonimisë bëhet bartëse e rrëfimit evokativ. Përmes *Librit të fluturimeve* (Flugbuch), që është ditar lufte i babait të Haikes, i cili si pilot kishte bërë *fluturime të zeza, në kohën e zezë me frymë dhe energji të zezë*. Përmes kësaj *mortaje të zezë*, Prole përkujton Luftën e Dytë Botërore. Ndërsa me *tokën e djegur* kujton vendlindjen e tij dhe luftën e fundit. Prole fëmijërinë e përkujton përmes *bukës së nxehtë* të mbrumë dhe dorës së nënës që ia afron. Kujtimet te ky personazh janë si aurë që ndizen dhe fiken me një shpejtësi vetëtime, duke u përthyer nga realiteti shqetësues.

Në oazën e kujtimeve shfaqet zërin autorial, që jep elementet autobiografike. Profecia në këtë libër është përtej orveliane, është apokalips biblik. Nuk është më vetëm sistemi ideologjik me syrin e vëllait të madh që kanos qenien njerëzore, por është *Dija e rafinuar*, e cila “*përfundimisht vrau pastërtinë qiellore, vrau gjithçka e, në fund, edhe gazin dhe ajrin që dikur, sipas saj, do të kishin krijuar oksigjenin e, më vonë, edhe jetën dhe vdekjen në planet...*” (f. 244). Andaj zëri i panjohur e tall ironikisht personazhin dhe njeriun: “*Ti nuk do të vdesësh në mungesë të plotë të oksigjenit, por do të vdesësh në mungesë të ushqimit të shëndoshë. More vesh, do të ishte fat i madh që ti të mos kesh asnjë metalik me ato stemat e kryeqyteteve europiane që ta blesh vdekjen tënde*” (f. 244). Romani ka edhe profecinë kozmike me shenjat e apokalipsit biblik, me shiun e hekurt dhe njollat e zeza brenda sipërfaqes së zjarrit të diellit, devijimi i Tokës jashtë rrethit të vet, kështu thonë zërat e astrofizikëve e, sipas Proles, kjo do të ndodhë në ditën e pestë të stinës së pestë të vitit të fundit, mu në momentin fatal “*të pikës së tërheqjes së gjurmëve të gishtërinjve të njeriut në planet*” (f. 243). Këto elemente e çojnë këtë vepër në zhanrin e fantaromanit. Romanin e shquan edhe ligjërimi ironik. Narrativja e ironisë në këtë roman është alegorike. Ironia bëhet përmes dialogut të kryepersonazhit me Haiken. Qëndrimi autorial vërehet edhe ndaj proceseve shoqërore, me ironinë alegorike të luftës së derrave mes tyre dhe derrave me ujçit, si aludim i dy sistemeve të dy kryefuqive botërore: asaj perëndimore dhe lindore. Konsistenca e romanit

është metamorfoza, e cila është përtej kafkiane, si metamorfozimi i sendeve në gjallesa (*aeroplani në peshkaqen*), i qenieve njerëzore në kafshë (njeriut *në ujkneri* ose në lejlek të verdhë. Në roman ka edhe metamorfoza mistike sipas kodeve të ritualit Shaman të transformimit të shpirtit sipas shenjave astrologjike. Vetë romani përfundon me metamorfozimin e kryepersonazhit. Prole vjen duke u zvogëluar, bëhet edhe një herë fëmijë.

Metamorfozimi vazhdon në një oazë të zezë prej lëkure qengji, e në fund shndërrohet në zanafillën e ngjizjes së tij (në një pikë sperme), që bartet nga merimanga gjigante e kohës për në gjithësi, pak para se të mbyllet qielli dhe të bie nata e përjetshme. Sabato shprehet: “*Proza është e ditës, poezia është nata: ushqehet me përbindësja e simbole, është gjuha e territ dhe e humnerave*”. E romani i Enver Visokës është si poezia e natës dhe i krijuar nga zonat e errëta, ndaj për të mund të ketë edhe qasje psikanalitike. “*Po nuk ka roman të madh, që të mos jetë në instancë të fundit poezi*”, - thotë prapë Sabato. I tillë është edhe ky roman me metaforat e bukura, si: *dy thëngjij të shuar prushi, engjëll i zi, lule të zeza, energji e errët, energji e zezë, zëri i frymës, aurora e frymës së djegur, çaste të djegura kohe, kohë e djegur, frymëmarrje e bardhë qielli, etja e kohës, kohë e fikur, mal i shkretë, aurorë të mallkimeve, kohë e pikur, shi në sirtarët e qiellit, mortajë e zezë, frymë e zezë, shi i zi, shi i hekurt, libër i zi, shpirt i mjerë, jetë të fikura, kohë e mykur, lëmsh i portokalltë zjarri, kala akulli, univers i thyer, shpirt i heshtur, shtrati galaktik i yjeve të heshtura, pyjet e yjeve, tokë e etur, tokë e djegur, strale të dritave, zogu i shpirtit, pema e shpirtit, lule kamilje, rrugë e yjeve, Zoti i yjeve, këmishë e zezë, kod mallkimi, merimangë kohe* etj.

Gjatë leximit dhe perceptimit të vëmendshëm mund të konkludojmë se romani *Nata e përjetshme* i Enver Visokës është shkruar për një lexues model dhe se, nëse ky recipient depërton në esencën e semiotikës së tij, dëshmon “*shejin e mendjes së pjekur*” (Arshi Pipa), siç ka dëshmuar edhe autori si krijues. Në fund mund të themi se ajo pikë zanafille e bartur diku në gjithësi do të jetë një ngjisje e një qenieje të re apo e një romani të ri. Për ne, si lexues, kjo do të mbetet një suspansë.

Të shpresojmë!

VAJTJA NË DASMË

(tregim satirik)



ILIAZ BOBAJ

- E morët vesh, besoj, Vladimiri me Anitën u ndanë. Dhe e mbanin veten si një çift i përsosur. Po ja që edhe tullumbacia e tyre plasi, - u dha lajmin e fundit Arta shoqeve të saj, ende pa u përshëndetur mirë.

- Po, po, e morëm vesh, - ndërhyri Marjeta. - Gjithsesi unë fajtores bëj Anitën. Ia kishte lëshuar shumë frerët të shoqit. Besonte tek ai verbërisht. Dhe ai, pasi ia piu lëngun, e braktisi dhe mori një më të re. Një grua e zonja di se si ta bëjë zap burrin e saj. Atë grua që beson te besnikëria e përjetshme e burrit, e pret ndarja e sigurt. Liria e burrit, është prangosja e femrës.

Pasi thanë mendimin e tyre edhe nja dy-tri gra të tjera për ndarjen që po trondiste qytetin, ato e panë të arsyeshme ta zgjeronin pakëz hapësirën e bisedës së tyre, duke rrëfyer për zotësinë femërore për t'ua mbledhur burrave dhe mënyrën se si e shfaqnin ato pushtetin e tyre perandorak te burrat, ndaj të cilëve qëndronin pa u lëshuar asnjë grimë nga dinjiteti i tyre femëror, e mori fjalën Klara.

- Burri është i vrullshëm si deti, gruaja është stoike si bregu. Ai përplas pasionet dhe dufin e tij në breg. Herë-herë e ledhaton atë butë-butë, herë-herë i këngëzon ëmbël sikur i këndon ndonjë këngë dashurie, herë-herë egërsohet dhe përplasat me egërsi mbi të, por gruaja duhet të dijë se si t'i përballojë këto përplasje dhe pasione. Vetëm ajo që është zonjë e vërtetë di se si t'i qëndrojë këtij tundimi. E keqja është se nuk janë të pakta ato gra të cilat ua japin vetë çelësin burrave për ta hapur kështjellën e dinjitetit të tyre femëror. Gra u thëncin...!

Tundi kokën, duke nënkuptuar se këto lloj grash nuk i falte kurrën e kurrës dhe vijoi:

- Edhe pse për gratë kanë ardhur kohë shumë të vështira dhe kjo më së shumti për faj të vet grave, duhet ta dini se unë nuk i kam lëshuar kurrë pe burrit tim në këtë pikë. Dhe nuk kam për t'i lëshuar për jetë të jetës! - e përforcoi zërin, duke e ngritur disa semitonë më lart dhe duke e shoqëruar me gishtin e saj tregues, të cilin, pasi e lëvizi horizontalisht, e ndaloi në një pikë, si për t'u thënë mikeshave të saj, se kufiri i burrit ishte deri aty ku fillonin kufijtë e dinjitetit femëror dhe se ai nuk kalonte dot asnjë grimë tej pikës që i kishte vënë atij Klara.

- Për këtë shkak jam ndarë tri herë, - shtoi ajo. - por çdo burri që kam pasur, i kam treguar vendin. Nuk binte më poshtë as Violeta,

e cila tha se burrin e kishte futur në shishe dhe e nxirrte prej andej vetëm kur ia hiqte tapën ajo.

- Burri është si puna e drejt, - tha Violeta. - Një burrë që bledh i lirë, pa e ndier pushtetin e gruas së vet, mund të bëjë gjithçka, si ai marinari që zbret në një port të huaj, pas një lundrimi prej disa muajsh në det të hapur. Një burrë me liri të pakufizuar, është si një rojtar pylli, i cili mendon se e ka të gjithë pyllin të vetin.

Merita, e cila në bisedat e saj shquhej për referime ndaj fakteve historike, pasi u mendua një copë herë, si shkencëtari para se të flasë para një auditori të përzgjedhur, shtoi:

- Duket sikur historinë e kanë bërë burrat por, në fakt, roli i grave ka qenë faktor vendimtar në ngjarjet e mëdha historike, duke qenë udhëheqëse të burrave. Semiramida e Egjiptit të lashtë dhe Kleopatra e Romës mbetën në histori se ditën të zinin vendin e tyre në kohën e vet.

Po kështu edhe Helena e Trojës, e shoqja e Odiseut, me zotësinë e saj vuri në luftë dy shtete dhe nuk u tërhoq derisa e bëri Trojën shkumb e hi...

Ato luajtën një rol primar në histori, ashtu siç luajti edhe Nora e Kelmendit në luftë kundër romakëve...

Siç e dini, kam qenë vetëm një muaj e martuar, po atë muaj burrit ia kam shtrënguar rripat ashtu siç ia shtrëngon i zoti samarit të mushkës, që ajo të mos ketë nga t'ia mbajë.

Blerta me Artën panë njëra-tjetrën në sy, ulën kokën dhe mezi e mbajtën të qeshurën me referimet historike të Meritës, por u kujdesën që ajo të mos i shikonte. Ah, shejtankat! Kështu vepronin përherë kur Merita u referohej fakteve të historisë...

Marikës mezi i pritej.

- Këtyre u duket sikur diçka kanë thënë, po kur të dëgjojnë atë që i kam punuar unë tim shoqi, nuk do t'u besojnë veshëve, - tha me vete.

Më në fund bisedat pothuajse u shuan. Me sa dukej, burrat e kishin marrë përgjigjen e merituar në këtë pikë. Dhe mirë t'u bëhej. Gratë kishin folur me fakte dhe me argumente bindëse dhe burrat nuk kishin nga ta luanin bishtin...

Por, jo, jo...

Deri tani ata vetëm sa ishin squllur pakëz nga vesa. Stuhia që do t'i bënte të mos i lante as lumë e as përrua, po vinte më pas...

Ishte radha e Marikës.

U rehatua në ndenjësën ku ishte ulur, kroi pakëz zërin dhe filloi:

- Unë po ju rrëfej një ndodhi me tim shoq.

...Po afrohej dasma e kushërirës sime të parë, Arditës, të cilën e dua shumë dhe e kam si motër. Por, ndërsa unë shkoj në çdo rast te njerëzit e tij, im shoq nuk para i ka

shumë qejf njerëzit e mi dhe u largohet atyre në çdo rast. Kjo ka koston e vet. Kostoja e parë dhe kryesorja, është se ul dinjitetin dhe prestigjin tim para njerëzve të mi.

- Për dy javë kemi dasmën e Arditës, - i thashë një mbrëmje. - Përgatitu të shkojmë ashtu siç na ka hije. Të blejmë edhe ndonjë rrobë të re.

- Unë nuk vij, - ma ktheu ftohtë, sikur të fliste me ndonjë njeri të panjohur në rrugë.

E vështrova me inat, por nuk i thashë asgjë.

Kisha vendosur që do t'i jepja fund njëherë e mirë kësaj gjendjeje, duke i dhënë tim shoqi një mësim të mirë, të tillë që të mos ia kishte dhënë asnjë grua burrit të saj, domethënë një mësim shembullor. U mendova mirë e mirë dhe, pasi u konsultova edhe me shoqen time të ngushtë, Adrianën, sajova planin tim, të cilin do të çoja deri në fund, sido që të ndodhte.

Po të pyes për herë të fundit, - i thashë një ditë. - Do të vish në dasmë, apo jo?

- Jo, jo, ta thashë një herë! - ma preu me thikë Rolandi dhe u nis për në punë.

- Mirë, - ia ktheva unë. - Do ta shohim...

Të shtunën, një ditë para dasmës së kushërirës sime, Rolandi doli së bashku me shokët e tij për të pirë kafën e mëngjesit, siç bënte zakonisht çdo fundjavë.

Unë pata përgatitur gjithçka me kohë dhe nuk më mbetej tjetër veçse ta zbatoja planin tim. Kisha bashkërenduar gjithçka edhe me shoqen time të ngushtë, Adrianën, e cila më këshilloi se cilin ilaç duhej të pija që të më dëmtonte sa më pak dhe si duhej të veproja menjëherë pas pirjes së tij. Ah, kur më thotë kjo koka ime për të arritur diçka, nuk ka burrë nëne që të më dalë përpara e jo më një copë Rolandi si burri im!

Ah, kjo puna e dinjitetit, moj motra! Është si puna e tërheqjes së litarit. Sikush e tërheq për veten e vet, po varet se cili e tërheq atë përfundimisht. Punë drejt, vërtet! Se ai që humbet, tërhiqet zvarrë pas këtij drejt litarit...

Shkurt hesapi, sapo e piva ilačin, i dërgova një mesazh tim biri, në të cilin i shkruaja: "Biri im i dashur! Kur të mbërrijë te ti ky mesazh, unë nuk do të jem më në këtë botë. Po helmoj veten për shkak të tët ati, i cili ma ka bërë jetën skëterrë. Nuk dua të më vijë as në varrim. Qofshi të lumtur, biri im i shtrenjtë! Jetën time e sakrifikoj për ju, që të jetoni të lumtur dhe jo si unë, në skëterrën që më krijoi yt atë. Lamtumirë, biri im!"

Në shtëpi kisha lënë edhe një shënim: "Shkaku i vdekjes sime është im shoq. Ma ka bërë jetën

skëterrë dhe nuk duroj dot më. Po e kthej me fund kupën e helmit".

Po përsëritej tragjedia e Sokratit...

- Im bir, - vijoi Marika, - dha alarmin. E mori vesh i madh e i vogël. Madje filluan edhe hamendjet. Njëra nga fqinjët e mia tha se Rolandi kishte marrëdhënie me një shoqen time, kurse një tjetër se unë e kisha kapur me presh në duar dhe pasi nuk e kisha duruar dot tradhtinë e tij, kisha dashur t'i jepja fund jetës. Një e tretë shkoi akoma më tej me fantazinë e saj. Ajo tha se Rolandi kishte një fëmijë me një grua tjetër dhe kur e mora vesh unë, nuk durova më, po plasa si qelqi me verë. "E mjera Marikë!" - tha ajo.

"Ah, sa fatkeqe qenkesh kjo vajzë!" - tha një kushërira imja kur e dëgjoji ngjarjen. "Ajo është një engjëll, që jeton me një përbindësh..."

Pavarësisht gjeografisë së thashethemeve, u kënaqa fort që fajin ia hidhnin të gjithë tim shoqi. I kisha sjellë aq bukur punët dhe ia kisha mbyllur aq mirë shtigjet tim shoqi, sa nuk i mbetej veçse të digjej në zjarrin që i kisha ndezur, të cilin e ushqeja me shkarpat e thata të këmbënguljes sime. Ah, Roland, Roland! Me sa duket nuk më ke njohur mirë! Po do të të bëj si ata këlyshët e rrahur, që tërhiqen të trembur pas litarit.

Roland i gjend sa hap e mbyll sytë në spital. Veç ta shihnit, ishte zverdhur si një limon i shtrydhur dhe nuk i kishte mbetur më lëng në fytyrë. Dukej më shumë i vdekur sesa i gjallë. Mustaqet e zezë i ishin lëshuar si driza të shkelura me këmbë.

- Ta rregulloj unë atë burrërinë tënde! - thashë me vete, kur e pashë pa pikë gjaku në fytyrë.

E vështrova vëngër, perëndova sytë dhe u bëra gati sikur do të shkoja që atë çast në botën tjetër, duke luftuar me të gjitha fuqitë e mia kundër vdekjes, që mendohej të më rrëmbente nga çasti në çast. I hodha një vështrim të vagullt tim shoqi, si të doja t'i thosha se ai ishte shkaku i katandisjes sime në një gjendje të tillë të mjeruar, zgurdullova sytë dhe u ktheva në anën tjetër. Ndërkaq mbërriti ime bijë me një frymë. Merrte frymë me zor, si lepur kur e ndjek këmba-këmbës zagari.

- Baba, kjo që ke bërë është një krim ndaj sate shoqeje dhe nënës sonë, - iu drejtua të atit me një ton të rreptë. - Nuk do të ta fal kurrën e kurrës!

Kurse im bir i ktheu kurrizin të atit.

Në të vërtetë unë e kisha nxjerrë helmin dhe e ndieja veten më mirë, pasi isha nën kujdesin e mjekëve. Por, ndërsa lufta me veten po zbutej, ajo me tim shoq, Rolandin, sapo kishte filluar dhe nuk kisha ndër mend t'i lëshoja asnjë grimë pa e shpurë lojën time deri në fund.

Vërtet, unë po përlesheshja fyt më fyt me vdekjen, por Rolandi

ishte në gjendje më të vështirë se unë, ai ishte edhe fajtori i tragjedisë sonë familjare, edhe i padëshirueshmi i familjes. Por jo vetëm i familjes...

As të afërmit e mi, të cilët mbërritën njëri pas tjetrit në intervale të shkurtra kohe, nuk ia varën fare Rolandit, duke e lënë mënjane, si një njeri të braktisur.

Nuk kish kënaqësi më të madhe për mua në ato caste...Gati-gati e harrova helmimin dhe fillova të buzëqeshja me ironi.

Në pasdite u bëra mirë dhe gjendja ime po përmirësohej nga çasti në çast. Shoqen time të ngushtë, Adrianën, e kisha pranë dhe më ndihmonte për gjithçka. Kur më pa që po përmirësohesha me shpejtësi, më shkeli syrin:

- S'ta ha qeni shkopin ty, jo! Je drejt vetë... Hajde, tani, ngrehu të shkojmë në shtëpi!

- Jo, jo, do të rri këtu sonte! Nesër në mëngjes do të dal.

Të nesërmen në mëngjes dola dhe shkova në shtëpi. Burri rrinte si pulë e lagur dhe mendohej të më shërbente me gjithçka. Bëja sikur nuk më interesonte asgjë nga shërbimi i tij. Aty nga dreka u ulëm në tryezë. Pa thënë asnjë fjalë, si në një drekë të përmortshme.

Hëngrem fare pak. Kur mbetëm vetëm, i hodha një vështrim kuptimplotë dhe e pyeta me gjysmë zëri:

- Në mbrëmje unë do të shkoj në dasmën e Arditës. Do të vish?

- U përtyp sikur t'i kishin mbetur disa gjysma fjalësh nëpër laring, të cilat mezi i mblodhi:

- Po, po.

Sytë i mbante përherë të ulur.

E mora si një këlysh të rrahur pas litarit dhe shkova në dasmë.

Në dasmë më pritën si heroinë. Kushërira ime që martohej, Ardita, fluturoi nga gëzimi.

- Oh shpirti im, që sakrifikove gjithçka, vetëm e vetëm që të vish në dasmën time! Nuk do të ta harroj sa të jetë jeta! - shpërtheu Ardita sapo më pa te dera dhe lotët i rrodhën çurg. Edhe të tjerët u mallëngjyen shumë.


Vetëm ime motër, Mira, më tërhoqi mënjane dhe më tha në vesh: "Mjaft më me këtë komedi, se u bëtë gazi i botës!"

Nuk ia vara fare. Mua nuk më interesonte bota. Më interesonte vetëm im shoq, të cilin jo vetëm që e bëra pulë, por i hapa edhe probleme me policinë për shkakun e helmimit tim. Ja, kështu bëhet zap burri, mike të dashura...

Shoqet e vështronin me sy të shqyer. Qenë hutuar aq shumë nga përvoja e saj, sa dukeshin sikur nuk merrnin as frymë.

(Marrë nga numri 20 i revistës "Akademia")

ROMANI EPISTOLAR



DAVID LODGE

Atë që nuk mund ta përballoj është se për një çast ajo njohu pretendimet e mia, pranoi të drejtat e mia. Gjë që më bën ta godas tavolinën me grusht...

Telefoni. Po cingëron. Prit. Asgjë. Avari studentësh. Gjëja që më bën t'i ulërij hënës është mendimi se ajo është duke shkarravitur atje në Londër sikur të mos ketë ndodhur asgjë. Thjesht dëshiroj ta di nëse e ka ngritur kokën për një çast nga bota e saj imagjinare dhe thotë...

Në fakt, sapo m'u kujtua diçka tjetër. Ajo mund të mos jetë duke shkarravitur sikur s'ka ndodhur asgjë. Mbase shkruan ca versione të ngjarjes në dhomën e mysafirëve. Ku ndonjëra nga heroinat e saj të mençura, të çuditshme, lëviz pazakonshëm kur sheh mbathjet e purpurta të ndonjë akademiku të ri arrogant. S'më duhet tash ai vështrimi yt, faleminderit - avash ia kam dalë të kuptoj ironinë. Ndonëse është ndryshe - ajo nuk po i shkruan privatisht një mikut ndonjë vend të largët. Ajo po u shkruan miqve të mi. Armiqve të mi. Kolegëve të mi. Studentëve të mi...

Çfarë? A janë mbathjet e mia të purpurta? Sigurisht që nuk janë të purpurta! A s'di asgjë për shijen time? Por ajo mund ta thotë se ato janë të purpurta! Kështu bëjnë këta njerëz. Zbukurojnë, përmirësojnë të vërtetën - gënjejnë.

MICHAEL FRAYN, *Mashtrimi* (1989)

ROMANET E SHKRUARA në formë të letrave ishin jashtë-zakonisht të popullarizuar në shekullin e tetëmbëdhjetë. Romanet epistolare të gjata, moralizuese, psikologjike dhe tunduese të Samuel

Richardsonit, *Pamela* (1741) dhe *Clarissa* (1747), ishin pikë referimi në historinë e fiksionit evropian, duke frymëzuar shumë imitues si Rousseau (Helioza e re) dhe Lacloin (*Lidhje të rrezikshme*). Drafti i parë i Jane Austenit për veprën *Ndjenjë dhe ndjeshmëri* ishte në formë të letrave, por parashikimi i saj për rënien e romanit epistolar në shekullin e nëntëmbëdhjetë vërtet qe profetik. Në epokën e telefonit romani epistolar shkruhej rrallë, megjithatë, siç dëshmoi kohën e fundit vepra *Mashtrimi* e Michael Fraynit, ai nuk u zhduk krejtësisht dhe ia vlen të ruhet.

Shpikja e makinës së faksit provokoi ringjalljen e kësaj forme (titulli i storjes së Andrew Davies, *Fakset e pista*, 1990, qe shenjë paralajmëruese) por, përgjithësisht, romancieri modern epistolar detyrohet t'i largojë korrespondentët në një distancë të konsiderueshme që konvenca të duket e besueshme. Heroi i Fraynit, apo antiheroi, është akademik britanik tridhjetëvjeçar, i paemër, i specializuar në veprat e një romanciereje bashkëkohore pak më të vjetër, së cilës në tekst i referohet me inicialet JL. Ai e fton të ligjërojnë në universitet dhe, për habinë e tij, ajo e fton në shtratin e dhomës së mysafirëve. Këtë ngjarje dhe vazhdimin e saj, ai e përshkruan në një seri letrash drejtuar mikut të tij, po ashtu akademik, me bazë në Australi.

Ai gjendet midis pasionit dhe dyshimit. Nga njëra anë lavdërohet për marrëdhënien intime me gruan, studimit të veprave të së cilës ia kushtoi karrierën profesionale; nga ana tjetër frikësohet se ajo do ta shfrytëzojë këtë marrëdhënie për ta kthyer në fiksion, duke e

botuar dhe keqinterpretuar. Ai e admiron aftësinë e saj letrare, e ka edhe zili dhe në mënyrë paradoksale e ka zët. Shqetësohet se, pavarësisht prej zotërimit të trupit të saj (pas një kohe martohet me të), në të njëjtën kohë, ai nuk e kontrollon imagjinatën e saj fiktive. Përfundon duke u përpjekur, më kot, ta blejë "mashttrimin" (d.m.th. shkruarjen e fik-sioneve). Kjo është temë e njohur satirike - dallimi midis aftësisë kritike dhe krijuese - e dhënë në mënyrë të re dhe argëtuese me anë të rrëfimit mjesh tëror.

Romani epistolar është lloj rrëfimi në vetën e parë, por ka disa tipare të posaçme që nuk gjenden në format e zakonshme autobiografike. Përderisa storja autobiografike është e njohur për narratorin para se të nisë, letrat janë proces i vazhdueshëm ose, siç thotë Richardsoni, "Shumë më i gjallë dhe më prekës... është stili i atyre që shkruajnë në kulmin e një shqetësimi aktual, ku mendja torturohet nga brejtja e pasigurisë... sesa stili i thatë dhe i ftohtë i rrëfimit të një personi që ka kapërcyer vështirësitë dhe rrezikun..."

Sigurisht, i njëjti efekt arrihet duke përdorur formën e ditarit, por romani epistolar ka dy përparësi shtesë. Së pari ai mund të ketë më shumë se një korrespondent dhe, kështu, e njëjta ngjarje tregohet nga këndvështrime të ndryshme, me interpretime krejt të ndryshme, siç e provoi shkëlqyeshëm Richardsoni te *Clarissa*. (P.sh., Clarissa i shkruan shoqes së saj Miss Howeit rreth një bisede me Lovelacein, ku ai vërtet dukej se po hiqte dorë nga e kaluara shthurëse; Lovelacei, të njëjtën

bisedë, ia tregon mikut të tij Belfordit si skenë intrige dinake për ta joshur vajzën.) Së dyti, edhe nëse kufizoheni siç bën Frayni, vetëm në një shkrimtar, në një letër, ndryshe nga ditari, ajo gjithmonë i drejtohet një adresuesi specifik, përgjigja anticipuese e të cilit kushtëzon diskursin dhe retorikisht e bën më kompleks, më interesant dhe më zbulues.


Frayni e shfrytëzoi këtë formë të fundit për një efekt shumë të mirë. Akademiku i tij është personazh i krisur, komik, plot sqimë, ankth dhe paranojë, që vazhdimisht i tradhton, duke anticipuar ose imagjinuar reagimet e mikut austrian ("S'më duhet tash ai vështrimi yt, faleminderit..."). Ndonjëherë letrat lexohen si monologë dramatikë, ku ne dëgjojmë vetëm njërin anë të dialogut dhe nxjerrim përfundime: "Çfarë? A janë mbathjet e mia të purpurta? Sigurisht që nuk janë të purpurta! A nuk di asgjë për shijen time?" Këtu, stili i afrohet skazit, imitimit të rrëfimit gojor që e trajtuam në kapitullin e mëparshëm; por ai përshtatet vetëdijshëm edhe me shkrimin letrar, si: "Ku ndonjëra nga heroinat e saj të mençura, të çuditshme, lëviz pazakonshëm kur sheh mbathjet e purpurta të ndonjë akademiku të ri arrogant". Nëse kjo fjali duket si hije e mbishkruar, e rënduar me shumë mbiemra dhe ndajfolje, ky është qëllimi i Fraynit. Narratori duhet ta përçojë gjallërisht komedinë e hallit të tij, por nuk i lejohet elokuenca e vërtetë, sepse kjo do të qe në kundërshtim me paaftësinë e zotërimit të "mashttrimit".

Ta them të drejtën, të shkruarit mund ta imitojë besnikërisht vetëm të shkruarit.

Paraqitja e të folurit dhe, për më tepër, e ngjarjeve joverbale, është shumë artificiale. Por, letra fiksonale nuk dallon nga letra e vërtetë. Referimi ndaj rrethanave ku shkruhet romani, në vetë tekstin, normalisht do ta tërhiqte vëmendjen për ekzistencën e autorit "real" prapa tekstit dhe kështu ta thyente iluzionin fikcional të realitetit, por në romanin epistolar ai i kontribuon iluzionit. Për shembull, unë nuk i fus telefonatat e agentit tim në tekstin e romanit që jam duke e shkruar, por thirrja e studentit që e ndërpret, në mes të fjalisë, akademikun e Fraynit, është sa realiste, aq edhe demaskim i karakterit (ai është kaq i vetobsesionuar saqë shpërfill përgjegjësitë zyrtare).

Realizmi pseudo-dokumentar i metodës epistolare u dha romancierëve të mëhershëm fuqi të paparë mbi audiencën e tyre, të krahasueshme me magjinë e ushtruar në audiencën televizive moderne nga telenovelat. Derisa u botua, vëllim pas vëllimi, *Clarissa* voluminoze, Richardsonit shpesh i luteshin lexuesit të mos lejonte vdekjen e heroinës. Madje lexuesit e parë të *Pamelës* supozuan se korrespondenca ishte e vërtetë, ku Richardsoni ishte thjesht redaktor. Natyrisht, lexuesit modernë të letërsisë artistike s'do ta merrnin kështu, por këtu kemi një mashttrim të pastër të Fraynit, i cili bëri që akademiku të ankohet për mënyrën sesi romancierët e kthejnë faktin në fiksion ("Kështu bëjnë këta njerëz. Zbukurojnë, përmirësojnë të vërtetën - gënjejnë.") në një lloj romani të projektuar ta bëjë fikcionin të duket si fakt.

TI DHE BOMBA ATOMIKE



GEORGE ORWELL

Duke marrë parasysh sa ka gjasa që ne të gjithë të bëhemi copë e çikë prej saj brenda pesë vjetëve të ardhshme, bomba atomike nuk ka ngjallur aq shumë diskutime sa mund të pritej. Gazetat kanë botuar diagrame të shumta, jo shumë të dobishme për njeriun mesatar, të protoneve dhe neutroneve prej të cilave përbëhen, dhe ka pasur shumë përsëritje të deklaratës së pado-bishme se bomba “duhet të vihet nën kontrollin ndërkombëtar”. Por çuditërisht pak është thënë, gjithsesi në shtyp, për pyetjen që është me interes më urgjent për të gjithë ne, pikë-risht: “Sa të vështira janë këto gjëra për t’u prodhuar?”

Informacione të tilla që ne - domethënë publiku i gjerë - zotë-rojmë për këtë temë, na kanë ardhur në një mënyrë mjaft të tërthortë, në kundërshtim me vendimin e presidentit Truman për të mos ia dorëzuar disa sekrete BRSS-së. Disa muaj më parë, kur bomba ishte ende vetëm një thashetheme, besohej shumë se ndarja e atomit ishte thjesht një problem për fizikanët dhe se kur ata ta kishin zgjidhur, një armë e re dhe shkatërruese do të ishte në dispozicion të pothuajse të gjithëve. (Në çdo çast, kështu vijuan thashethemet, një i çmendur i vetmuar në një laborator mund ta bëjë qytetërimin pluhur e hi, aq lehtë sa ndezja e një fishekzjarri.)

Nëse kjo do të ishte e vërtetë, i gjithë drejtimi i historisë do të ishte ndryshuar papritmas.

Dallimi midis shteteve të mëdha dhe shteteve të vogla do të ishte fshirë dhe fuqia e shtetit mbi individin do të ishte dobësuar shumë. Megjithatë, nga fjalimet e presidentit Truman dhe komen-tet e ndryshme që janë bërë për to, duket se bomba është jashtë-zakonisht e shtrenjtë dhe se prodhimi i saj kërkon një përpjekje të madhe industriale, siç janë në gjendje të bëjnë vetëm tre ose katër vende në botë. Kjo pikë

është e një rëndësie thel-bësore, sepse mund të nënkuptojë se zbulimi i bombës atomike, aq larg nga ndryshimi i historisë, thjesht do të forcojë prirjet që kanë qenë të dukshme gjatë një duzine vitesh më parë.

Është e gjë e zakonshme të thuhet që historia e qyte-tërimit është kryesisht histori e armëve. Në mënyrë të veçantë është vënë në dukje vazhdimisht lidhja midis zbulimit të barutit dhe përmbykses së feudalizmit nga borgezia. Dhe megjithëse s’kam dyshim se mund të bëhen përjashtime, mendoj se rregulli i mëposhtëm do të ishte përgjithësisht i vërtetë: se epokat në të cilat arma mbizotëruese është e shtrenjtë ose e vështirë për t’u prodhuar do të prirën të jenë epokat e despotizmit, ndërsa kur arma dominuese të jetë e lirë dhe e thjeshtë, njerëzit e thjeshtë e kanë një shans. Kështu, për shembull, tanket, luftanijet dhe aeroplanët bombardues janë në thelb armë tiranike, ndërsa pushkët, mushqetat, harqet e gjata dhe granatat e dorës janë në thelb armë demokratike. Një armë e ndërlikuar e bën të fortin më të fortë, ndërsa një armë e thjeshtë - përderisa nuk ka një më të mirë - i jep kthetrat të dobët. Epoka e madhe e demo-kracisë dhe e vetëvendosjes kombëtare ishte epoka e mushqetës dhe e pushkës. Pas shpikjes së strallit dhe para shpikjes së kap-sollës, mushqeta ishte një armë mjaft e efektshme dhe në të njëjtën kohë aq e thjeshtë sa mund të prodhohej thuajse kudo. Kombinimi i cilësive të saj bëri të mundur suksesin e revolu-cioneve amerikane dhe franceze dhe e bëri një kryengritje popullore një çështje më serioze sesa mund të ishte në kohën tonë. Pas mushketës erdhi pushka me fole fisheku. Ajo ishte një gjë deri diku e ndërlikuar, por ende mund të prodhohej në shumë vende, dhe ishte e lirë, kalohej lehtësisht kontrabandë dhe harxhonte pak municion. Edhe kombi më i

prapambetur mund të rrokte pushkët nga një burim ose një tjetër, në mënyrë që boerët, bullgarët, abisininët, marokenët - madje edhe tibe-tianët - të mund të luftonin për pavarësinë e tyre, nganjëherë me sukses.

Por më pas çdo zhvillim në teknikën ushtarake ka favorizuar shtetin kundër individit dhe vendin e industrializuar kundër atij të prapambetur. Ka gjithnjë e më pak vatra pushteti. Në vitin 1939 kishte vetëm pesë shtete të afta për të bërë luftë në shkallë të gjerë, dhe tani janë vetëm tri - në fund të fundit, ndoshta, vetëm dy. Kjo prirje ka qenë e dukshme prej vitesh dhe është vënë në dukje nga disa vëzhgues edhe para vitit 1914. E vetmja gjë që mund ta përmbyse këtë realitet është zbulimi i një arme - ose, për ta thënë më thjesht, i një metode luftimi - që nuk varet nga përqendrimet të mëdha të fabrikave industriale.

Nga shenja të ndryshme mund të arrihet në përfundimin se rusët nuk e zotërojnë ende sekretin e prodhimit të bombës ato-mike; nga ana tjetër, ka një pajtim të përgjithshëm të opinionit publik se do ta zotërojnë brenda pak vitesh. Pra, kemi para nesh perspektivën e dy ose tre super-shteteve përbindësh, secili i zotëruar me nga një armë me të cilën miliona njerëz mund të zhduken brenda pak sekondash, duke e ndarë botën mes tyre. Është nxituar të hamendësohet se kjo nënkupton luftëra më të mëdha dhe më të përgjakshme dhe, ndoshta, një fund të qytetë-rimit të makinerive.

Por supozoni - dhe me të vërtetë ky zhvillimi më i mundshmi - që kombet e mëdha të mbijetuara bëjnë një marrëveshje të heshtur për të mos përdorur kurrë bombën atomike kundër njëri-tjetrit? Supozoni se e përdorin, ose kërcënimin për ta përdorur, vetëm kundër njerëzve që nuk janë në gjendje të hak-merren? Në atë rast ne jemi kthyer aty ku ishim më parë, i

vetmi ndryshim është se pushteti është i përqendruar në duar akoma më të pakta dhe se perspektiva për popujt e nënshtruar dhe klasat e shtypura është akoma më e pashpresë.

Kur Xhejms Bërnëm shkroi Revolucionin menaxhues, shumë ame-rikanëve iu duk e mundshme që gjermanët do ta fitonin fundin evropian të luftës, dhe për këtë arsye ishte e natyrshme të supo-zohej se Gjermania dhe jo Rusia do të dominonin masën e tokës euroaziatike, ndërsa Japonia do të mbetej zotëruese e Azisë Lin-dore. Ishte llogaritje e gabuar, por nuk ndikon në argumentin kryesor. Sepse fotografia gjeografike e Bërnëmit për botën e re ka rezultuar e saktë. Gjithnjë e më qartë sipërfaqja e tokës po ndahet në tri perandori të mëdha, secila e pavarur dhe e shkëputur nga kontakti me botën e jashtme, dhe secila e sunduar, nën një mas-kim apo një tjetër, nga një oligarki e vetëzgjedhur. Pazarit se ku do të përcaktohen kufijtë vazhdon ende dhe do të vazhdojë për disa vjet, dhe i treti nga tre super-shtetet - Azia Lindore, e dominuar nga Kina - është ende potencial më shumë sesa realitet. Por lëvizja e përgjithshme është e pagabueshme dhe çdo zbulim shkencor i viteve të fundit e ka përshpejtuar.

Një herë na thanë se aeroplani kishte “hequr kufijtë”; në fakt, vetëm pasi avioni u bë armë serioze, kufijtë janë bërë përfundi-misht të pakalueshëm. Dikur pritej që radioja ta promovonte mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar; ka rezultuar të jetë një mjet për të izoluar një komb nga një tjetër. Bomba atomike mund ta përfundojë procesin duke grabitur klasat e shfrytëzuara dhe popujt e të gjitha fuqive për t’u revoltuar dhe, në të njëjtën kohë, t’i vërë zotëruesit e bombës mbi bazën e barazisë ushtarake. Në pamundësi për ta pushtuar njëri-tjetrin, ka të

ngjarë të vazh-dojnë ta sundojnë botën mes tyre dhe është e vështirë të shihet se si mund të prishet ekuilibri përveç ndryshimeve të ngadalta dhe të paparashikueshme demografike.

Para dyzet a pesëdhjetë vjetësh, H. G. Uellsit dhe të tjerë na paralajmëruan se njeriu rrezikon ta shkatërrojë veten me armët e tij, duke lënë pas milingonat ose disa lloje të tjera që të mbijetojnë e të na zënë vendin. Kushdo që ka parë qytetet e rrënuara të Gjermanisë do ta çoj ndër mend edhe këtë nocion. Megjithatë, duke parë botën në tërësi, zhvendosja për shumë dekada nuk ka qenë drejt anarkisë, por drejt rivendosjes së skllavërisë. Mund të shkojmë jo drejt shkatërrimit të përgjithshëm, por drejt një epoqe kaq tmerrësisht të qëndrueshme sa perandoritë e skllëvërore të antikitetit. Teoria e Xhejms Bërnëmit është diskutuar shumë, por pak njerëz i kanë marrë parasysh nënkuptimet e saj ideologjike - domethënë llojin e botëkuptimit, llojin e besimeve dhe strukturën shoqërore që, ndoshta, do të mbizotëronte në një shtet që ishte njëkohësisht i pamposhtur dhe në një gjendje të përhershme “luftë të ftohtë” me fqinjët.

Nëse bomba atomike do të ishte diçka aq e lirë dhe që pro-dhohet lehtësisht si një biçikletë apo një orë me zile, mund të na kishte zhytur përsëri në barbarizëm por, nga ana tjetër, mund të kishte nënkuptuar fundin e sovranitetit kombëtar dhe të shtetit policor shumë të centralizuar. Nëse, siç duket, është një objekt i rrallë dhe i kushtueshëm aq i vështirë për t’u pro-dhuar sa një luftanije, ka më shumë gjasa t’u jepet fund luftë-rave në shkallë të gjerë me koston e zgjatjes së pafundme të një “paqeje që nuk është paqe”.

Tribune, 19 tetor 1945

Përktheu nga origjinali (anglishtja): Granit ZELA

GUIDË PËR DHURATAT E FUNDVITIT



Aksesorë, bizhuteri, parfume, veshje, dhurata të personalizuar dhe djemtë do të bëjnë gjithmonë të njëjtën pyetje: Çfarë dhurate do të dëshiroje këtë fundvit? E në fakt, me faj nuk mund t'i bëjmë, sepse ndër vite me kaq shumë festa e okazione idetë shterojnë. Megjithatë nëse do të binim dakord për diçka do të ishte që një përvojë, një eksperiencë vlen shumë më shumë se një dhuratë. E me këtë të fundit nënkuptojmë një udhëtim në çift, një përvojë që do t'ju dhurojë kujtimet më të bukura. Ndaj këtë vit, nëse ende ju mundon pyetja "çfarë dhurate duhet t'i bëjë asaj" apo "atij" keni klikuar artikullin e duhur, vendin ku do të gjeni dhuratën më të bukur.

Një fundjavë në Portonovi, përgjatë periudhës më të bukur të vitit, do të ishte dhurata që do ju falte emocionet më të bukura. Jo shumë larg Tiranës, në resortin që u shndërruar në destinacionin e preferuar të sa e sa shqiptarëve, magjia e festave ka trokitur herët këtë muaj. Dritat, ngjyrat, bredhi, shtëpizat e drurit, të gjitha të krijojnë idenë e fshtatit ku Babagjyshi përgatit dhuratat me ndihmën e elfëve të tij, në Polin e Veriut, por në fakt e gjithë kjo skenë ndodh buzë detit. Kjo ndërthurje e klimës së butë, aromës së detit me atmosferën magjepsëse festive, do t'ju përshfaqë përpara syve një tablo si asnjëherë më parë. Por le të listojmë vetëm disa nga arsyet se disa ditë pushimi në

Portonovi do të ishin dhurata më e bukur që mund të bënit ose të merrnit këtë vit.

Eventet e organizuara

Festat në Portonovi janë të jashtëzakonshme. Çdokush, i madh e i vogël do të mrekullohej nga hapësirat e ndriçuara, skena dhe këndet nga ku mund të shkrepni foton ideale për Instagram. Nga eventet për çdo moshë deri te festimet e jashtëzakonshme, çdo moment do të jetë i paharrueshëm. Çdo shesh në resort e jo vetëm duket se rezervon një surprizë për ju dhe sharmi i këtij fshati që gëlon nga gjallëria në çdo periudhë të vitit do t'ju marrë zemrën. Koncertet me këngëtarë, grupe dhe DJ të njohur do të jehojnë në të gjithë Portonovi për 16 ditë me radhë prej 23 dhjetorit, deri më 7 janar.



Tregu i Krishtlindjes

Sheshi Marina do të shndërrohet në arenën e festimeve, me këndet për foto, tregun e Krishtlindjeve, ku do të shërbehen ushqimet dhe pijet e ngrohta e jo vetëm. I

konceptuar për fëmijë e të rritur, shtëpizat e drunjt, mirëpresin artizanët vendas, nga ku mund të blini suveniret më të bukura por jo vetëm.

'One & Only Poronovi' hoteli kryevepër me famë botërore ju fton të bëheni pjesë e një përvoje unike si asnjëherë më parë falë trajtimeve të personalizuar dhe të mirëmenduara për çdo klient. Duke bërë bashkë mjekësinë e lashtë kineze me teknologjinë më të fundit perëndimore, ekspertët e metodës Chenot praktikojnë prej më shumë se 50 vitesh një qasje unike ndaj mirëqenies, me programet jetëndryshuese të detoksifikimit dhe trajtimeve revolucionare të kujdesit të lëkurës. Ekipi beson se çdo udhëtim shëndetësor është individual dhe si i tillë, çdo program është i përshtatur

për nevojat tuaja të veçanta. Bëjini vetes një dhuratë ta paçmuar, duke përmbushur mendjen, trupin dhe shpirtin, vetëm në Portonovi.

Këto ishin vetëm disa nga arsyet që përse Portonovi duhet të jetë destinacioni i festave tuaja këtë fundvit, por shumë më shumë surpriza, darka Gala, e organizime të një standardi shumë të lartë ju presin.

Nëse dëshironi ta prekni vetë magjinë e këtij vendi me disa ditë të mbushura me argëtim apo romancë në çift, në Portonovi ju do të keni akses në restorantet elegante dhe në SPA-në e hotelit 'One & Only Poronovi', duke ju garantuar një përvojë të paharrueshme. Pavarësisht nëse jeni duke kërkuar disa ditë të mbushura me argëtim apo romancë në çift, Portonovi do t'ju garantojë një përvojë të paharrueshme. E sigurisht, për t'ju bërë këto festa edhe më të ëmbla nuk mund të mungonin ofertat. Përfitoni sa jeni në kohë nga uljet speciale për një arratisje dimërore që do të bëhet një nga kujtimet tuaja më të bukura. Oferta përfshin jo vetëm akomodimin në suitat luksoze, me mëngjes e parkim të përfshirë, por dhe një masazh relaksues 30 minuta për person. Kjo ofertë speciale "Winter Escape" fillon me vetëm 192 euro për natë dhe është e disponueshme deri në fund të muajit janar.

10 rite që duhen bërë natën e Vitit të Ri për një 2024 me super fat



Nata e Vitit të Ri është festa më supersticioze që ekziston. Ne lëmë pas vitin e vjetër dhe e shikojmë të ardhmen me pozitivitet, duke shpresuar gjithmonë për më të mirën. Kjo ndjenjë përkthehet në rite fati të mirë dhe gjepte, që synojnë tërheqjen e fatit të mirë. Në Itali nuk mund të mungojë darka me bazë sallam derri dhe thjerrëza, e shoqëruar me koncerte, valle dhe lojëra me letra. Por si e kalon natën e Vitit të Ri pjesa tjetër të botës? Zbuloni traditat dhe ritet të fatit.

Brazili

Në natën e Vitit të Ri, vendi i Amerikës së Jugut feston me tre lloje menush në varësi të faktit nëse vendet janë afër detit, apo në zonat më të brendshme. Djemtë priren të vishen me të verdha, në nderim të diellit, jetës dhe arit, një simbol i bollëkut. Është zakon që kryefamiljari të hedhë një gotë verë mbi supe, për të shmangur fatin e keq, ndërsa të rinjtë e qyteteve bregdetare nuk heqin dorë nga noti i mesnatës.

Belgjika

Të pastrosh trupin pas qejfeve të Krishtlindjeve për t'u përgatitur për vitin e ri. Kështu festohet Viti i Ri në Belgjikë, me një supë të këndshme me qepë që mbyll darkën dhe festimet në dritën e parë të agimit. Është një ogur i mirë të vendosni një monedhë ose disa gjethe lakre nën pjata.



Kinë

Këtu nata e Vitit të Ri nuk festohet më 31 dhjetor, si në kalendarin gregorian, por në një ditë që ndjek kalendarin hënor, i cili mund të ndryshojë nga 21 janari deri më 19 shkurt. Festimet zgjasin dy javë dhe përfundojnë me festën e fenerëve.



Gjatë festimeve njerëzit vishen me të kuqe, një ngjyrë e cila, sipas traditës, do të frikësonte Nianin, përbindëshin mitologjik që sipas legendës dilte nga strofulla e tij çdo 12 muaj për të gllabëruar qeniet njerëzore, atë të përfaqësuar nga maska e luanit që parakalon nëpër qytet.

Gjermania

Gjatë Vitit të Ri gjerman, njerëzit vishen, pinë verë të kuqe dhe



hanë arra. Më tradicionalistët pinë Feuerzangenboeie, një pije vëllazërore e bërë me verë, kanellë dhe rum. Në fund të mbrëmjes, në tryezë lihet një pjatë e mbushur me ushqime, për të pritur vitin e ri me mbarësi dhe bollëk.

Japonia

Në Tokën e Diellit që lind, natën e Vitit të Ri përfitohet për të bërë një pastrim të madh të shtëpisë, i cili zgjat tre ditë, deri më 3 janar. Gjatë kësaj periudhe festohet duke falënderuar perënditë për të korrat dhe duke mirëpritur shpirtat e të parëve duke dekoruar shtëpinë me degë pishe, bambu dhe kashtë. Në mesnate kambanat e tempujve budistë bien 108 herë për të



rrëfyer të gjitha mëkatet e njerëzve.

Greqia

Nëse festoni në shtëpi, çdo mysafir, sapo të hyjë në derën e përparme, duhet të hapë një shëgë: sa më shumë fara të



derdhen në dysheme, aq më i mirë do të jetë fati i tij gjatë vitit. Në tryezë shërbehet ëmbëlsira e Shën Vasilit, brenda së cilës është fshehur një monedhë. Ai me fat që e gjen do të ketë një vit të pasur dhe të begatë.

Anglia

Gjatë natës së Vitit të Ri është zakon të hahet gjeldeti i mbushur me gështenja dhe puding, pak si në Krishtlindje. Mbrëmja vijon

Rusia

Këtu nata e Vitit të Ri festohet edhe dy herë. Më 31 dhjetor, sipas kalendarit gregorian dhe më 13 janar sipas kalendarit Julian (i quajtur edhe Viti i Ri i Vjetër). Më 31 dhjetor presim mesnate për të kërcyer dhe për të ngrënë një ëmbëlsirë tipike dhe të mbarë, kumbulla të thata të mbushura me lajthi dhe të mbuluara me salcë kosi. Më pas, në zilen e dymbëdhjetë të kambanave, dera e përparme hapet për të pritur me gëzim vitin e ri.

Spanja

Spanjollët presin mesnatën duke ngrënë buñuelos, petë sfoliatë të mbuluara me sheqer. Në tingujt e parë të vitit të ri është zakon të hidhen dymbëdhjetë rrush, një për çdo muaj, për të tërhequr fat dhe bollëk. Edhe këtu, njerëzit përpiqen të veshin diçka të kuqe. Për më tepër, është një ogur i mirë të vendosni një unazë në gotën e bukës së parë, e cila do t'i sjellë fat atij që e mban.

Tajlandë

Viti i Ri Thai festohet nga 13 deri më 15 prill, që përkon me fillimin e vitit budist. Është një nga festalet më të shumëpritur të vitit dhe më i ndjekur nga turistët. Tradita thotë se ofertat i bëhen tempullit duke lagur imazhet e Budës me spërkatje uji dhe duke pastruar tërësisht shtëpitë. Kjo rezulton me një luftë uji të hedhur mbi kalimtarët, e cila sipas traditës do të largonte fatin e keq. Për ta bërë këtë, përdoret gjithçka, nga legenët tek bastunët e deri te elefantët.



XHUDOJA, KRENARIA SHTETËRORE

Xhudoja edhe në vitin 2023 ishte sporti kryesor dhe krenaria e Republikës së Kosovës. Garuesit, e drejtuar nga mjeshtri i madh Driton Kuka dhe kampionia olimpike Majlinda Kelmendi, ishin triumfues në shumicën e garave ndërkombëtare. Kapakun sukseseve xhudistët e Kosovës ia vunë në Kampionatin e Hapur Evropian të Xhudos “Open Prishtina 2023”, i cili u mbajt më 16 dhjetor në Prishtinë. Kosova bindshëm triumfoi edhe në këtë kampionat. Akil Gjakova fitoi medaljen e artë, kurse Distria Krasniqi, Nora Gjakova dhe Dardan Cena fituan medalje të bronzitë

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, DHJETOR, JANAR - Xhudoja e Kosovës e nisi mirë vitin 2023. Në garën e parë ndërkombëtare, Lorian Kuka (-78 kg) është stolitur me medalje të bronzitë në Grand Prix që është mbajtur në Almada të Portugalisë. Loriana për të bronzitën zuri në mbajtje për 20 sekonda dhe mposhti me Ippon garuesen nga Koreja Jugore, Jeongyun Lee. Menjëherë në garën pasuese më 5 shkurt në Grand Slam Paris 2023, Distria Krasniqi arriti të fitojë medaljen e artë. Distria për të artën mposhti me Wazaari hungarezen Reka Pupp. Gjashtë ditë më pas medalje Kosovës i solli edhe Flaka Loxha, e cila u stolis me medalje të argjendtë

xhudistët elitare u bënë pjesë e FSK-së falë nënshkrimit të memorandumit në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Xhudos së Kosovës. Më 4 maj xhudistët e rinj morën pjesë në Turneun Ndërkombëtar të Xhudos “Albania Open 2023” në Tiranë. Medaljet e arta i fituan Furkan Kelmendi, Shpat Zeka, Muhamedin Veseli, Florian Gerguri, Sara Osmani, Rrezarta Alimi, Art Thaqi, kurse medaljet e argjendta i fituan Dion Sharapolli, Donat Laka, Yll Maliqi, Bleona Gerxhaliu. Xhudistët e rinj i sollën Kosovës tri medalje në garën ndërkombëtare, Kuwait City Asian Open 2023. Medaljen e argjendtë e fitoi Shpat Zekaj (-100 kg), kurse dy



në Kupën Botërore në Sofje të Bullgarisë. Ndërsa më 17 shkurt, për 15-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, Laura Fazliu u stolis me medaljen e bronzitë në Grand Slam Tel Aviv. Edhe marsi ishte muaj me berqet për sportin e Kosovës, pasi Distria Krasniqi (-52 kg), Nora Gjakova (-57 kg) dhe Laura Fazliu (-63 kg) janë stolitur me medalje të argjendta në Grand Slam Tbilisi të Gjeorgjisë. Në fund të marsit

medalje të bronzta i sollën Fatjona Kasapi (-57 kg) dhe Debora Gjakova (-63 kg). Në muajin maj Dardan Cena është stolitur me medalje të artë në Kupën Evropiane për Juniorë në Kaunas. Cena në finale zuri në mbajtje dhe mposhti me Ippon polakun Adam Kazmierczak dhe u rendit i pari në këtë Kupë. Më 16 maj Distria Krasniqi u rendit e para në Ranglistën Botërore nga



Federata Ndërkombëtare e Xhudos, me 7 275 pikë. Xhudoja pati suksese edhe në qershor. Fillimisht Lorian Kuka (-70 kg) është stolitur me medalje të bronzitë në Grand Prix Dushanbe, Takhikistan. Për të bronzitën Kuka fitoi pa ndeshje, pasi që kundërshtarja e saj, britanikja Katie-Jemima Yeats-Brows, nuk u paraqit në tatami. Më 24 korrik kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri i MAPL-së, Elbert Krasniqi dhe zëvendësm ministrja e MKRS-së, Daulina Osmani, dhe zëvendësm ministri i MASHT-it, Taulant Kelmendi dhe deputetët Ardian Gola dhe Gramos Agusholli, vizituan Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë. Kryetari i Federatës së Xhudos të Kosovës, Agron Kuka, bashkë me xhudistët tanë, paraqiti arritjet e programit “Kosova, shtet i xhudos” dhe projektet e ardhshme

në kuadër të Federatës. Në muajin gusht vazhdoi shkëlqimi i Dardan Cenës që u stolis me medalje të bronzitë në Lojërat Frankofone që u mbajtën në Kinshasa, Republikën Demokratike të Kongos. Për medalje të bronzitë Cena mposhti me Ippon garuesin nga Senegali, Serigne Gaye. Ndërsa Shpati Zekaj (-100 kg) fiton medalje të artë në Lojërat Frankofone. Kosova rrëmbej dy medalje në Masters Budapest Hungary 2023. Laura Fazliu (-63 kg) fitoi medalje të artë, kurse Distria Krasniqi të argjendtën. Më 2 dhe 3 shtator 2023 u mbajt Kampionati Ballkanik i Xhudos për Seniorë dhe Ekipë, në sallën e sporteve “Karagaçi” në Pejë. Xhudistët tanë ishin të suksesshëm. Ata përfunduan në vendin e parë në garat individuale me plot tetë medalje të arta, si dhe fituan edhe vendin e parë në garat ekipore. Dy medalje Kosova i fitoi edhe në

Grand Slam Baku 2023, ku Nora Gjakova (-57 kg) e rrëmbeu të artën, ndërsa Distria Krasniqi (-52 kg) të argjendtën. Nora fitoi pesë ndeshje radhazi, që të gjitha me Ippon, kurse në finale mposhti gjeorgjianen Eteri Liparteliani. Ndërsa Distria fitoi tri ndeshje radhazi dhe humbi një, atë të finales, kundër japonezes Kisumi Omori. Më pas për Kosovën erdhi edhe një sukses nga Kampionati Ballkanik për Juniorë (U21) në Bihaç të Bosnjë-Hercegovinës. Në këtë kampionat Anes Veseli fitoi medaljen e artë, Muhamedin Veseli të argjendtën dhe Dëbora Gjakova të bronzitën. Ndërsa më pas Sidorela Dodaj (-48 kg) është stolitur me medalje të bronzitë në Kupën Evropiane për Kadetë (U18) në Berlin. Për të bronzitën ajo mposhti me Ippon holandezen Robin Hoekstra. Një tjetër sukses ishte edhe ai më 16 tetor në Kampionatin Ballkanik U23 në Stamboll. Rezultatet ishin Muhamedin Veseli (-60 kg) i artë, Dëbora Gjakova (-63 kg) e argjendtë, Loris Sharapolli (-73 kg) i bronzitë, Sara Osmani (-52 kg) e bronzitë, Rrezarta Alimi (-63 kg) e bronzitë. Ndërsa Blin Kuka është stolitur me medalje të argjendtë në Kupën Evropiane për Kadetë (U18) në Berlin. Më 30 tetor Akil Gjakova doli edhe një herë në skenë. Ai e fitoi medaljen e argjendtë (-73 kg) në Grand Slam Abu Dhabi në Emiratet e Bashkuara Arabe. Gjakova ishte në formë të shkëlqyeshme. Ai fitoi pesë ndeshje radhazi me Ippon, më pas u ndal në finale me një Wazaari nga





Erzen Zyberaj, i papushtueshëm në vitin 2023

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, DHJETOR, JANAR - Atleti kampion i Kosovës, Erzen Zyberaj, kishte pak pushim gjatë vitit 2023. Ai mori pjesë në shumë gara zyrtare dhe

jozyrtare. Pothuajse në secilën që mori pjesë doli fitimtar. Zyberaj për nder të festës së Flamurit Kombëtar dhe të gjithë atyre që u flijuan për liri, më 28 nëntor vrapoi nga kryeqyteti i Kosovës, Prishtina, për në kryeqytetin e

Shqipërisë, Tiranë, duke e përmbyllur me sukses vrapimin për ditën e Flamurit Kombëtar. Zyberaj me flamurin kombëtar dhe shtetëror i ka kaluar 260 kilometra duke shkëlqyer nëpër rrugët shqiptare me përkrahjen

e familjarëve të shumtë e miqve nga vende të ndryshme. Edhe pritja në sheshin e Tiranës nga shumë qytetarë nuk mungoi për Zyberajn, i cili është në kulmin e karrierës. Në garat zyrtare ku Zyberaj rrëmbeu vendin e parë ishin

“Pritshina Trails 2023” 47 km, “Sharri Vertical”, gara e parë e mbajtur në histori të Kosovës në këtë disiplinë. “Uludag Ultra Trail - Bursa” 100 km, “High Scardus Ultra - Prizren” 52 km dhe “Lybeten Sky Race - Maqedoni e Veriut” 23 km.



garuesi i Uzbekistanit, Shakhram Ahadov. Kosova fitoi katër medalje në Kampionatin Evropian për Seniorë në Montpellier të Francës më 2023. Distria Krasniqi fitoi medalje të argjendtë, duke u bërë edhe nënkampione evropiane. Nora Gjakova, Laura Fazliu dhe Akil Gjakova fituan medalje të bronzit. Në këtë Kampionat garuan 46 shtete, 388 garues, 218 meshkuj dhe 170 femra, derisa Kosova mori pjesë me gjashtë garues. Më 8 nëntor u certifikua grupi i parë i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Xhudo. Në kuadër të programit shtetëror “Kosova, shtet i xhudos”,

në Qendrën Nacionale të Xhudos në qytetin e Pejës është mbajtur ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së në xhudo. Në muajin nëntor, po ashtu, u mbajt Kampionati i Kosovës për grupmoshat U16, U18, U21, U23, ku morën pjesë mbi 100 garues. Ky kampionat u mbajt në Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë. Suksesi i radhës për xhudon ishte ai i Fationa Kasapit (-57 kg), që e fitoi medaljen e bronzitë në Kampionatin Evropian U23 në Potsdam 2023. Për të bronzitën Kasapi mposhti austriaken Laura Kallinger. Më 19 nëntor në Palestrën e

Sportit të Shkollës së Mesme të Mjekësisë “Imperium” në Bardhosh është mbajtur turneu ndërkombëtar “Adem Jashari”, ku morën pjesë mbi 100 garues. Ky turne është organizuar nga Federata e Xhudos e Kosovës në bashkëpunim me Klubin e Xhudos “Polici” nga Prishtina. Përveç klubeve të Kosovës, pjesëmarrës ishin edhe klubet nga Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Sllovakia, Maqedonia, Bullgaria dhe Polonia. Garuesi më i mirë për meshkuj u shpall Andi Reshitaj nga KXh “Ippon” Pejë, garuesja më e mirë për femra u shpall Johanna Klinger nga Bosnjë-Hercegovina.

Nga shtetet e jashtme shteti më i suksesshëm u shpall Sllovakia me 3 medalje të arta, 1 të argjendtë dhe 1 të bronzitë. Ëmbëlsira mbetet për fund. Kosova e mbylli mjaft suksesshëm vitin 2023. Kosova është shpallur kampione në Kampionatin Evropian të Hapur të Xhudos “Open Prishtina 2023”. Ky kampionat është mbajtur për herë të parë në vendin tonë më 16 dhjetor në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Pjesëmarrëse ishin 27 shtete të Evropës me 42 xhudistë. Kosova bindshëm triumfoi edhe në këtë kampionat. Akil Gjakova fitoi

medaljen e artë, kurse Distria Krasniqi, Nora Gjakova dhe Dardan Cena fituan medalje të bronzitë. Kontribut të madh për mbajtjen e kampionatit kanë dhënë presidentja Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti, ministri i Sportit, Hajrulla Çeku dhe ansambli “Rugova”. Kampionatin e nderoi me pjesëmarrëse zëvendëspresidenti i Unionit Evropian të Xhudos, Otto Kneiting, kurse Unioni Evropian i Xhudos dha dy çmime speciale: njërin për kryetarin e Federatës së Xhudos të Kosovës, Agron Kuka, tjetrin për kampionen olimpike Majlinda Kelmendi.



Kosovës i besohet organizimi i Lojërave Mesdhetare ‘Prishtina 2030’, Shqipëria kualifikohet në ‘Euro 2024’

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, DHJETOR, JANAR - Ngjarje të jashtëzakonshme sportive ndodhen në vitin 2023 në rrafshin vendor dhe në atë ndërkombëtar. Padyshim për shqiptarët lajmi më i mirë ishte kualifikimi i Kombëtares së Shqipërisë në Kampionatin Evropian, por edhe besimi që iu dha vendit tonë për organizimin e Lojërave Mesdhetare “Prishtina 2030”. Në rrafshin ndërkombëtar spikat dominimi i Manchester Cityt dhe triumfi në Ligën e Kampionëve, por edhe “Topi i Artë” i fituar për të tetën herë nga Lionel Messi.

Miratohet Ligji Anti-doping

10 MARS - Në Kuvendin e Kosovës u miratua Ligji Anti-doping. Objektivat kryesore të projektligjit janë: fuqizimi i integritetit të sistemit sportiv, kujdesi ndaj shëndetit të sportistëve dhe sportistëve dhe sigurimi i drejtësisë dhe mundësive të barabarta në gara sportive.

MKRS-ja ndan rreth 1 milion euro për KOK-un dhe KPOK-un, ndihmon edhe federatat sportive

5 PRILL - Dy marrëveshje bashkëpunimi në fushën e sportit

janë nënshkruar në mes të Ministrisë së Sportit dhe dy Komiteteve, atij Olimpik dhe Paralimpik të Kosovës. Masivizimi i sportit, organizimi dhe pjesëmarrja në gara, reprezentimi i shtetit dhe ngritja e kapaciteteve administrative janë disa nga aktivitetet e dy organizatave kyçe në vendin tonë. Ministri Çeku ka nënshkruar 19 memorandume për mbështetje financiare me Federatën e Xhudos, Volejbollit, Hendbollit, PingPongut, Federatën e Sportit Shkollor, Mundjes, Triathlonit, Atletikës, Basketbollit, Boksit, Skitarisë, Autosporteve, Muay Thait, Shenjëtarisë, Tenisit, Notit, Çiklizmit, Badmintonit dhe Golfit.

KH Trepça fiton kupën, Besa titullin dhe Superkupën

7 MAJ - KH Besa Famgas ka vazhduar dominimin në Superligën e Kosovës në hendboll, duke fituar titullin e kampiones për edicionin 2022/23, i dhjetë radhazi. Në finale të plejofit Besa mposhti Trepçën (2-0), ndërsa Kupën e Kosovës e fitoi Trepça, pasi në finale e mposhti skuadrën pejane me rezultat 40:39. Superkupën e fitoi Besa që në finale mposhti skuadrën mitrovicase me rezultat 36:28, ndërsa KHF Istogu dominoi

plotësisht në Superligën e femrave.

Liga evropiane, titujt për Barçën, Cityn, Napolin, Bayernin dhe PSG-në

14 MAJ - Barcelona e ka fituar titullin e kampionit në La Liga për sezonin 2022-23. Fitorja e saj e thellë 4-2 ndaj Espanyolit ia siguroi titullin e 27. Në Angli Manchester City është kurorëzuar kampion për të tretin sezon radhazi, pasi rivali për titull, Arsenali, humbi në Nottingham Forest. Napoli u shpall kampion i Italisë pasi barazoi 1-1 në transfertë ndaj Udineses, duke e fituar “Scudetton” e parë pas 33 vjetësh. Në Bundesligë, Bayern Muncheni u shpall kampion në mënyrë dramatike, pas fitores 2-1 në udhëtim te Këlni dhe barazimit të Borussia Dortmundit ndaj Mainzit (2-2). PSG-ja fitoi titullin në Ligën 1. Për suksesin e 11-të, klubit parisien i mjaftoi barazimi ndaj Strasbourgut (1-1).

KB Peja fitoi titullin, KB Trepça kupën

18 MAJ - Skuadra e Pejës ka fituar titullin e kampiones në Superligën e Kosovës në Basketboll për edicionin 2022/23. Peja e siguroi titullin, pasi në ndeshjen e pestë të serisë finale të plejofit e mposhti

Trepçën. Epiteti i lojtarit më të vlefshëm të kësaj serie finale i takoi amerikanit Jalen Tate, ndërsa Trepça edicionin e mbylli me triumf në Kupën e Kosovës dhe Superkupën Mbarëshqiptare.

Ballkani rrëmben titullin, Prishtina kupën

6 QERSHOR - Skuadra e Ballkanit është shpallur kampion i Kosovës në Superligë për herë të dytë radhazi, ndërsa skuadra e Prishtinës e ka fituar kupën e Kosovës në futboll pas një fitoreje 2-0 në finale kundër Gjilanit. Pas tri vjetësh, klubi bardhekaltër e ktheu një trofe në kryeqytet.

Manchester City për herë të parë fiton Ligën e Kampionëve

10 QERSHOR - Manchester City ka arritur që për herë të parë në histori ta fitojë Ligën e Kampionëve. Në finale City mezi e fitoi përballjen me Interin (1-0) në stadiumin “Ataturk” në Stamboll. Ndeshja u vendos me golin e shënuar në minutën e 68 nga Rodri.

Denveri, kampion në NBA

13 QERSHOR - Për herë të parë në histori, Denver Nuggets ka fituar

titullin e kampionit në ligën më të fortë të basketbollit NBA. Nuggetsit fitoi 4-1 serinë finale ndaj Miamit. Në ndeshjen e fundit Denveri triumfoi në fund me rezultat 94-89. Nikola Jokiqi u shpall lojtari më i mirë i serisë finale. Ai në ndeshjen e fundit kontribuoi me 28 pikë, 16 kërcime dhe katër asistime.

Suksesi i madh i atletikës në Lojërat Evropiane “Krakow 2023” dhe Berlin

22 QERSHOR - Atleti Muhamet Ramadani ka zënë vendin e tretë në Lojërat Evropiane “Krakow 2023”, të cilat për atletikën vlejnë si Kampionat Evropian ekipor, divizioni i tretë. Në mesin e 14 garuesve pjesëmarrës, Ramadani hodhi gjylen në distancë 19.07 metra. Atletët specialë Florent Haziri, Arta Avdyli, Lirika Sadiku dhe Leart Gashi përfaqësuan Kosovën në Olimpiadën Speciale Botërore në Berlin. Në ngjarjen ku morën pjesë 7 000 sportistë, tri medalje u dhanë për Kosovën. Florenti e fitoi të artën, Arta të argjendtën, ndërsa Lirika të bronzën.

Ramadani siguroi medalje të bronzë

15 KORRIK - Atleti Muhamet Ramadani siguri një medalje të bronzë në Kampionatin Evropian

U-23 në Espoo të Finlandës në disiplinën e hedhjes së gjyles. Me një gjuajtje të jashtëzakonshme prej 19.20 metrash, ai siguroi vendin e tij në podium mes 15 garuesve të tjerë.

Kosovës ngre trofeun e Kampionit Ballkanik në ‘Beach-Volley’

17 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës në “Beach-Volley” U22 në konkurrencën e femrave ka fituar titullin e kampiones në Kampionatin Ballkanik U22 në rërë organizuar në Maqedoninë e Veriut. Dyshja Melirona Avdullahu dhe Yllka Jashari në finale kanë mposhtur kombëtaren turke.

Uta Ibrahim ngjitet në majën K2 8611m

27 KORRIK - Uta Ibrahim është ngjitur në majën K2 8611m, e dyta më e larta dhe e para për vështirësi. Ky është një sukses i jashtëzakonshëm për Utan që ka thënë se një jetë ka punuar për të arritur deri këtu.

Ymeri dhe Isufi marrin vendet e para në ‘Kosova Sprint Thriatlon’

31 KORRIK - Federata e Triatlonit e Kosovës organizoi garën ndërkombëtare “Kosova Sprint Thriatlon”, në të cilën morën pjesë garues të gjashtë shteteve: Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Austria dhe Bullgaria. Albion Ymeri dhe Genc Isufi zunë vendet e para te meshkujt.

Kosova fiton katër medalje në Lojërat Frankofone ‘Kinshasa 2023’

4 GUSHT - Ekipi i Kosovës ka fituar katër medalje në Lojërat Frankofone “Kinshasa 2023”. Të artën e fitoi xhudisti Shpati Zekaj, kurse të argjendtën e fituan Muhamet Ramadani dhe Gresa Bakraqi në sportin e atletikës, kurse nga xhudo të bronzitën e fitoi Dardan Cena.

Kosova nuk kualifikohet në ‘Eurobasket 2025’

5 GUSHT - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll është mposhtur nga Danimarka me rezultat 63:88 dhe e ka humbur mundësinë të kualifikohet për “Eurobasket 2025”. “Dardanët” do të duhej të fitonim me 7 pikë ose më shumë epërsi këtë ndeshje për t’u kualifikuar tutje.

Robin Krasniqi fiton titullin WBC Silver

6 GUSHT - Robin Haxhi Krasniqi ka fituar titullin WBC Silver në pesha gjysmë të rënda përballë francezit Nadjib Mohammedi. Ky duel përfundoi para kohe pasi Mohammedi theu disa herë rregullat e boksit dhe kështu gjyqtari e diskualifikoi atë. Ky event u mbajt në stadiumin “Fadil



Vokri” në Prishtinë. Para duelit kryesor, në program ishin edhe shtatë meçe të tjera, ku boksierë shqiptarë u përballen me kundërshtarët e tyre.

Arabia mbledh yjet e futbollit, Messi shkon në Amerikë

10 GUSHT - Arabia Saudite, pas Cristiano Ronaldos, transferoi edhe shumë yje të tjerë si Benzema, Kante, Koulibaly, Kessie, Fabinho, Jota, Mendy, Firmino, Mahrez, Allan Saint-Maximin, Milinković-Savić, Neves, Malcom, Alex Telles, Fofana, Brozović, Henderson, Dembele e Hendry. Për dallim nga këta futbollistë, Lionel Messi ka vendosur ta vijojë karrierën tek Inter Miami në MLS-në e ShBA-së. Rrugën e Messit e ndoqën edhe Jordi Alba dhe Sergie Busquets.

Kosova U17 në hendboll, e shtata në Ankara

13 GUSHT - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll U-17 (vajzat) e ka mbyllur me fitore bindëse Kampionatin Evropian të Divizionit B të mbajtur në Ankara. Vajzat e Kosovës mundën Letoninë 39:27. Me fitore u renditën në vendin e shtatë.

Badallaj fiton medaljen në Kampionatin Evropian për Shkollarë

25 GUSHT - Boksieri Ensar Badallaj fitoi medaljen e argjendtë në Kampionatin Evropian për Shkollarë të mbajtur në Maribor të Sllovenisë. Badallaj shënoi tri fitore, ndërsa u mund në finale nga Florin Almeanu i Rumanisë, kategoria -57 kg.

Usyk mbron titujt në peshën e rëndë

27 GUSHT - Oleksandr Usyk i ka mbrojtur titujt WBA, WBO, IBF dhe IBO në peshat e rënda, duke mposhtur Daniel Duboisin në raundin e nëntë. Raundi i nëntë ishte pikë vendimtare për Usykun, pasi në sekondat e mbetur arriti ta gjunjëzonte britanikun 25-vjeçar, me gjyqtarin që numëroi deri në nëntë.

Medalje e argjendtë evropiane për kikboksen

1 SHTATOR - Rron Kasumi ka fituar medaljen e argjendtë në Kampionatin Evropian Wako të Kikboksit për Fëmijë, Kadetë dhe Juniorë, që u mbajt në Stamboll të Turqisë. Kasumi shënoi dy fitore, ndërsa u ndal në finale, kategoria +81 kg.

Komiteti Paralimpik i Kosovës anëtarësohet me të drejta të plota në Komitetin Evropian

2 SHTATOR - Komiteti Paralimpik i Kosovës (KPK) është bërë anëtar me të drejta të plota në Komitetin Paralimpik Evropian (EPC). Votimi është mbajtur më 9 gusht në Asamblenë e Përgjithshme në Rotterdam të Hollandës. Për kishin votuar edhe shtetet mosnjohëse, përpos Serbisë. Ky anëtarësim u mundëson paraatletëve në vitin e ardhshëm të garojnë për herë të parë në Lojërat Paralimpike që do të mbahen në Paris.

Kosovës i besohet organizimi i Lojërave Mesdhetare ‘Prishtina 2030’

8 SHTATOR - Asambleja e Përgjithshme e Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare (ICMG) ka votuar pro kandidaturës “Prishtina 2030”. 55 vota për, 8 kundër dhe tri vota të pavlefshme ishte bilanci i fitores së madhe të Kosovës. Shqipëria do të jetë bashkorganizatore, pasi sporti i lundrimit do të zhvillohet në bregdetin shqiptar. Në Asamble, të mbajtur në Heraklion të Greqisë, të pranishëm ishin edhe

udhëheqësit e shtetit, kryeministri Albin Kurti, ministri Hajrullah Çeku (MKRS), Hekuran Murati (MF), Elbert Krasniqi (MAPL), kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, drejtuesit e KOK-ut, si dhe drejtori i BKT Kosova, Suat Bakkal. Pas fitores ata e quajtën arritje të jashtëzakonshme për shtetin tonë. Pas deklarimit të fitores u nënshkrua edhe kontrata mes drejtuesve të ICMG-së, KOK-ut, Prishtinës dhe ministrive përkatëse. Prishtina u bë qyteti i parë jobregdetar që do t’i organizojë Lojërat Mesdhetare.

Nënshkruhet memorandumi për ndërtimin e stadiu-mit të Gjilanit

16 SHTATOR - Ministri i Sportit, Hajrulla Çeku dhe kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit në vlerë prej 15 milionë eurosh për ndërtimin stadiumit në qytetin e Gjilanit.

Donat Syla, kampion i Ballkanit për të Rinj

28 TETOR - Kosova fitoi 5 medalje në Kampionatin Ballkanik për Youth (të Rinj) dhe Juniorë në Ramnicu të Rumanisë. Në finale Syla mposhti boksierin nga Bosnjë-Hercegovina, Kunovac Nijaz. Medaljen e argjendtë e fituan Suela Canolli (57kg) e Orinda Xhakli (66 kg), kurse dy të bronzta Lumturim Xhoxhaj (57 kg) dhe Luan Morina (75 kg).

Donjeta Sadiku, e artë në Kampionatin Ballkanik

3 TETOR - Donjeta Sadiku ka fituar medaljen e artë në Kampionatin Ballkanik të Boksit që u mbajt në Albena të Bullgarisë. Sadiku shënoi fitore bindëse në finale ndaj ukrainases Tetiana Dovgal. Ekipi i boksit fitoi edhe katër medalje të bronzta, prej të cilave vetëm Shpetim Bajoku shënoi një fitore, por që humbi në gjysmëfinale, pas lëndimit të kundërshtarit. Bashkimi Bajoku, Patriot Behrami e Taulant Jakupi u stolisën me të bronzitën.

Trepça shkruan historinë, kualifikohet në grupet e FIBA Europe Cup

5 TETOR - Për herë të parë në historinë e saj, KB Trepça do të jetë pjesëmarrëse në fazën e grupeve të FIBA Europe Cup. Në ndeshjen e dytë të grupeve parakualifikuese KB Trepça e ka mposhtur Parnu Sadam me shifrat 77:67 (11:15, 21:20, 26:19, 19:13) në Estoni. Basketbollistët më të mirë te mitrovicasit ishin Jordy Tshimanga me 14 pikë e 12 kërcime, Kevin Davis me 17 pikë e tetë kërcime dhe Mikaile Tmusiq me 14 pikë.

Verstappen fiton titullin e tretë radhazi në Formula 1

7 TETOR - Piloti holandez Max Verstappen u bë kampion i botës

në Formula 1 për herë të tretë radhazi në garën e sprintit për Çmimin e Madh të Katarit. Sezoni i tij dominues përfshinte një rekord 10 fitore radhazi, dhe ai ka fituar 13 nga 16 garat e sezonit deri më tani. Vetëm pesë pilotë të F1 kanë fituar më shumë tituj. Verstappeni tani ka po aq tituj sa Jack Brabham, Niki Lauda, Nelson Piquet, Ayrton Senna dhe Jackie Stewart. Mbajtësit e rekordeve janë Lewis Hamiltoni dhe Michael Schumacheri me nga shtatë tituj kampion bote secili.

Vashat U17 të Kosovës kualifikohen në Ligën A për kualifikimet e ‘Euro 2024’

9 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës U17 është kualifikuar në Ligën A për kualifikimet e “Euro 2024”. Pas barazimit ndaj Andorrës dhe fitores ndaj Gjeorgjisë, vashat e Kosovës mundën Maqedoninë e Veriut në turneun e organizuar nga FFK-ja.

Kosova U17, kampione e ‘IHF Trophy’

15 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës U17 në hendboll është shpallur kampione e “IHF Trophy” për zonën e Evropës, pasi në finale mposhti Bosnjën e Hercegovinën (39:33). Ky sukses ua siguroi vajzave tona kualifikimin në fazën interkontinentale të “IHF Trophy”, prej ku mund ta sigurojnë kualifikimin në Kampionatin Botëror. Kosova U-19 u rendit e dyta, pasi u mund në finale nga Britania e Madhe.

FC Prishtina 01 arrin sukses madhështor në garat ndërkombëtare

28 TETOR - Klubi i Prishtinës në Futsall, FC Prishtina 01, u kualifikua në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve në Futsall, duke hyrë në mesin e 16 skuadrave më të mira të Evropës. Kjo arritje erdhi pas dy fitoreve dhe një barazimi në fazën e grupeve dhe përfundoi në vendin e parë.

Kosova, medaliste e bronzte e botës në karate

29 TETOR - Vashat e Kosovës në karate mundën Kazakistanin në luftën për të bronztën dhe shkruan historinë duke u ngjitur në podiumin e Kampionatit Botëror të Karatesë në Budapest të Hungarisë.

Messi për herë të tetë rrëmben ‘Topin e Artë’

30 TETOR - Lionel Messi e ka shkruar për herë të tetë emrin e tij në listën e fituesve të “Topit të Artë”, si askush tjetër. Asi argjentinasi u shpall fitues i trofeut më prestigjioz individual për vitin 2023, pasi mposhti Erling Haalandin dhe Kylian Mbappen.

Ujkani pensionohet, emërohet zëvendës-drejtor i Përfaqësueses

2 NENTOR - Portieri dhe kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës, Samir Ujkani, pas një karriere të pasur në nivel klubesh, por edhe me Kombëtaren e Shqipërisë dhe Përfaqësuesen e Kosovës, vendosi të pensionohet. Ndërsa ai menjëherë pas pensionimit është emëruar zëvendës-drejtor i Përfaqësueses së Kosovës në futboll.

Bajoku, boksieri më i mirë i turneut ‘Adem Jashari’

5 NENTOR - Shpëtim Bajoku u shpall boksieri më i mirë në edicionin e 25-të të Turneut Ndërkombëtar të Boksit “Adem Jashari”. Pjesëmarrës ishin edhe boksierë nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Sllovakia dhe Zvicra.

Musa i suksesshëm në Kampionatin Botëror të Bodybuildingut dhe Fitnessit

6 NENTOR - Rilind Musa ka shënuar suksesin më të madh të garuesve tanë në Kampionatin Botëror të Bodybuildingut dhe Fitnessit që u mbajt në Santa Sussana të Spanjës. Musa u rendit i pesti nga 16 garues në kategorinë “Men’s Physique -179 cm”. Granit Kuleta u rendit i shtati nga 14 garues në kategorinë deri në 95 kg, ndërsa Kushtrim Bajraktaraj doli i 11-ti prej 18 garuesve në -85 kg.

Shqipëria për herë të dytë kualifikohet në Kampionat Evropian

17 NENTOR - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll është kualifikuar në Kampionatin Evropian, Gjermania 2024. Ekipi i Shqipërisë ka luajtur kundër kombëtares së Moldavisë në vendin e kësaj të fundit dhe ndeshja ka përfunduar me barazim. Golin për ekipin e Shqipërisë e ka dhënë Sokol Cikalleshi. Shqipëria është shteti i 12-të që e ka rezervuar vendin për kampionatin me 24 ekipe pjesëmarrëse. Kombëtarja e Shqipërisë është e para në Grupin E. Kjo, përmdryshe, është hera e dytë që Shqipëria kualifikohet për Kampionatin Evropian në futboll. Hera e parë ka qenë më 2016.

Federata e Golfit e Kosovës është anëtarja më e re e Asociacionit Evropian të Golfit

18 NENTOR - Federata e Golfit e Kosovës është anëtarja më e re e European Golf Association. Nga sot fillon një etapë e re e historisë së golfit të Kosovës dhe nga viti i ardhshëm Kosova do të jetë pjesëmarrëse në garat evropiane të golfit.



Bajoku, medalist i bronzte në Evropianin U22

18 NENTOR - Bashkimi Bajoku është shpërblyer me medaljen e bronzte në Kampionatin Evropian të Boksit për U22. Boksieri në fjalë u ndal në gjysmëfinale të kategorisë -54 kg. Është kjo arritja më e madhe e Bajokut në karrierën e tij.

Gjashtë medalje fitohen nga karateistët në Lubjanë

20 NENTOR - Pesë të argjendta dhe një e bronzte, është bilanci i medaljeve të fituara nga ekipi i karatesë në Kampionatin Ballkanik për kadetë, juniorë dhe U-21, të mbajtur në Slloveni. Medaljen e argjendtë e fituan Islam Selmani (U-21, -60 kg), Erblin Shoshi (kadet, -52 kg), Artioli Shaqiri (junior, -76 kg), Redona Gashi (U-21, -50 kg), të gjithë në kumite dhe Alma Loki (U-21) në kata. Me të bronztën u stolis Blerand Osmani (kadet +70 kg).

Kosova dështoi në kualifikueset për Evropian, por edhe me dy përzgjedhës

22 NENTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll dështoi në kualifikueset për Kampionatin Evropian “Euro 2024”. “Dardanët” përfunduan në vendin e

parafundit në Grupin I, pjesë e të cilit ishin edhe Rumania, Zvicra, Izraeli, Bjellorusia dhe Andorra. Nga dhjetë ndeshje, Kosova fitoi 11 pikë, ndërsa pas vetes la vetëm Andorrën me dy pikë. Në Evropian si e para e grupit u kualifikua Rumania, ndërsa Zvicra e dyta. Kosova dështoi edhe me dy përzgjedhësit. Alain Giresse pas humbjes nga Bjellorusia u largua nga drejtimi i “dardanëve”. Trajnerin francez e ka zëvendësuar slloveni Primozh Gliha, të cilit i ka zgjatur katër muaj qëndrimi në krye të Kosovës. Nën drejtimin e Glihas, Kosova shënoi dy fitore, ndërsa pati po aq barazime dhe humbje.

KOK-u dhe KOKSh-i nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

25 NENTOR - Komiteti Olimpik i Kosovës dhe Komiteti Olimpik Kombëtar i Shqipërisë kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi përmes të cilit bëhet unifikimi i ngjarjeve sportive të përbashkëta si kampionatet dhe ngjarjet e tjera sportive kombëtare të përbashkëta. Qëllimi i këtij memorandumit është rritja e cilësisë së sportistëve, promovimi, shkëmbimi dhe pikëpamjet mbi çështjet që lidhen me sportin.

Taekwondistët fitojnë pesë medalje në Kampionatin Ballkanik

25 NENTOR - Pesë medalje të fituara, prej tyre një e artë, një e argjendtë dhe tri të bronzta, është bilanci i suksesit të taekwondistëve të Kosovës në Kampionatin e 23-të Ballkanik të mbajtur në Sarajevë. Në grupmoshën junior, Jon Gashi fitoi medaljen e artë, kategoria -73 kg, ndërsa Mal Sahiti u stolis me të bronztën në -68 kg. Tek seniorët, Rona Gashi fitoi medaljen e argjendtë (-62 kg), kurse Denis Bllaca (-58 kg) e Arnis Agushi pranuan të bronztat (-74 kg).

Vashat e Kosovës në futboll promovohen në Ligën B

1 DHJETOR - Vashat e Përfaqësueses së Kosovës në futboll arritën një sukses të madh duke u kualifikuar në Ligën B të Ligës së Kombeve. “Dardanet” shënuan fitore bindëse ndaj Bullgarisë 5-1 në ndeshjen e luajtur në stadiumin “Zahir Pajaziti”, për ta siguruar promovimin në një ligë më lart, pasi u konfirmuan në vendin e parë të Grupit 5 të Ligës C.

Skitarja Sophie Sorschag debuton për Kosovën

3 DHJETOR - Skitarja e kërcimeve me



ski, Sophie Sorschag, ka garuar në Kupën e Botës në Lillehammer të Norvegjisë. Sorschag debutoi për Kosovën në disiplinën e kërcimeve nga lartësia normale, arriti të hyjë në finale, doli e 33-ta, ndërsa në kërcimet nga lartësia e madhe nuk arriti të hyjë në finale.

Taekwondisti Bleron Ademi shpallet nënkampion i Evropës për U-21

7 DHJETOR - Taekwondisti Bleron Ademi u bë nënkampion i Evropës për U-21. Ai fitoi medaljen e argjendtë në Evropianin që u mbajt në Bukuresht të Rumanisë. Ademi fitoi katër luftëra, për t'u ndalur në finale të kategorisë -54 kg.

Prishtina, 'Qytet Evropian i Sportit për Vitin 2024'

7 DHJETOR - Prishtina edhe zyrtarisht ka marrë epitetin "Qytet Evropian i Sportit për Vitin 2024".

Vendimi është marrë nga Parlamenti Evropian. Është kjo një tjetër arritje e sportit, veçanërisht Prishtinës, sukses ky në të cilin kontribuoi edhe KOK-u.

Ballkani sërish në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës

14 DHJETOR - Kampioni i Kosovës, Ballkani, sërish ka shkëlqyer në arenën ndërkombëtare. Për të dytin vit me radhë u kualifikua në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës. Në ndeshjen vendimtare, Ballkani humbi nga Dinamo Zagrebi (3-0) dhe në këtë ndeshje e mbylli grupin me 4 pikë.

Sporti i gjimnastikës vazhdon të rritet, rezultatet ndërkombëtare nuk mungojnë

16 DHJETOR - Federata e Gjimnastikës e Kosovës zhvilloi

gara vendore e ndërkombëtare përgjatë vitit 2023. Gjimnastet e Klubit "Elita" nga Prishtina, Bora Hoti, Kaltrina Thaqi, Vilëza Zeqiri dhe Jara Gumnishta, të udhëhequra nga trajnerët Shkumbin Maqastena dhe Abeliana Bregu, kanë marrë pjesë në Turneun Internacional të Gjimnastikës "Gymfinity International 2023" që është mbajtur nga data 16-17 dhjetor në Grunstadt të Gjermanisë. Po në këtë turne kanë marrë pjesë edhe gjimnastet e Kubit të Gjimnastikës "Fushë-Kosova". Në këtë turne kanë marrë pjesë shumë garues nga shumë ekipe dhe vende të ndryshme të botës. Në turneun "Gymfinity International 2023" gjimnastet nga Kosova kanë shkëlqyer, duke rrëmbyer medalje të arta, të argjendta dhe të bronzta nëpër të gjitha kategoritë dhe disiplinat e këtij sporti atraktiv. Gjimnastja Bora Hoti ka arritur të tubojë gjithsej 44.4 pikë, duke rrëmbyer vendin e parë në të gjitha disiplinat. Po ashtu, suksese të

jashtëzakonshme kanë arritur edhe Kaltrina Thaqi, Vilëza Zeqiri dhe Jara Gumnishta, të cilat kanë arritur të stolisen me medalje të arta, të argjendta dhe të bronzta. Në shtator ekipi i Përfaqësueses së Gjimnastikës së Kosovës mori pjesë në Kampionatin Ballkanik të Gjimnastikës në Turqi. Gjimnastet e Kosovës që garuan me sukses ishin Bora Hoti, Elena Sefa, Jora Gervalla, dhe Fernaze Cakaj dhe Sara Pllana. Në përpjekjet e tyre, ato nuk arritën të kualifikohen në finale për shkak të konkurrencës së fortë në rajon. Më 11 dhe 12 nëntor Federata e Gjimnastikës së Kosovës u përfaqësua ndërkombëtarisht nga tri klube të gjimnastikës artistike për femra: "Elita", "Vushtrria" dhe "Fushë Kosova", të cilët morën pjesë me sukses në Turneun HorizonCup në Selanik të Greqisë duke shfaqur një performancë të jashtëzakonshme. Sara Pllana arriti vendin e parë në "all around" duke rrëmbyer trofeun më të rëndësishëm me shumë sukses. Afër medaljeve ishin Rea Berisha

dhe Adea Shala. Përveç tyre, gjimnastet e tjera që shkëlqyen në këtë garë ishin Bora Hoti, Jora Gervalla dhe Vlera Gërguri. Edhe gjimnastet e tjera arritën rezultate pozitive, përfshirë Elena Sefa, Tiara Dragusha, Sumea Hoxha, Olta Breznica, Loreta Kelmendi dhe Elisa Bogaçku.

Capralos i impresionuar me të arriturat e KUK-ut dhe sportistëve të Kosovës

18 dhjetor - Presidenti i Komitetit Olimpik të Evropës (EOC), Spyros Capralos, është ndier i impresionuar me të arriturat e KOK-ut në dy-tri vitet e fundit dhe sukseset e sportistëve të Kosovës. I pari i lëvizjes olimpike të Evropës takoi drejtuesit e KOK-ut, por edhe kryeministrin Albin Kurti dhe ministrin e Sportit, Hajrulla Çeku. Sipas tij, Kosova është në rrugë të mirë të fitojë medalje edhe në "Paris 2024".





Zemra e Erjona Sulejmanit e ndarë tresh në ‘Euro 2024’

Goglat e shortit për finalët e “Euro 2024” dhuruan një grup ferri. Shqipëria përfshihet në Grupin B së bashku me Spanjën, Kroacinë dhe Italinë. Modelja dhe showgirl shqiptar Erjona Sulejmani, ish-ja partnerja e futbollistit Blerim Xhemaili, në një postim në rrjetet sociale,

thotë se zemra e saj është e ndarë në tresh. “Kur ke tri skuadra të preferuara, Shqipërinë, Italinë dhe Spanjë, dhe shpreson që të paktën një të fitojë Euro 2024, por më pas zbulon se janë në të njëjtin grup”, shkruan Erjona, e cila më pas, nëpërmjet komenteve të shumta nga

ndjekësit, mësoi se mund të kalojnë grupin 3 skuadra dhe këto mund të jenë të tria skuadrat që ajo bën tifo, të cilat nuk mund të përballen me njëra-tjetrën në fazën tjetër. Kur është pyetur se kë do të donte në finale, Sulejmani është shprehur se donte Itali - Shqipëri.

Tifozja e Barit ngre temperaturat për festa

Në rrjetet sociale nuk e ka zbuluar identitetin e saj të vërtetë dhe njihet me emrin “Tifozja e Barit”, ndërsa rreth një vit më parë përfundoi në qendër të vëmendjes, duke ulur pantallonat në stadiumin “San Nikola”. Prej asokohe tifozja “hot” ka pasur një karrierë intensive,

fillimisht duke u testuar me sukses në akademinë e famshme të pornos të drejtuar nga Roko Sifredi dhe më tej në “OnlyFans”. Bukuroshja italiane së fundmi ka menduar t’i risë temperaturat në prag të festave, me anë të disa postimeve tepër provokuese në “Instagram”.



10 partneret më të bukura të yjeve të futbollit në 2023-n



Bashkëshortet dhe të dashurat e yjeve të futbollit janë një nga aspektet më të bukura në këtë

sport dhe në listën e partnereve më të bukura të futbollit për vitin 2023 përfshihen disa emra të rinj.

Shumica e këtyre grave u bënë të famshme duke mbështetur bashkëshortët e tyre dhe heronjtë

e famshëm të futbollit brenda dhe jashtë fushës, dhe këto femra madhështore, të mrekullueshme,

tërheqëse dhe mbresëlënëse, janë lidhur me disa nga yjet më të shkëlqyer dhe më të njohur të futbollit në botë. Sipas “Pulse Sports”, David Beckham, Mario Icardi, Cristiano Ronaldo dhe Lionel Messi të gjithë i kanë parë bashkëshortët e tyre të marrin komplimente masive nga fansat për shkak të bukurisë së tyre.

10 partneret më të bukura të yjeve të futbollit:

1. **Georgina RODRIGUEZ** (partnerja e Cristiano Ronaldos)
2. **Marlene ALVARENGA** (gruaja e Nelson Semedos)
3. **Monique SALUM** (gruaja e Pastor Fred)
4. **Antonella MESSI** (gruaja e Messit)
5. **Taylor WARD** (gruaja e Riyad Mahrez)
6. **Tolami BENSON** (e dashura e Bukayo Saka'a)
7. **Sophia WEBER** (e dashura e Kai Havertz)
8. **Marta DIAZ** (e dashura e Sergio Reguilion)
9. **Leah MONROE** (e dashura e Tammy Abraham)
10. **Jessica AIDI** (gruaja e Marco Veratti)



‘Bomba’ e Unitedit nuk përmbahet, mbështet ‘djajtë’ me poza provokuese

Luki Nikolson njihet si tifozë e flaktë e gjigantëve të Manchester Unitedit. Edhe pse klubi më i titullar në Angli nuk po përjeton një moment pozitiv, Nikolson ka gjetur strategjinë efikase për t’ua ngritur moralin djemve të Ten Hag dhe mbështetësve të klubit. Në foton e fundit në “Instagram”, Luki tregon “më tepër” seç duhet, teksa rrëmben të gjithë madhësinë e “Old Trafford” me këmbët përjetë.

Noemi konfirmon me foto se nuk ka krizë lidhja me Tottin



Historia e dashurisë mes Françesko Tottit dhe Noemi Boçit po ecën mirë. 35-vjeçarja ka postuar një foto romantike në “Instagram” nga Nju-Jorku, ku ka shkuar me ish-kapitenin e Romës. Në foto ajo puth partnerin e saj në faqe. Pas tyre është një sfond befasues gradaçelash dhe dritash. Noemi shtoi dy zemra emoji dhe numrin 13 në imazh, një numër i lidhur me historinë e saj të dashurisë me Tottin.

Tifozja kroate dhuron shou në ‘Instagram’

Ivana Knoll rreth një vit më parë pushtoi mediet si një prej muzave më të bukura gjatë Kampionatit Botëror të futbollit në Katar, por tifozja seksi kroate vijon të jetë në qendër të vëmendjes. Modelja seksi është tepër aktive në “Instagram”, ndërsa vazhdon të mahnitë me bukurinë dhe format trupore. 31-vjeçarja regjistron më shumë se 3.1 milionë ndjekës, ndërsa shfaqet në formë fantastike në fotot dhe videot që publikon çdo ditë.



Mlcakova, nga garat me motorë, në modele e suksesshme

Anet Mlcakova është shumë e lidhur me botën e motorëve. Ka qenë shpeshherë pjesë e modeleve në bokse krah pilotëve në Moto GP apo në kategorinë Superbike. Bukuroshja çeke është partnerja e pilotit italian Nikolo Kanepa, kampion në kategorinë endurance. Por më shumë se sa aktivitetet në garat me motorë, ashtu si shumë modele të tjera, 26-vjeçarja shkëlqen në rrjete sociale, teksa regjistron mbi 1.1 milion ndjekës në “Instagram”.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1522/1
Dt: 29.12.2023

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Ligjit nr.08/L- 197 për Zyrtarët Publik, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPALLJE E KONKURSIT
Për plotësimin e vendit të lirë në Qendra e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2023/2024

Niveli	Institucioni/Sh kolla	Vendi	Pozita	Vend i lirë/Zëvendësim	Numri i pozitave
SHML	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Mësimdhënës/e për Matematikë	Vend i lirë	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Shkollë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit, duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara;
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it (UA Nr. 05/2021) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Matematikë në shkollë të mesme të lartë:

- Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

III. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t’i kryejë detyrat që mund t’ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

IV. Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2023/2024 (Shtator 2023 – Gusht 2024);
- Kandidatët me kualifikime jo-përkatëse sipas ligjeve dhe UA të cekur në pikën II të këtij konkursi nuk do të merren në shqyrtim;
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t’i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheq 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri në 100 pikë apo 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbliidhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitat e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail (konkurset) dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në tabelën e shpalljeve në Shkollë dhe do tu dërgohen kandidatëve me e-mail.

V. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **29.12. 2023 deri më datën 12.01.2024.**
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollë, Qendra e Kompetencës në Skenderaj;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Rezultatet e konkursit do të publikohen në tabelë të shpalljeve në Shkollë.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arbnore Hili shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: 10, 11, 12 të Gjimnazit “Hajdar Dushi”.

- Muj Çoçaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU “Lidhja e Prizrenit” Prizren.

- Kushtrim Baxhaku shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Batjar Binakaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHME “Ymer Prizreni” Prizren.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1521/1

Dt: 29.12.2023

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Ligjit nr.08/L- 197 për Zyrtarët Publik, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPALLJE E KONKURSTIT

Për plotësimin e vendit të lirë në Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë për vitin shkollor 2023/2024

Niveli	Institucioni/Shkoll a	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësi m	Numri i pozitive
SHML	Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi"	Malishevë	Mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane	Vend i lirë	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Shkollë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomati e kualifikimit, **duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara;**
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore **(nëse ka).**

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (**Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138**) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it (**UA Nr. 05/2021**) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane në shkollë të mesme të lartë:

- Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS).

III. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

IV. Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2023/2024 (Shtator 2023 – Gusht 2024);
- Kandidatët me kualifikime jo-përkatëse sipas ligjeve dhe UA të cekur në pikën II të këtij konkursi nuk do të merren në shqyrtim;
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheq 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri në 100 pikë apo 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitat e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail (konkurset) dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në tabelën e shpalljeve në Shkollë dhe do tu dërgohen kandidatëve me e-mail.

V. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **29.12. 2023 deri më datën 12.01.2024.**
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollë, Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuar në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Rezultatet e konkursit do të publikohen në tabelë të shpalljeve në Shkollë.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.




Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë






www.facebook.com/gjeipuneshpjete

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Bazuar në nenin 38, paragrafi 3 dhe paragrafi 4, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-150 (këtu e tutje: Ligji për BQK-në), Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) shpall:

KONKURS
për
Zëvendësguvernator/e
për Funksione të Përgjithshme

Zëvendësguvernatori/ja për Funksione të Përgjithshme është pozitë e lartë ekzekutive (mbi nivelin e drejtorëve të departamenteve). Zëvendësguvernatori/ja shërben si anëtar/e i/e Bordit Ekzekutiv dhe e ndihmon Guvernatorin në realizimin e operacioneve të BQK-së. Është i/e ngarkuar me funksionet e BQK-së, përfshirë mbrojtjen e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare dhe mbikëqyrjen e praktikave të tregut, statistikave financiare dhe të jashtme, administratën e përgjithshme të BQK-së, burimet njerëzore, prokurimin dhe kontraktimin, sigurinë, logjistikën si dhe funksione tjera. Po ashtu, mund të ngarkohet me detyra dhe përgjegjësi shtesë ose portofol tjetër sipas strukturës organizative.

Profili i kërkuar i kandidatit:

- Të jetë shtetas/e i/e Kosovës;
- Të jetë me integritet;
- Të ketë diplomë universitare (studime themelore e detyrueshme);
- Të ketë minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështjeve juridike;
- Të ketë njohuri në zhvillimin dhe implementimin e politikave të rëndësishme të lidhura me objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Të përmbushë kërkesat nga neni 40 i Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Diplomat universitare post-diplomike paraqesin përparësi;
- Përvoja dhe aftësia menaxheriale relevante paraqet përparësi;
- Përvoja profesionale dhe teknike në menaxhim të proceseve në institucione financiare paraqet përparësi;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera paraqet përparësi.

Dokumentet e kërkuara për pozitën në fjalë:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim (mund ta shkarkoni në www.bqk-kos.org);
- Curriculum Vitae (CV);
- Letër motivuese (të elaborohet ndërlidhja e përvojës dhe/ose kualifikimit tuaj me pozitën e synuar);
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit;
- Kopja e noterizuar e diplomës së studimeve themelore, ndërsa për diplomën e studimeve themelore të fituar jashtë Republikës së Kosovës kërkohet kopja e noterizuar e nostrifikimit në Republikën e Kosovës;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale). Raporti për periudhën përkatëse nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti) i preferueshëm si dokument shtesë;
- Certifikatën nga Gjykata kompetente, e cila dëshmon se kandidati/ja nuk ka qenë asnjëherë subjekt i ndonjë vepre penale (certifikatë kjo jo më e vjetër se 3 muaj); dhe
- Vërtetimin nga Policia që dëshmon se kandidati/ja nuk është nën hetime (vërtetim ky jo më i vjetër se 3 muaj).
- Certifikatat profesionale, rekomandimet dhe referencat relevante (opcionale).

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të lartcekur në e-mail adresën elektronike paneli@bqk-kos.org, duke e vendosur si titull (subjekt): *Aplikimi për Z.G. për Funksione të Përgjithshme*.

Afati i fundit për aplikim është 15 janar 2024 (ora 23:59).

Vetëm kandidatët e përzgjedhur që plotësojnë kushtet formale dhe kërkesat e konkursit me dokumente të kompeltuara, që konsiderohen të emërueshëm nga ana e Panelit do të ftohen për intervistë.



Na osnovu člana 38. stava 3. i stava 4. Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 05/L-150 (u daljem tekstu: Zakon o CBK), Centralna banka Republike Kosovo (CBK) raspisuje:

KONKURS
za
zamenika guvernera
za opšte funkcije

Zamenik guvernera za opšte funkcije je visoka izvršna pozicija (iznad nivoa direktora odjeljenja). Zamenik guvernera za opšte funkcije služi kao član Izvršnog odbora i pomaže guverneru u obavljanju operacija CBK. Zadužen je za funkcije CBK-a, uključujući zaštitu korisnika finansijskih usluga i nadzor tržišne prakse, finansijsku i spoljnu statistiku, opštu administraciju CBK-a, ljudske resurse, nabavku i ugovaranje, bezbednost, logistiku i druge funkcije. Takođe se može zadužiti dodatnim dužnostima i odgovornostima ili drugim portfolijom prema organizacionoj strukturi.

Traženi profil kandidata:

- Da je državljanin Kosova;
- Da ima integritet;
- Da ima fakultetsku diplomu (osnovne studije obavezno);
- Da ima najmanje deset (10) godina profesionalnog ili akademskog iskustva u oblasti ekonomije, finansija, bankarstva, računovodstva ili pravnih pitanja;
- Da ima znanje u razvoju i sprovođenju važnih politika u vezi sa ciljevima i zadacima CBK-a;
- Da ispunjava uslove iz člana 40. Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo;
- Univerzitetske diplome iznad osnovnih studija predstavljaju prednost;
- Relevantno menadžersko iskustvo i sposobnost predstavljaju prednost;
- Profesionalno i tehničko iskustvo u upravljanju procesima u finansijskim institucijama predstavlja prednost;
- Poznavanje engleskog i drugih jezika predstavlja prednost.

Potrebna dokumenta za navedenu poziciju:

- Službeni obrazac CBK-a za prijavu (možete preuzeti na www.bqk-kos.org);
- Biografija (CV);
- Motivaciono pismo (elaborirati povezanost između iskustva i/ili kvalifikacije sa ciljnom pozicijom);
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte;
- Ovjerena kopija diplome osnovnih studija, dok za diplomu osnovnih studija stečene van Republike Kosovo, ovjerena kopija nostrifikacije u Republici;
- Dokaz o radnom iskustvu (kopije ugovora ili potvrde poslodavca ili drugi relevantni dokumenti koji služe za dokazivanje pozicije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata za zaštitu ličnih podataka). Izveštaj iz Fonda penzione štednje Kosova (Trust) za relevantni period je poželjan kao dodatni dokument;
- Uverenje nadležnog suda kojim se dokazuje da kandidat nikada nije počinio krivično delo (uverenje ne starije od 3 meseca); i
- Uverenje policije kojom se dokazuje da kandidat nije pod istragom (uverenje ne starije od 3 meseca).
- Profesionalni sertifikati, preporuke i relevantne reference (opcionarno).

Zainteresovani kandidati moraju dostaviti gore navedenu kompletnu dokumentaciju na elektronsku e-mail adresu paneli@bqk-kos.org, stavljajući kao naslov (subjekat): *Prijava za Z.G. za opšte funkcije*

Zadnji rok za podnošenje prijava je 15. januar 2024. godine (23:59 časova)

Na razgovor od strane Komisije biće pozvani samo izabrani kandidati koji ispunjavaju formalne uslove i uslove konkursa sa kompletnom dokumentacijom.

